Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (197) SHKURT 2023. ÇMIMI: 50 LEKË. 0,5 €

BIG market
PESHKOPI MAQELLARË
Plot oferta dhe surpriza...

STUDIM

Skavica – pikëpyetjet e një hidrocentrali që cënon Dibrën...

Nga **DR.ADRIATIK BALLA** — Faqe 4

REPORTAZH

Nga Dibra në Dibër, përmes Trebishtit, Gjinovecit, Steblevës...

Nga **FITIM DIKA** — Faqe 7

75 VJETORI

Bulqiza ndërtoi Shqipërinë, por ajo e harroi atë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** — Faqe 8

BOTIME

"Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës", një libër me vlera shkencore

Nga prof.dr. **BASHKIM LLESHI** — Faqe 20

KESH publikon draftprojektin e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social

Protestë në Londër kundër Skavicës

Çështja"Skavicës" vazhdon të trazojë jetën e banorëve në Dibër dhe komunitetit dibran nëpër botë. Më 23 shkurt 2023, grupimi i quajtur "Aleanca për Dibrën" që drejtohet nga biznesmeni Zenel Hoxha, zhvilloi një protestë në Londër, përballë zyrave të kompanisë qendrore të Bechtel. Aleanca për Dibrën synon që ta ndalojë ndërtimin e Skavicës përmes vënies në dukje të korrupsionit qeveritar si dhe akuzave se kjo qeveri punon kundër interesave kombëtare. Sipas AD kjo "qeveri është më antikombëtare në histori, është qeveria më e korruptuar në botë, është qeveria shqiptare më anti Amerikane në histori!". "Projekti 'Skavica' është projekti më korruptiv në Europë", thuhet në njoftimin e protestës së 23 shkurtit në Londër. Aleanca u bën thirrje shqiptarëve të ngrihen "në këmbë, për Dibrën, që nga fëmija në djep".

LEXONI NË FAQEN 3



NË BRENDËSI:

- **Kush po i vjen Radikës...**
- **Shungullime malli** *dhe dritëhijet e kohës*
- *Përse nuk e shikoj* **Big Brother VIP?**
- **Liri Rasha**, *fenomen i papërsëritshëm i muzikës folklorike shqiptare*
- *Për tre mësues të gjuhës shqipe nga katundi Vleshë:* **Femi Xhepa, Halim Shehu** *dhe* **Hivzi Shehu**.
- *Respekt dhe mirënjohje për mësuesit e mi:* **Myslim Shehu**, **Adem Shehu** *dhe* **Kadri Zhulali**
- **Na bashkoi poezia -14**, *krijues të njohur e të rinj me një gjeografi hapësinore në trojet shqiptare*
- "**Gjurmë të folkut arbëror**" - *një enciklopedi e folkut shqiptar*
- **Bashkim Duva**, *miku i gjithë matjanëve*
- *Homazh për mësuesin veteran* **Ahmet Rushit Tomja**
- *Ndahet nga jeta* **Sami Sulejman Kamberi**, *njeriu i ndershëm, i drejtë, mendjehapur*

PUNIMET NË RRUGËN E ARBRIT

Bashkohet tuneli i emergjencës, tuneli kryesor është në 690 metrat e fundit



Tuneli i emergjencës në Rrugën e Arbrit, 3.8 km i gjatë, u bashkua të mërkurën, datë 15 shkurt 2023, ndërkohë që punimet për tunelin kryesor po vazhdojnë. Burime nga kompania thanë se po vazhdojnë edhe punimet në tunelin kryesor. Sipas tyre, tuneli kryesor, ai i trafikut, ka edhe rreth 690 metra për tu bashkuar, ndërkohë që po punohet në të dy anët. Hapja e tunelit të emergjencës do të ndihmojë që punimet të ecin më shpejt edhe në tunelin kryesor, atë që do të përdoret për qarkullimin normal të automjeteve. Bashkimi i tunelit të emergjencës nuk nënkupton se në këtë tunel punimet do të ecin më shpejt dhe mund të hapet për qarkullim për makinat.

LEXONI NË FAQEN 2

SPECIALE

Prof. Adem Bunguri zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave



STUDIMI

Rivlerësimi i hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova

Evidenca arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë na shtyn të ndalemi më thellë në këtë çështje, ku gjendet sipas nesh, çelësi për të kuptuar më mirë mekanizmin e shfaqjes së këtij fenomeni gjatë Bronzit të Hershëm, si dhe për të rivlerësuar hipotezën e migracionit "kurgan".

Nga **ADEM BUNGURI,** *Akademik*

Shënime

Akademik A.Bunguri, personalitet i shquar i arkeologjisë shqiptare

Nga prof. **VESEL HOXHA**

Vlerësime për akademik Adem Bungurin nga personalitete të kulturës dhe shkencës në Dibër

SPECIALE NË **FAQET 9-13**

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 2 (197).
Shkurt 2023
Gazeta doli nga shtypi, 8 mars 2023.
Gjendet në treg deri në fund muajit mars 2023.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Adriatik BALLA
Vesel HOXHA
Bashkim LLESHI
Adem BUNGURI
Hajri SHEHU
Fitim DIKA
Selman MEZIU
Edi LESI
Afrim KAROSHI
Rasim HOXHA
Naxhi KASORUHO
Sejdin DEMIRI

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K82019002S
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Bashkohet tuneli i emergjencës, tuneli kryesor është në 690 metrat e fundit

Tuneli i emergjencës në Rrugën e Arbrit, 3.8 km i gjatë, u bashkua të mërkurën, datë 15 shkurt 2023, ndërkohë që punimet për tunelin kryesor po vazhdojnë.

Burime nga punonjës të kompanisë thanë në kushtet e anonimatit se po vazhdojnë edhe punimet në tunelin kryesor. Sipas tyre, tuneli kryesor, ai i trafikut, ka edhe rreth 690 metra për tu bashkuar, ndërkohë që po punohet në të dy anët.

Hapja e tunelit të emergjencës do të ndihmojë që punimet të ecin më shpejt edhe në tunelin kryesor, atë që do të përdoret për qarkullimin normal të automjeteve.

Bashkimi i tunelit të emergjencës nuk nënkupton se në këtë tunel punimet do të ecin më shpejt dhe mund të hapet për qarkullim për makinat. Tuneli i emergjencës do të ndihmojë në ecurinë më mirë të punimeve, por ai nuk mundet të hapet për qarkullim normal të makinave.

Tuneli i Murrizit ishte parashikuar me një gjatësi prej 3.2 km, por pas shembjes së tunelit në maj 2019, u desh një ristudim i tij dhe punimet nisën në një vend tjetër, gjë që e ka rritur gjatësinë e tunelit në 3.8 km.

Gjërësia e tunelit që do të shërbejë për trafikun normal përbëhet nga dy korsitë e trafikut më gjërësi 3.5m secila, dy kuneta anësore me nga 0.35m të gjëra, dy trotuare me gjerësi 0.85m dhe me pjerrësi tërthore 2% në drejtim të kunetave përkatëse. Pjerrësia tërthore e korsive është -2.5%, ndërsa lartësia e lirë për trafikun është 5 m. Përmasat gabarite brenda për brenda tunelit të trafikut janë: baza 10.1m dhe lartësia 6.8m.

Tuneli i Emergjencës është paralel me atë të trafikut në një distance aksiale 25m. Kanë të njëjtën gjatësi, ndërsa korridori i kalimit të mjeteve është 3.5m. Ka dy trotuare me nga 0.7 metra secili, dhe lartësia e lirë e kalimit është 4m. Përmasat e tij gabarite janë: baza 6.04 m dhe lartësia 4.7m.

Këto dy tunele paralele bashkohen midis tyre me anë të 6 galerive të kalimeve tërthore, nga të cilat 4 janë për shpëtimin e këmbësorëve në një rast eventual dhe 2 të tjerët janë për nevojat emergjente të automjeteve.

Seksionet përkatëse tërthore janë projektuar për të mundësuar për arritjen e qëllimit të këtyre galerive. Galeritë tërthore vendosen në largësinë 500m midis tyre përgjatë gjithë tunelit.

Galeritë e kalimit nga tuneli i trafikut në atë të emergjencës janë të ngjashëm me vetë tunelin e emergjencës.

Sipas projekt idesë, tuneli parashikon marrjen e masave të sigurisë sipas standardeve europiane. Në raste emergjence apo zjarri në tunel ai u




Pamje nga bashkimi i dy anëve të tunelit të emergjencës në Murrizë. Foto: GjokaKonstruksion/FB

mundëson plotësisht udhëtarëve të lënë mjetet e tyre dhe të shkojnë në një vend të sigurtë, ndërkohë që garanton hyrje të shpejtë të ekipeve të zjarrfikësave dhe të shpëtimit. Pikërisht për këtë është parashikuar tuneli i emergjencës paralel me atë të trafikut. Po kështu, çdo 500m, janë projektuar edhe galeritë e kalimit nga tuneli i trafikut në atë të emergjencës dhe anasjelltas. Këto vendkalime do të jenë 2 galeri mjetesh dhe 4 galeri këmbësoresh, të gjitha të pajisura me dyer sipas kërkesave të mbrojtjes nga zjarri e tymi.

Sheshet e portaleve të tunelit mundësojnë hyrje dhe daljen e shpejtë të mjeteve të emergjencës në tunelin e emergjencës, ndërsa në vendtakimet e galerive të mjeteve me tunelin e trafikut dhe atë të emergjencës do të mundësojnë edhe hapësira vendqëndrimi për mjete.

Në të njëjtin progresiv me tunelin e emergjencës, edhe tuneli i kryesor i trafikut ka 2 anekse vendqëndrimi mjetesh në të dy anët e tij, me gjatësi 60m. Në këtë 60 metra, 40 m do të përdorën për vendparkimin e mjeteve, 5m për aneksin e thirrjes së emergjencës, 5m për aneksin e panelit elektrik dhe 10m për shuarsin e goditjeve.

Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri brenda në tunel përfshin hidrante, linja uji për hidrantet, sisteme fikje zjarri të veçanta, detektorë zjarri e tymi, dhomëza të mbrojtes nga zjarri çdo 250m, rezervuar uji të posaçëm, prurje uji jo më pak se 1200 l/min për gjatë të paktën një ore. Brenda në tunel, çdo 125m ka dhomëza të thirrjes së emergjencës. Tuneli është projektuar për t’u pajisur me instalimet e kërkuara elektro-mekanike të sigurisë dhe ventilimit.



Tuneli i Murrizit që do të shërbejë për trafikun normal përbëhet nga dy korsitë e trafikut më gjërësi 3.5m secila, dy kuneta anësore me nga 0.35m të gjëra, dy trotuare me gjerësi 0.85m, ndërsa lartësia e lirë për trafikun është 5 m. Përmasat gabarite brenda për brenda tunelit të trafikut janë: baza 10.1m dhe lartësia 6.8m.

PAK HISTORIK

Kontrata e koncensionit me kompaninë “Gjoka Konstruksion” është miratuar nga Këshilli i Ministrave më 23 mars 2018 dhe parashikonte një periudhë 13 vjeçare koncensioni, nga të cilat 44 muaj do të duheshin për ndërtimin e saj.

Kur në rrugë nisën zyrtarisht punimet u premtua se afati i nisjes së qarkullimit do të ishte në pranverën e vitit 2021, ndërsa afati i përfundimit të punimeve u deklarua nëntor i vitit 2021.

Për shkak të vonesës së hapjes së tunelit të Murrizit si dhe periudhës së ndërprerjeve të punimeve, më 20 tetor 2020 është nënshkruar një zgjatje e kontratës së ndërtimit më 17 muaj, duke e çuar përfundimin e rrugës në nëntor 2023, afat i cili, sipas ecurisë së deritanishme, nuk është i mundur të arrihet.

Belinda Balluku, ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, deklaroi në një interpelancë parlamentare në korrik 2022 se vlera e kontratës mbetej e pandryshuar: 33.6 milionë lekë.

Deri më tani, shoqëria koncensionare ka marrë nga buxheti i shtetit gati një të tretën e shumës totale, prej gati 12.4 milionë lekë.

Në tetor të vitit të kaluar, Autoriteti Rrugor Shqiptar zhvilloi një tender për sistemimin dhe rivitalizimin e skarpateve në Planin e Bardhë dhe Shkallën e Tujanit, me një vlerë rreth 20 milionë Euro. Këto punime priten të mbarojnë gjatë muajit prill-maj 2023, duke u hapur plotësisht për qarkullim.

Punimet nga degëzimi i Klosit deri në Qafë Buall, 10 km i gjatë, janë gati në përfundim, në pritje të shtresës asfaltike. Burime nga kompania bëjnë të ditur se në maj ky segment do të jetë i hapur për qarkullim.

Përgatiti: Bujar Karoshi

kryesore

Nëse jeni të interesuar për raportin paraprakt të vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social, klikoni në linkun e mëposhtëm ose skanoni barkodin:
https://tinyurl.com/27ec9v56

Protestë në Londër kundër Skavicës

KESH publikon draft projektin e vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social

Çështja"Skavicës" vazhdon të trazojë jetën e banorëve në Dibër dhe komunitetit dibran nëpër botë. Më 23 shkurt 2023, grupimi i quajtur "Aleanca për Dibrën" që drejtohet nga biznesmeni Zenel Hoxha, zhvilloi një protestë në Londër, përballë zyrave të kompanisë qendrore të Bechtel.

"Aleanca për Dibrën" njoftoi në faqen e saj në Facebook se "protesta e Londrës përçoi mesazhin e duhur të kompania Bechtel, e cila është përfshirë në klanin mafioz qeveritar shqiptar dhe atë ndërkombëtar të sojit McGonigal, për zhdukjen e Dibrës".

Aleanca për Dibrën (AD) synon që ta ndalojë ndërtimin e Skavicës përmes vënies në dukje të korrupsionit qeveritar si dhe akuzave se kjo qeveri punon kundër interesave kombëtare.

Sipas AD kjo "qeveri është më antikombëtare në histori, është qeveria më e korruptuar në botë, është qeveria shqiptare më anti Amerikane në histori!".

"Projekti 'Skavica' është projekti më korruptiv në Europë", thuhet në njoftimin e protestës së 23 shkurtit në Londër. Aleanca u bën thirrje shqiptarëve të ngrihen "në këmbë, për Dibrën, që nga fëmija në djep".

"Shqiptarët, dibranët nuk duhet ta njohin atë qeveri që spastroi atdheun nga rinia. Çdo marrëveshje me këtë qeveri është e pavlefshme", thuhet në deklaratën e Aleancës për Dibrën të shpërndarë në Facebook.

Drejtuesit e protestës kanë premtuar se "nuk do të ndalemi kurrë derisa Lugina e Drinit, Dibra mbarë vendlindja e Heroit tonë Kombëtar, të shpallet zonë e mbrojtur nga Bashkimi Europian".

Protesta kishte pak pjesëmarrës dhe, pas protestës, në një reagim në faqen e tyre në Facebook, shprehën pezmin për pjesëmarrjen e pakët të dibranëve në protestë.

"Kemi besim që dibranët do të zgjohen nga gjumi letargjik, për ta vlerësuar vendlindjen. Nuk kemi kohë për kritika të merituara, por do gjejmë durimin për ti pritur krahë-hapur, për të na u bashkuar në ditët në vijim", thuhej mes të tjerash në njoftimin pas protestës.

Kjo protestë në Londër ishte e dyta, pas asaj të zhvilluar në tetor 2022 nga grupimi "Kundërshtimi ndaj digës së Skavicës", drejtuar nga Ferzileta Gjika. Kjo e fundit organizoi më 25 shkurt 2023 në Peshkopi, në Hotel Veri, një takim me temë "Për Dibrën o Sot o Kurrë, Nesër është Shumë vonë", ku disa banorë të zonës dhe aktivistë kundër Skavicës dhanë argumentet kundër këtij projekti.

KESH PUBLIKON DRAFT PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL (VNMS)

"Golder Associates S.r.l." dhe "Gr Albania" kanë dorëzuar te Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) një draft të projektit mbi vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social.

Ky draft, i hartuar që në shtator 2022, është firmosur nga ekspertët e GR Albania më 7 shkurt 2023 dhe është publikuar në faqen e internetit të KESH në fillim të shkurtit.

Raporti është një përmbledhje e shkurtër prej 56 faqesh, në të cilën përshkruhen disa tema që kanë të bëjnë kryesisht me mjedisin dhe ndikimet që do sjellë rezervuari i Skavicës mbi të.

Në studimin e publikuar evidenton disa lloje bimësh dhe speciesh, të cilat mbrohen nga Direktivat Europiane të Habitateve dhe janë në listën e Librit të Kuq, në zhdukje ose drejt zhdukjes.



Protesta përballë zyrave të Bechtel në Londër. Foto nga faqja në Facebook e Aleancës për Dibrën

"Disa lloje bimësh me interes kombëtar dhe ndërkombëtar (Lista e Kuqe Shqiptare dhe Lista e Kuqe e BNRN - IUCN) u identifikuan gjatë studimeve në terren dhe janë të përfaqësuara mirë në zonën e studimit", shkruhet në raport (f.8).

Në raport thuhet se "gjatë vëzhgimeve në terren, të kryera tashmë, u identifikuan disa lloje bimësh mjekësore me rëndësi ekonomike dhe shëndetësore për banorët vendas. Prania e ndikimit njerëzor në zonat e studimit ka krijuar mozaike me habitate të ndryshme që janë më të prekurat nga llojet e huaja dhe pushtuese".

Në kapitullin për habitatet natyrore dhe të modifikuaram raporti thekson se "peizazhi përgjatë lumit Drin, në zonën e studimit, është kryesisht natyror me zona më të vogla të karakterizuara si bujqësore (të modifikuara). Karakteristikat natyrore të peizazhit konsistojnë në shtratin e lumit, bimësinë natyrore dhe morfologjinë, e cila nuk ndikohet nga strukturat e krijuara nga njeriu me përmasa të konsiderueshme. Zona konsiderohet me vlera të larta estetike".

Duke folur për tokat bujqësore, raporti thekson se "Habitatet e tokave bujqësore të modifikuara dhe të rigjeneruara ndodhen brenda zonës së studimit. Zakonisht, ato mbillen me misër, perime dhe pemë frutore (kryesisht mollë dhe kumbulla). Në disa raste, si në Fushë Çidhën, produktiviteti i tyre është i lartë për shkak të pranisë së tokës aluviale të pasur me sedimente".

Raporti evidenton se "disa habitate të tokave bujqësore janë braktisur për sa i përket menaxhimit produktiv. Duke qenë se janë në djerrë, ato kanë filluar të gjysmë-natyralizohen, duke u kthyer ne livadhe dhe te dominohen nga shkurre" (f.18)

Në raport listohen disa faktorët kryesorë të ndikimit që lidhen me projektet si emetimi i gazeve serrë; emetimi i substancave që shkatërrojnë ozonin; emetimi i pluhurit dhe grimcave; ndryshimet në morfologjinë lokale; heqja e sipërfaqes së tokës; kërkesa për ujë; shkarkimi i ujërave të zeza; ndryshimet në cilësinë e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore;ndryshimi i veçorive të peizazhit; ndërtesat dhe infrastruktura të reja; heqja e bimësisë natyrore; ndryshimi në përdorimin e tokës; humbja e mjeteve/menyrës së jetesës; humbje ose dëmtim i drejtpërdrejtë i trashëgimisë kulturore dhe burimeve arkeologjike etj.

"Vlerësimi formal i vlerave të parametrave të lartpërmendur, duke përfshirë kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara, do të bëhet në një fazë të mëvonshme të procesit të VNMS-së, pasi të përcaktohen projekti përfundimtar, vendndodhja, zgjerimi i rezervuarit, kushtet e të dhënave të komponentëve,dhe kuptohet ndikimi i plotë i krijuar nga aktivitetet e Projektit", shkruhet në raport.

Raporti ka evidentuar disa efekte negative përsa i përket gjeomorfologjisë, tokës dhe ujit.

Në raport thuhet se mund të ketë ndikim negativ erozioni i tokës, degradimi i cilësisë së tokës dhe të ujit, degradim i cilësisë së ujërave nëntokësorë, etj.

Në aspektin e biodiversitetit evidentohet humbja e drejtpërdrejtë e bimësisë ose modifikimi i saj si dhe zhdukja e disa lloje speciesh.

Të kapitulli "Komponentët sociale" (f.18-20), në çështjen "Përdorimi i tokës dhe zhvendosja fizike" evidentohen si ndikim negativ fakti se "Zona e ndikimit të projektit është në një kontekst rural, ku jetesa e komuniteteve lokale është shumë e varur nga bujqësia dhe aktivitetet e bazuara në tokë". Evidentohet gjithashtu se " jetesa e familjeve që jetojnë në zonën e rezervuarit do të ndikohet ndjeshëm". Por për këto dy çështje, evidentohen edhe zgjidhjet pozitive të mundshme, si p.sh. fakti që "do të ndërtohen shtëpi dhe infrastruktura të reja dhe do të përmirësojnë nivelet e përgjithshme të jetesës së familjeve të zhvendosura dhe komuniteteve përreth". Në raport thuhet se "do të zbatohen programe të restaurimit të mjeteve/mënyrës të jetesës, të tilla si programe bujqësore për të mbështetur adoptimin e pajisjeve dhe metodave të modernizuara".

Përsa i përket trashëgimisë kulturore, studimi thekson se "trashëgimia kulturore e njohur dhe e panjohur brenda rezervuarit do të preket drejtpërdrejt dhe, në disa raste (objekte të paluajtshme) do të humbasin përgjithmonë'. Por ndërkohë evidenton se "gjetjet arkeologjike mund të kthehen në njohuri të shtuara mbi historinë e zonës së impaktuar nga projekti dhe të përfaqësojnë destinacione të reja turistike".

Edhe përsa i përket infrastrukturës, "projekti do të ndikojë shumë në rrjetet ekzistuese të infrastrukturës duke përfshirë rrugët, shpërndarjen e ujit, shpërndarjen e energjisë si dhe komuniteti që përdor infrastruktura të tilla do të ndikohet drejtpërdrejt". Raporti evidenton një rrjet ekzistues të dobët të kësaj infrastrukture dhe thekson se "infrastrukturat e reja do të jenë të standardeve të përmirësuara".

> **"Kemi besim që dibranët do të zgjohen nga gjumi letargjik, për ta vlerësuar vendlindjen. Nuk kemi kohë për kritika të merituara, por do gjejmë durimin për ti pritur krahë-hapur, për të na u bashkuar në ditët në vijim", thuhej mes të tjerash në njoftimin pas protestës.**
>
> **Raporti Mjedisor dhe Social konsiderohet si një çështje e rëndësishme në vendimmarrjen për ndërtimin ose jo të hidrocentralit të Skavicës.**

Të njëjtin vlerësim ndan edhe për objektet sociale, si shkollat, klinikat shëndetësore etj., të cilat do të përmbyten, por "projekti mund të përfaqësojë një mundësi për të ndërtuar shkolla të reja, rrugë, kopshte dhe objekte të tjera sociale me standarde të përmirësuara".

Në lidhje me turizmin, në raport theksohet se "disa aktivitetet turistike mund të shqetësohen gjatë fazës së ndërtimit" si dhe "disa destinacione turistike do të preken drejtpërdrejt nga përmbytjet". Ashtu edhe si për komponentët e tjerë, në raport vlerësohet se "projekti mund të përfaqësojë një mundësi për të gjeneruar aktivitete të reja turistike dhe për të përmirësuar ofertën turistike".

Për varrezat dhe objektet fetare ekzistuese brenda pellgut do të preken drejtpërdrejt dhe për këtë nuk ka zgjidhje pozitive.

"Ky identifikim i ndikimit rrjedh nga një fazë fillestare e analizës dhe do të përpunohet më tej gjatë aktiviteteve të ardhshme të VNMS-së bazuar në informacionin bazë më të saktë dhe informacionin më specifik dhe më të detajuar të projektit", shkruhet në fund të raportin e publikuar.

Gjithashtu, në fund të raportit jepet edhe një draft përmbajtje e raportit përfundimtar të VNMS-së, i cili pritet të publikohet gjatë muajve në vazhdim.

Aktualisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke konsultuar me institucionet e tjera Raportin e Studimit Mjedisor dhe tashmë është një afat më pak se 1 mujor, ku raporti do të konsiderohet i përfunduar. Më pas, do të planifikohet dëgjesat me publikun, i cili duhet të njoftohet paraprakisht përmes mediave, me poster pranë njësive të qeverisjes vendore apo në faqet e internetit të kompanisë, KESH dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Pas konsultimeve me publikun, raporti i nënshtrohet një vlerësimi final nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, merr komentet online nga publiku deri në marrjen përfundimtare të firmës së Ministrit.

Raporti Mjedisor dhe Social konsiderohet si një çështje e rëndësishme në vendimmarrjen për ndërtimin ose jo të hidrocentralit të Skavicës.

BUJAR KAROSHI

Në kushtet kur shkenca ka parashikuar që thatësira do të rritet gjatë këtij shekulli, është e pafalshme të bazosh perspektivën e energjisë së vendit vetëm nga hidrocentralet. Ndaj duhen gjurmuar alternativat, si energjia solare, ajo e erës etj, të cilat kanë më pak kosto, janë të pashtershme, e nuk sjellin dëme të tilla në mjedis e në ekonomi sikurse "Skavica".

Lexoni shkrimin e plotë në botimin origjinal në **linkun e mëposhtëm ose skanoni barkodin:**

https://tinyurl.com/45aa9htd

Rruga e Arbërit nr. 197

studim

Skavica – **pikëpyetjet e një hidrocentrali** që cënon Dibrën dhe luginën e Drinit të Zi



Nga **Dr.ADRIATIK BALLA**

HYRJE

HEC "Skavica" është një prej projekteve madhore të qeverisë shqiptare, një projekt që kërkon një investim midis 0.5-1 miliard euro, të cilat do të paguhen nga taksapaguesit shqiptarë, me synim për të përmirësuar sistemin elektroenergjetik të vendit, me objektiv dy elementë thelbësorë: krijimin e një rezerve hidrike që i jep fund varësisë së vendit nga importi i energjisë (pra rritjen e prodhimit) si dhe evitimin e përmbytjes në zonën e Nënshkodrës. Por cilat janë të vërtetat shkencore në lidhje me Skavicën? Në çështjet e mëposhtme, duke dhënë argumentet tona dhe duke ngritur disa shqetësime qytetare, i mështojmë faktit se Skavica nuk duhet ndërtuar, duke apeluar për gjetjen e burimeve të tjera alternative, që Shqipëria i ka me shumicë.

DISA TË DHËNA PËR HIDROCENTRALET MBI LUMIN DRIN DHE PIKËPYETJET E SKAVICËS

Kaskada e Drinit përmban disa hidrocentrale. HC i Vaut të Dejës, vënë në punë në nëntor 1971, ka 5 agregatë dhe një fuqi 250 MW. Prodhimi vjetor i tij është 1.1 miliard kilovatorë . Hidrocentrali i Fierzës është vënë në shfrytëzim në nëntor 1978. Ka fuqi të vendosur prej 500 MW dhe punon me 4 agregate. Prodhimi vjetor i tij është 1.8 miliard kilovatorë . Hidrocentrali i Komanit filloi ndërtimin më 1979 dhe përfundoi më 1985. Ka fuqi të vendosur 600 MW dhe punon me 5 agregate. Prodhimi vjetor i energjisë është 2 miliard kilovator . Nuk ka të dhëna të sakta se sa do të jetë fuqia e hidrocentralit të Skavicës, sepse deri tani është ecur me supozime ordinere (flitet për fuqi 250 MW, fuqi që nuk ndikon në mënyrë vendimtare në përmirësimin e sistemit tonë hidroenergjetik, pra dëmi i shkaktuar nga përmbytja është më i madh se fitimet).

"TË MBYSIM DIBRËN, TË SHPËTOJMË SHKODRËN" PËRBËN MARRËZI SHKENCORE

Shumë autorë insistojnë të ndërtohet Skavica për të shpëtuar Shkodrën nga përmbytja. Një qasje e tillë tërësisht e pabazuar në shkencë është në rastin më të mirë mosnjohje e problemit, e në rastin më të keq ligësi. Në asnjë vend nuk bëhen projekte për të sjellë lumturi në një zonë duke shkaktuar tragjedi në një zonë tjetër. Për t'ju kthyer argumentit, theksojmë se në periudhën ujëshumë dhe gjatë ditëve me shi intensiv, Drini i Zi kapërcen 1 mijë m3/s, dhe i bashkuar me Drinin e Bardhë para se të mbërrijë në Bunë, ata kapërcejnë 2-3 mijë m3/s, e një herë në 100 vjet mbi 4 mijë m3/s. Në këto raste të rralla, Drini i bashkuar me Bunën derdh në det një sasi mbi 6500 m3/s, duke ngjarë kështu me Danubin (Pano 2015). Atëherë, në kushtet kur prurjet janë maksimale si pasojë e zgjatjes së periudhës me shi, apo e korresponduar me shkrirjen e shpejtë të borës, detyrohen të hapen portat e të gjithë liqeneve, duke bërë që fusha e Nënshkodrës të jetë e rrezikuar nga përmbytjet. Duke njohur karakterin e reshjeve në vendin tonë, që bien kryesisht në periudhën nëntor-prill, si dhe rastisjet në 10, 20 50 e 100 vjeçare, bëhet e pamundur që Skavica ta luajë këtë rol, pra të evitojë përmbytjen e Shkodrës. Varianti më i besueshëm është që Drini, si pasojë e prurjes së madhe dhe derdhjes në Bunë me drejtim pingul me të, bëhet pengesë për Bunën në dalje nga liqeni, për pasojë rritet niveli i ujërave të vetë liqenit duke shkaktuar përmbytje. Por Skavica nuk mund ta evitojë këtë për sa kohë Buna, ka një kapacitet të vogël ujëpercjellës dhe aftësi të paktë për të zbrazur ujërat e shumta të liqenit. Kjo lidhet me shumë faktorë, por kryesisht cektësinë e shtratit të Bunës, apo mosgjetjen e një zgjidhjeje artificiale që ujërat e Drinit të menaxhohen sipas rastit duke aktivizuar edhe rrjedhën e vjetër të tij drejt Lezhës.

MBI NDIKIMIN NEGATIV NË TIPARET FIZIKO-GJEOGRAFIKE

1. Ndikimi në proceset shpatore, pra ndryshimin e profilit morfogjenetik të shpateve si pasojë e ndryshimeve të nivelit bazë të erozionit për shumë degë të Drinit të Zi. Paqëndrueshmëria e shpateve do të çojë në rrëshqitje dhe ngopje me lagështi për t'i bërë shtresat më të paqëndrueshme dhe për shkak të denatyrimit të shtratit në rritjen e gjeohazardeve me shfaqje të reja e të panjohura më parë për këtë luginë.

2. Në aspektin gjeomorfologjik, liqeni krijon një ndarje të pjesës lindore të luginës me atë perëndimore. Kjo ndarje shënon edhe elementin më të rëndë negativ në tiparet natyrore, pasi, ndryshon tërësisht sistemi gjeomorfik i luginës së Drinit të Zi, me pasoja të pariparueshme në qindra e mijëravjeçar në mjedis.

3. Në aspektin klimatik, liqeni i Skavicës do të krijojë kushtet për një mikroklimë të rajonit, e cila do të specifikohet nga përmbajtja e lartë e lagështisë në ajër, për pasojë shtimin e fenomenit të mjegullës dhe rrjedhimisht ndikimin negative të treguesve të rrezatimit dhe treguesve të tjerë meteorologjikë, duke e bërë jetën e banorëve në pellgun e Dibrës më pak të shëndetshme.

4. **Ndikimi negativ në pasuritë hidrike nëntokësore**, pasi shumë burime aktuale me ndërtimin e Skavicës varrosen, po kështu ndryshojnë mjaft parametra të ujërave nëntokësore mbi pasqyrën e liqenit.

5. Ndryshime negative në tiparet pedogjenetike, ku tokat e begata të Dibrës si pasojë e denatyralizimit të elementëve të tjerë fizikogjeografikë, humbasin cilësinë e tyre për klimën ku janë formuar në mijëra vjet e për rrjedhojë do të ndryshojë tërësisht struktura e përdorimit të tokës, gjë që ka pasoja të rënda në prodhim dhe larmishmëri e për pasojë në shpopullim të vazhdueshëm.

6. Ndikimi në florë dhe faunë mund të llogaritet po ashtu katastrofik. Me qindra specie bimore e shtazore zhduken, për t'u lënë vend specieve që nuk janë karakteristikë për këtë luginë e për klimën e saj. Kuptohet, për këtë çështje kanë folur edhe autorë të tjerë.

7. "Skavica" shuan karakterin potamogjenik të lumit Drini i Zi. Digat e Vaut të Dejës, Komanit, Fierzës, si dhe 3 ujëmbledhësve të tjerë (HC) në pjesën e Maqedonisë së Veriut, kanë bërë që karakteri potamogjenik i lumit Drin të shuhet në pjesën më të madhe të tij. Ky karakter ruhet vetëm në sektorin nga Skavica e deri në Gjoricë. Nëse ndërtohet Skavica nuk do të kemi më "lumi Drin", por do të kemi "kompleksi i liqeneve artificialë të Drinit", shkurt "liqenet e Drinit". Duke ruajtur të paprekur lumin Drini i Zi, mbrohet një nga pasuritë më të mëdha të natyrës shqiptare.

NDIKIMI NEGATIV DEMOGRAFIK

Ky është një nga treguesit më tragjikë nga ky projekt. Skavica shpopullon Dibrën dhe këtu qëndron themeli i të gjitha çështjeve që ngrihen. Për shkak të pozitës gjeografike dhe rëndësisë së kësaj krahine në ngjarjet historike, Dibra është përballur me rrebeshe e fatkeqësi të mëdha përgjatë historisë. Tre janë periudhat kur është vënë në diskutim ekzistenca e saj. Fillimisht me pushtimin osman dhe masakrat e përbindshme të Sulltan Mehmetit në Çidhnë e në krejt Dibrën, duke bërë që krahina të humbiste pjesën dërrmuese të popullatës e të mbetej me pak mijëra banorë në fund të shekullit XV. Më pas me agresionin e egër serb ku llogaritet se nga treva e Dibrës u larguan deri në 70 mijë vetë dhe, së treti, shpopullimi si pasojë e emigracionit që po ndodh gjatë këtyre 30 viteve të fundit, e që sipas të dhënave që ka publikuar vetë Instat, është alarmant. Nga qarku Dibër gjatë këtyre viteve të fundit, është larguar mesatarisht çdo vit mbi 3 mijë banorë. Qarku ka humbur në 5 vjetët e fundit 12% të popullsisë. Skavica përshpejton zbrazjen dhe çon në shpopullim.

Shpopullimi dhe pasojat. Ndërtimi i Skavicës do të shpërngulë afro 20 mijë banorë. Por ndikimi negativ është për afro 50 mijë vetë. Kjo pasi dëmtohen interesat e 20-30 mijë të tjerëve që janë në emigracion por janë ende të lidhur me zonën. Ku do të sistemohet një numër kaq i madh njerëzish, çfarë pune do të bëjnë (kjo popullsi është e pakualifikuar për punë tjetër), cili do të jetë dëmshpërblimi i tyre? Çfarë do të ndodhë me varret e të parëve, me qendrat arkeologjike etj? Skavica nuk i përmbyt të gjitha vendbanimet e Dibrës, por përmbyt më kryesoret dhe ato më kryesoret (Fushë-Muhurr, Arras, Fushë-Çidhnë, Dardhë, Zall-Reç, Laçe, Katund i Ri, Vajmëdhenj etj), të cilat janë ekzistenciale për vendbanimet më në lartësi që janë të shpërndarë, të vegjël, me pak tokë, pa infrastrukturë etj.

NDIKIMI NEGATIV NË INFRASTRUKTURË

Ndërtimi i HEC-it sjell një masë të madhe uji (mbulon një sipërfaqe mbi 55-65 km2), që e ndan luginën në dy pjesë, në lindje dhe në perëndim. Kjo e bën të pamundur lidhjen e tyre të shkurtër me ura dhe për të dalë nga një breg në tjetrin do të duhen tragete të vegjël apo varka, duke bërë që të humbasë koha, të rriten kostot e transportit, të mungojë lidhja e shkurtër e fshatrave me qytetin e Peshkopisë, praktikisht kjo çon në rrënimin përfundimtar të të gjithë fshatrave në të majtë të rrjedhjes, madje mund të shkohet deri aty sa të ndryshojë krejtësisht harta administrative.

NDIKIMI NEGATIV NË EKONOMI

Është fare e qartë tashmë se specialistët e dekadave më parë nuk kanë mundur të bindin se energjia e Skavicës do të sjellë më shumë fitime se produktet bujqësore e blegtorale të prodhuara në luginën e Drinit të Zi. Larmishmëria e produkteve bujqësore është mjaft e madhe dhe e dëshmuar në kohë. Lugina e Drinit të Zi është një hambar për Shqipërinë. Asnjëherë, në asnjë rrethanë, hidrocentrali i Skavicës nuk mund të prodhojë fitime sa ç'prodhojnë tokat e Dibrës. Analizat e specialistëve në atë kohë e në këtë kohë duhen marrë në konsideratë.

SHQETËSIMI QYTETAR DHE EFEKTET NEGATIVE SOCIAL-KULTURORE E HISTORIKE

Ky është një element i rëndësishëm që fokusohet në disa disa drejtime:

Shqetësimi juridik – Ndërtimi i një dige të tillë që përmbyt Dibrën, kërkon më së paku marrjen e mendimit të banorëve dhe në kushtet kur nuk ka marrëveshje dhe mirëkuptim, atëherë është kushtetuta ajo që paraqet nevojën e një referendumi lokal, ku populli i Dibrës të shprehet. Projekte të tilla që nuk dëshirohen nga banorët nuk mund të zbatohen. Ka plot shembuj në Europë dhe më gjerë të zbatimit të referendumeve lokale.

Shqetësimi që lidhet me historinë – Dibra është vendi i zbulimeve të mëdha arkeologjike, ku janë evidentuar shumë vendbanime prehistorike e historike me vlera të jashtëzakonshme, por për këto është shprehur më mirë arkeologu i njohur, profesor A.Bunguri. Lugina që përmbytet është baza e disa prej ngjarjeve më të rëndësishme historike të popullit tonë dhe Dibra e ne të gjithë nuk mund të lejojmë të varroset poshtë ujërave të një hidrocentrali historia e saj/jonë.

Shqetësimi që vjen nga dëmtimi materialo-shpirtëror – Skavica përmbyt një kulturë, një qytetërim mijëravjeçar, përmbyt një his-

aktualitet

- Denatyralizohet lugina e Drinit të Zi, e cila ka një pjesë të rëndësishme të fondit bujqësor në Republikën e Shqipërisë dhe disa prej tokave më pjellore të vendit, si dhe shumë burime natyrore që janë mundësi zhvillimi shumë më tepër sesa një HC.
- Nga 15 njësi administrative brenda Bashkisë Dibër, përfshi qytetin e Peshkopisë, preken plotësisht ose pjesërisht nga përmbytjet e Skavicës 9 njësi administrative, pra më shumë se gjysma e Bashkisë.
- Nga 83 fshatra gjithsej, që përmbyten plotësisht ose pjesërisht janë 35, të tjerët nuk përmbyten por dalin jashtë loje dhe zhduken sepse: ose u përmbyten tokat, ose u ndërpriten rrugën me qendrën administrative, u mungon komunikimi me pjesën tjetër, është e pamundur të riorganizohen me kushtet e sotme me të cilat ballafaqohen fshatrat shqiptarë në zonën verilindore të vendit.

tori, pra ajo përmbyt vlera historike, por edhe vlera materiale e shpirtërore të banorëve që i kanë të lidhura me tokën, shtëpinë dhe krahinën, me këngët dhe vallet, me veshjen, me traditat e çmuara të saj. Kjo dëmton lidhjen shpirtërore të banorëve të emigruar me zonën, pasi aty ndodhen varret e të parëve, ndodhet e shkuara e fisit, fshatit, krahinës dhe sikurse ka thënë autori francez Paul Claval, regjioni përcaktohet si një hapësirë ku fermentohet me natyrën ndjenja njerëzore e identitetit dhe Dibra e dibranët në veçanti, e kanë të shprehur këtë gjë.

Shqetësimi politik – i cili ka të bëjë me indiferencën e klasës politike, për më tepër që anashkalohet zëri i shkencëtarëve. Nëse ka një vendim për ta bërë ose jo Skavicën, atë vendim duhet ta marrin shkencëtarët e jo politikanët.

KONKLUZIONET THEMELORE

Hidrocentralet janë gjë e mirë, energji e pastër, por ato ndërtohen atje ku logjika ekonomike është e shëndetshme. Të përmbytësh Dibrën ka pasoja të rënda.

Detyrohen të shpërngulen mijëra banorë (afro 20 mijë). Edhe sikur t'u ndërtohet gratis një qytet, shkohet në kolaps, pasi kjo popullatë nuk është e përgatitur (kualifikuar) për treg pune tjetër nga bujqësia dhe blegtoria, plus shërbimet që nevojiten kudo që t'i akomodosh.

Zhduken fshatra të tërë, 35 të tillë, dhe krejt toka e tyre bujqësore dhe lugina e Drinit të Zi është nga më pjelloret e Shqipërisë (4-5 mijë hektarë tokë shumë pjellore). Një hidrocentral më shumë nuk është më mirë sesa një hambar më pak. Hidrocentralet kanë një jetëgjatësi të caktuar (sepse vjen një ditë e mbathen nga depozitimet), kurse fusha (lugina) është brez pas brezi.

Dëmtohet në mënyrë të pakthyeshme lidhja shpirtërore e banorëve me zonën.

Varroset historia e lavdishme e Dibrës, histori mijëravjeçare, ku spikat si "Olimpi", Historia e Skënderbeut, heroit të vetëm kombëtar të shqiptarëve. Pra këtu bëhet fjalë për historinë e popullit shqiptar. Nuk ka Skënderbe pa Dibër e pa Dibër nuk ka Shqipëri.

Në luginën e Drinit të Zi, nuk mbetet më vend për të kujtuar luftërat skënderbejane të skalitura në historinë e Shqipërisë dhe ky është dëm kolosal, që shkel mbi amanetin e të parëve dhe shkërmoq identitetin e pasardhësve.

Denatyralizohet lugina e Drinit të Zi, e cila ka një pjesë të rëndësishme të fondit bujqësor në Republikën e Shqipërisë dhe disa prej tokave më pjellore të vendit, si dhe shumë burime natyrore që janë mundësi zhvillimi shumë më tepër sesa një HC.

Ndryshon krejtësisht skema ekonomike e zonës, deri në nivel qarku, ndërsa dendësia e popullsisë në më shumë se 2 mijë km2 midis Kukësit në veri, Mirditës e Matit në perëndim, Bulqizës në jug e kufirit shtetëror në lindje, bie në më pak se 20 banorë/km2. Në aspektin gjeostrategjik, ky do të ishte i dëmshëm për sigurinë e vendit, menaxhimin e resurseve dhe të ardhmen ekonomike të saj.

Nga 15 njësi administrative brenda Bashkisë Dibër, përfshi qytetin e Peshkopisë, preken plotësisht ose pjesërisht nga përmbytjet e Skavicës 9 njësi administrative, pra më shumë se gjysma e Bashkisë.

Nga 83 fshatra gjithsej, që përmbyten plotësisht ose pjesërisht janë 35, të tjerët nuk përmbyten por dalin jashtë loje dhe zhduken sepse: ose u përmbyten tokat, ose u ndërpriten rrugën me qendrën administrative, u mungon komunikimi me pjesën tjetër, është e pamundur të riorganizohen me kushtet e sotme me të cilat ballafaqohen fshatrat shqiptarë në zonën verilindore të vendit.

Popullsia gjithsej sipas regjistrit të zyrës civile dhe planeve të zhvillimit të vetë ish-komunave midis viteve 2005-2008, ishte 41558 banorë nga afro 80 mijë banorë në rang të Bashkisë Dibër (nga regjistrimi i censusit 2011 për këto 9 njësi administrative janë 29104 banorë). Natyrisht, në vitin 2022 ky numër është akoma më i vogël nëse ndjekim logjikën e migrimit masiv nga zonat malore drejt zonave fushore të vendit apo dhe emigrimit jashtë vendit. Kjo shifër, përafërsisht, në vitin 2022, për 9 njësitë administrative që morëm në analizë, është mes 15-20 mijë banorë.

Ndikimi i ndërtimit të Skavicës është për më shumë se 40 mijë vetë (që preken me dëmtimin e pronës, humbjet e lidhjeve familjare, kontaktet, bizneset etj), kurse që shpërngulen plotësisht është gati gjysma e tyre, afro 20 mijë vetë.

Pjesa që mbetet e paprekur, detyrohet të largohet vetvetiu pasi janë fshatra malorë pa të ardhme, me pak tokë bujqësore dhe larg qendrës urbane e administrative, larg shkollave, larg spitaleve, pa infrastrukturë rrugore e pa shërbime.

Shfuqizohet e gjithë veprimtaria e deritanishme në bujqësi, ku është derdhur djersë e gjak për ndërtimin e qindra kilometrave kanale, sistemimin e tokave, pyllëzime artificiale etj, një punë heroike ndër breza, e cila nuk ka çmim.

Në kushtet kur shkenca ka parashikuar që thatësira do të rritet gjatë këtij shekulli, është e pafalshme të bazosh perspektivën e energjisë së vendit vetëm nga hidrocentralet. Ndaj duhen gjurmuar alternativat, si energjia solare, ajo e erës etj, të cilat kanë më pak kosto, janë të pashtershme, e nuk sjellin dëme të tilla në mjedis e në ekonomi sikurse "Skavica".

Skavica, sipas pretendimeve të zyrtarëve, përmirëson sistemin hidroenergjetik të vendit me maksimumin e vet 10-12%, ndërkohë që humbjet në rrjet si pasojë e abuzimit, vjetërsisë së teknologjisë, keqmenaxhimit, problemeve në sistemin e shpërndarjes etj, shkon nga 18-30%.

Marrë nga gazeta "Sot". Botohet me shkurtime. Shkrimin origjinal e gjeni në: **https://tinyurl.com/45aa9htd**

SHËNIME



Kush po i vjen Radikës...

Nga **EDI LESI**

Është hera e tretë që shtatoret e heronjve të kombit na përcjellin me indiferencë në bulevardin e blinave të Peshkopisë, në fushatën tonë të vendosur për të gjetur shpirtin e këtij qyteti, ata trubadurë bohemë tek të cilët qëndrojnë tiparet e një komuniteti të vogël.

E kërkuam më kot vëmendjen e shtatoreve edhe në 4 të mëngjesit, edhe një natë më parë, kur qemë fillthi aty, e sot që është e Djelë, ngjan përpjekje e dëshpëruar pasi ka shumë njerëz që e kanë mbushur deng në dy anët këtë shëtitore të fiksuar herët në memorie, prej atyre kartolinave të vjetra të vitit të ri.

Patëm fat. Trubadurët, këngëtarët e poetët e kësaj ane, na gjetën, erdhën tek ne, në darkën bujare te Nëna Dashuri.

I prin Agim Skara, virtuoz. Prej tij rrjedh natyrshëm epika me qendresë e barut, e po aq serenata korçare e jaret e Shkodrës.

Bën sot 67 vjeç, po e marrim vesh rastësisht. Nuk kërkon vëmendje, do të na argëtojë e krijojë atmosferë.

Jemi nis për Dibër, duke e lënë metropolin në shemrinë e përietshme mes atyre që s'kanë e atyre që duan më shumë.



Është një sinor perskaj Tiranës e destinacionit tonë, kur kalon Shkallën e Tujanit, tejet poroz. Aty ku Dibra vjen me nxitim e kryengulthi sikur pret prej një jete, e ku kryeqyteti shtriq me bezdi gjymtyrët e Lindjes. Nuk ka tabela, e kur për herë të parë e bën këtë rrugë nuk e merr vesh mirë në atë zonë kaq të bukur, si prej filmit Lord of Rings, nëse ato fshatra të paket e te rregjuar, hedhur anës me dorë El Greko-je, janë të Tiranës, apo të Dibrës.

Rruga e Arbrit ka leshuar shtat si krijesë mitologjike në disa pjesë, e në disa, shtigjet me asfalt ngjajnë si ai peri përtac që mënon të zërë vend në kokën e gjilpërës.

Sugjerim i mirë që ta nisim ngjitjen e Qafës së Murrizit me këngen e Djemve të Detit, 'Jo tani', sjellë fuqishëm prej Aleksadër Gjokës e Aurela Gaçes.

Në hyrje të Klosit, marrim një kafe të shpejtë në një lokal të madh, buzë lumit Mat. Karriget e veshura tebdil për salla dasmash, ngjajnë të ngrira ç'prej moti.

'Veç n'u martofsha vetë', thotë Bujari, përtej banakut. Nuk ka ngel më njeri këtu, për të bërë gosti të mëdha, pohon ai. Bosi është Veliu, i cili kujdeset për nipat.

Është shkurtuar distanca për Peshkopi patjetër, por ekzistuesja të sjell një lodhje që duhet trajtuar me kafe e raki kumbulle, në atë kërthizë të këtij polisi, ku baret flirtojnë me emrat e qendrave më të mëdha të Europës e botës.

Tek 'Bolzano', na shërben Klodiani, 30 vjeç. Ndryshe nga mijëra të tjerë, vendosi të kthehet pas një qendrimi të gjatë në Durrës e Gjermani. Thotë se nuk e pëlqen më të jetojë në shtëpi me qira, e ja ku u vendos në plëngun e tij.

Eshtë darkë.

Shumë pak frymë në qarkullim.

Dashuria, kuzhinierja e njohur, prej të cilës mban emrin hoteli ku jemi bujtës, po bën zhurmë të këndshme në kuzhinë.

Ne që mendojmë se kemi ardhur luginës heroike, kemi shkelur kodrave ku është bërë luftë e janë shkrehur pushkë me mbrojt vatanin, mezi presim të dëgjojmë live, kengen e Hajredin Pashës. Atë këngë që bën kudo, të madh e të vogel, të ngrihet në këmbë.

Ja ku Radikës i vjen, pikërisht Agimi.

Motivi; zgjata unë dorën të prekja ty, i Djemve të Detit, do na lërë tani.

Jemi në një rend të ri. Nuk ndalet dafrunga deri në orët e para të mëngjesit. Dëgjohet shpesh urdhri, anëtarë të të cilit jemi; Nata sapo ka filluar.

E përhime është Peshkopia të nesërmen, dhe një vend i mirë për të pirë kafen e bekuar të mengjesit, ish-turizmi. Endri, 15 vjeç, vallëzon nëpër tavolina. Do punoj thotë deri 17, pastaj do iki.

Qytet i bukur për moshën e tretë, shpall Halili, pensionist. Sak, pak të rinj ka.

Çfarë po i vjen Radikës, nëse energjia po i ikën.

3 orët në kthim, janë një kantilenë nën re. Dibra e heshtur në sqetull të Korabit është më afër, me gjithë zakonet e bukura, sidomos me jufkat.

(Marrë nga profili në Facebook i autorit. Fotot janë të autorit)

Rruga e Arbërit nr. 197

SHËNIME NGA FIRENCE

Shungullime malli dhe dritëhijet e kohës

Nga **SELMAN MZIU**



Në foto: Selman Mziu dhe Haki Përnezha

Ecja i menduar, pasi zbrita nga autobusi urban. Koka më shungullonte. Trotuaret ishin me gurë të skalitur. Kujtesa më çoi atje, te vendlindja. Te ato blloqe mermeri që skaliteshin nga muhuraku, brezhdanasi, luznaku, çidhnaku deri te bellovasi dikur patateprodhues. Ato nuk janë ma. Edhe unë veç lëshoi kamerat e kujtesës. Miniera më shfaqet si një përbindësh prehistorik i zgavëruar nga tretja, kalbëzimi. Nuk do të kalojë shumë kohë dhe uji, bashkë me llumin, baltën e kuqe do t'a mbulojnë. Po, kuota 443 m ashtë vendosur në projekt. E shkruar e zezë mbi të bardhë. Projekti asht gati. Dibranët në gjumë, ose të çarë në një mijë ashkla. Unë tani jam te sheshi "Republika" në Firence, Itali. Poshtë një dere me hark gjigant. Mijëvjeçarët veç e zbukurojnë. Unë, shqiptari i vogël, e vështroi çuditshëm.

Ulem në tavolinë me dy djelmosha, ndërkohë përqafoi fort Hakiun. Ky mysafir më ftoi mua për një kafe. Nuk e di pse i dua e admiroj pa kufi këto njerëz me emrin Haki. Ndoshta ndonjë emëruesi i përbashkët. Ndoshta fuqia atomike e disa elementëve të Mendjelevit. Ndoshta ngarkesa pozitive e elektroneve. Ndoshta shpirti dhe zemra e ndjejnë thellë dashurinë për dijen. Karriget, tavolina, kafeja e trupi im që dridhet pak sa. Ndoshta emocionet. Ndoshta buzëqeshja lulezonje e Përnezhës. Ndoshta fjalët e tij të ngrohta, mbushur me nektar përkujdesje, çiltërsie, dashurie të sinqertë. Ndoshta ujëkthjellti Drini i Zi, që i lirshëm udhëton e na bashkon. Po, tani, se më vonë vargonjtë do t'ia hedhin. Mjerisht. Fatkeqësisht. Dikush nuk arrin t'a kuptojë. Dikush pëlqen strukjen. Një tjetër kërkon të shtrëngojë fort lavdinë apo karrigen. Të tjerë kanë mbetur si pula të trullosura..

I qeshur pranë meje Hakiu, historian. Projektet e tijë. Piketat e studimeve historike. Shpurpurosen mendime autorësh shqiptarë e të huaj. Mirëpo kërkon, atje te trualli i ngjarjes, të gjejë fijet lidhëse. Toponime, kujtime, legjenda, rite, zakone. E kërkon epokat t'i lidh me mjeshtëri, këmbënguljesh në fakte. Unë dëgjoj i emocionuar nga gëzimi, nga malli që më merr për vendndodhjet e Kishave të Shenjtores Mari, të Gjergjit, Salvadorit (Shpëtimit), Dimitreos, Vasilit, Shën'tat. Balli me ndriçon nga lumturia që më zbut dhimbjet e trupit. Më shërojnë emra të tillë. Më miklojnë kujtimet e vegjëlisë. Më rritin besimin për t'i materializuar në letër edhe unë diçka për krahinën e Muhurrit ku shkulmon historia.

Por një mizë e jeshiltë, siç e përsëriste babai kur ndiente rrezik, po i sillet akolles (rreth e rrotull). Diga. Skavica. Fundosja në ujë. Po, pse? Për prodhim energjie, sigurisht. Që të shpëtojë fshatrat e Shkodrës. Edhe kjo e shkruar në projekt. Po dheun tim kanë ato. Po në mijëvjeçarët ma mori uji nga kodrat e Shumbati, nga Draj Reçi, nga Hoteshi, Ushtelenxa, Zimuri, Gjorica e Poshtme e kështu në pafundësi. Ne i mbrojtëm nga serbi e turku e derdhëm gjak. Po ne duhet të vdesim, të zhdukemi, që të shpëtojnë ata. Ah, qeveri mushkonjash! Ah, kohë e hakmarrjes mizore! Tani nuk ju duhem ma. Varroseni, ka mbetur shterp Dibra, thonë ato, qeveria e bandillave barkdhjamosur. E lotët më bien në pllakat e gurit te sheshi "Republika". Nuk bien e të treten mbi tokën time. Jo, se ashtu deshën ato që përgatitën varrosjen time. Po edhe të varreve. Edhe të shpellës Zgjorgj, ku u gjet sopata prej guri e eshtrat e një gruaje mijëra vjeçare. Po, u ba kurban edhe ajo. Edhe mua e qindra mijëra buzëdrinasve po na bëjnë e na kanë bërë kurban. Po eshtrat e mia ku do gjinden?!

Eh, dibranët e mi! Eh, Haki kërkimtari, i pa lodhuri i etnokulturës, traditave e historisë dibrane! Kemi ramun në hekurat qark të kohës. Disa tallen. Disa qeshin me ne. Disa kanë zgjedhur mjerimin e një populli e mbi këtë kanë ngritur lumturinë e vetë. Të bëjmë ç'është e mundur për veten tonë, që të rifitojmë buzëqeshjen. Për brezat e ardhshëm që të ngrenë ngrehinën e jetës. E lumit Drini i Zi të mos e zhdukim, burgosim, tradhëtojmë.

Ndahemi me mikun tim dhe të Firences, Hakiun. Korrëm mendimet e njëri-tjetrit. Kënaqësia na lehtësoi. Fytyra e shpirti na buzëqeshi. Mallimi u shua. Por jo i gjithi. Të sotmen t'a jetojmë, të ardhmen t'a ëndërrojmë. Të përpiqemi të projektojmë atë.

Mirë u pafshim herë tjetër, këtu ku kam trupin ose atje ku më kanë mbetur rrënjët.

KËRKOHET GAZETAR/E

Kërkohen një gazetar/e me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603.** E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

komente



Përse nuk e shikoj Big Brother VIP?

Nga **AFRIM KAROSHI**
jashtekornize.al

Nuk kisha menduar se do të më duhej të shkruaja rreth një programi televiziv, aq sa ç'kam shkruajtur këto kohë për Big Brother.

Por kam shkruar, sepse, dukshëm, programi është kthyer në një dritare mediatike, në të cilën edhe pasqyrohet kultura e tanishme shqiptare, por edhe shfytyrohet, në një formë që kërkon reflektim.

E kur, shumë shqiptarë, i lënë makinat në garazh e ulen përpara ekranit për të parë programin, lypset një lloj sqarimi se përse unë, nuk e parkoj makinën fare për programin.

Ndoshta, në listimin e arsyeve, mund të gjej ca të tjerë si puna ime të ndihmojmë njëri-tjetrin t'i bëjmë ballë kësaj dalldie të përkohshme mediatike që po çmend dynjanë.

Arsyeja kryesore se përse nuk e shoh programin është mungesa e kohës.

Nuk kam kohë në darkë të shoh fare asnjë program televiziv. Gjatë ditës kam punë si shumë të tjerë. Pasdite, kur kthehem në shtëpi, kam vazhdimisht angazhime familjare. Po mësoj nga e para gërmat e mëdha të shtypit dhe të voglat e dorës me djalin në klasën e parë. Dal e printoj ndonjë projekt për vajzën në klasën e 10-të, dhe mezi pres të lidhem me djalin në universitet, për ta pyetur për ditën andej ku është.

Kur vjen ora e programit - e kam fjalën për të martën e për të shtunën - më ngatërrohen klasët me fëmijët, e mezi mbaj mend se kush është ku. Prandaj, përtoj të ngrihem nga dhoma, ku më kanë rënë kockat rehat, e të shkoj të ndez televizorin në dhomën e ndejtes.

Meqë ra fjala, se u kujtova, më prisni një minutë, sa ta shoh, a më punon televizori akoma apo është prishur?

....

Nuk më punoka televizori. Më saktë, dekoderi tokësor nuk punon. Na duhet të blejmë një televizor tjetër. Ose dekoder.

Arsyeja e dytë se përse nuk e shoh Big Brother VIP është, se nuk paskam dekoder.

Më duhet të dal të blej një dekoder tjetër, e nuk kam kohë ta blej. Ndoshta nuk dua të harxhoj para. Atëherë, nga fillimi i procesit të digjitalizimit, thanë se këto dekoderat janë falas, por as atëherë nuk u interesova se kishte rradhë të madhe. Dhe, e fika televizorin, sapo procesi i digjitalizimit po ecte me ritme të kënaqshme.

Arsyeja e tretë, që bie më shpesh në sy, është, se programi, sillka një pamje të kulturës shqiptare në pah, por unë nuk ia kam nevojën kësaj pasqyre.

E besoj këtë. Se programi pasqyron shqiptarinë, njëfarësoj. Por unë, nuk kam nevojë për pamjen që sjell ky program për të kuptuar kulturën shqiptare.

Kam vite, që e analizoj me shumë kujdes kulturën shqiptare.

Ne shtyjmë, shajmë (kryesit pas krahëve), vishemi ndryshe për PRIME, e ndryshe e kemi zemrën pas kuintave. Ne të shajmë e të kritikojmë, e pastaj të japim të drejtë, se na ndodh dhe neve siç të ka ndodhur ty, por s'kemi guxim të kërkojmë falje. Larg qoftë ta ul unë veten për të kërkuar falje dhe kur e kam gabim! Është dobësi! Pastaj të duam, e më vonë të harrojmë, sot vdesim për ty, nesër nuk na duhesh. Të marrim në telefon kur na ka rënë një hall, e të kritikojmë për sjelljen tënde, kur të kanë rënë ty halle mbi kokë. Vetë ia solli vetes gjithë këto telashe!

Ne shtyjmë, shajmë (kryesit pas krahëve), vishemi ndryshe për PRIME, e ndryshe e kemi zemrën pas kuintave. Ne të shajmë e të kritikojmë, e pastaj të japim të drejtë... Sot vdesim për ty, nesër nuk na duhesh. Të marrim në telefon kur na ka rënë një hall, e të kritikojmë për sjelljen tënde, kur të kanë rënë ty halle mbi kokë.. E kemi vdekje, në kuptimin, që vdesim duke kërkuar dashuri, e s'kemi guximin të bëjmë diçka për të sakrifikuar për dashurinë.
Ne, shqiptarët, duam gjithmonë të marrim pjesë në një lojë ku fiton më i miri. E pastaj, nuk lëmë gjë pa lëvizur, që më i miri të dalim vetë...

Shqiptarët të shtyjnë, bëjnë sikur s'të kanë shtyrë, dikujt ia rrëfejnë se kanë bërë mirë që të kanë shtyrë, e dikujt i thonë "për Zotin, nuk kam gisht unë në këtë shtyrje." Shqiptarët bëjnë gjithçka e sillen sikur s'kanë bërë asgjë!

Dhe dashurinë, ashtu si në televizor, shqiptarët - domethënë ne - e kemi vdekje. E kemi vdekje, në kuptimin, që vdesim duke kërkuar dashuri, e s'kemi guximin të bëjmë diçka për të sakrifikuar për dashurinë.

Ne, shqiptarët, duam gjithmonë të marrim pjesë në një lojë ku fiton më i miri. "Le të fitojë më i miri", themi publikisht. E pastaj, nuk lëmë gjë pa lëvizur, që më i miri të dalim vetë.

Ne e kemi vendosur, që në fillim të garës, se më i miri, jemi vetë. A ke dëgjuar dikë të pranojë krejt natyrshëm se dikush tjetër, në atë fushë ku lëmon ky personi, të pranojë se ka një më të mirë?

A mjaftojnë këto arsye për të mos e parë programin?

Nuk besoj se lipset më shumë shpjegim.

P. S. Ndërkohë që mbarova këto shënime, të cilat i kisha nisur prej ditësh, tre gra janë vrarë sot, shumë afër qendrës së qytetërimit modern shqiptar. Dhe kontrasti mes një programi televiziv që rreket të tregojë personalitetin e ca njerëzve të rëndësishëm, realitetit mediatik shqiptar dhe realitetit të vrazhdë, ku vdesin njerëz të cilët nuk duhet të vdesin, pothuajse nuk ekziston.

reportazh

Nga Dibra në Dibër, përmes Trebishtit, Gjinovecit, Steblevës, Llakaicës…



Ky vend ka nevojë edhe për më shumë investime. Shteti duhet të investojë që këtij vendi ti vijë pak "erë" nga shekullit XXI dhe jo mesjetë

Nga: **FITIM DIKA**

Tre dibranë dashamirës të historisë, traditës, kulturës dhe normalisht maleve të Dibrës, Butrint Sela, Brezar Dibra dhe Fitim Dika, fundjavën e parë të 2023 vizituan pjesën jugore të vendlindjes së tyre ose Malet e Kuqe, që tashmë ndër popull njihen me emrin ruso-sllav Jabllanicë-Shebenik.

Pasi gjerbën ekspresin në kafen Retro 2, tre bjeshkatarët me arushën e maleve Jeep Grand Cherokee nisen drejt këmbimores për të këmbyer ca dollarë e denarë në lek dhe më pas drejt kufirit rajonal Xhepisht-Trebisht, ku na pritsin dy policë, disi të lodhur nga vetmia, përkundër ajrit të pastër që mbizotëron aty. Është kufiri i hapur në kohën e Nikola Gruevskit dhe ku mendohet se po nga kjo rrugë është larguar drejt Hungarisë.

Pas kalimit të kufirit arritëm në Trebisht ku një flamur i zbehtë shqiptar valonte afër shkollës në qendër të fshatit. Aty gjetëm një plak dhe shumë kafexhi, ku duheshim të pyesnim se, a mund të shkonim lirshëm drejt Klenjës nga Gjinoveci i braktisur. Plaku i urtë pasi pa veturën dhe gomat e saj off-road tha se mund të dilni, por kini kujdes se rruga është copë-copë.

GJINOVEC

Nisëm përpjetëzën me kthesa deri 150 shkallë, ku vërtet rruga ishte si mos më keq, por kjo edhe e "arsyeshme" pasi në Gjinovecin me dy kisha nuk pamë shtëpi me tym dhe asnjë banor. Nëpër varrezat e mesfshatit kishte ca kryqe dhe emrat nënkuptonin se këtu jetonin edhe minoritarë ortodoksë sllavë. Poashtu, në kishë ishte shkruar diçka në alfabetin cirilik. Në dalje të fshatit pamë dy barinj dhe ca dele që kullotnin, tipike e Shqipërisë, ku në çdo zgrip mali përsëri takon ndonjë person. I pyetëm për fshatin dhe si ndjeheshin, kurse përgjigjeshin, se ishin "minoritarë bullgarë", duke i nënkuptuar se kishin marrë së fundi "pasaportën bullgare".

Dikur kjo zonë mbahej shqiptare, pas pluralizmit anonin më shumë nga maqedonasit, kurse së fundit gati të gjithë ndjehen bullgarë.

KLENJË

Pasi kaluam Fushë-Klenjën, ku një lum pasi lëvizte i vetmuar humbiste në thellësitë e maleve, ngjashëm si lumi në Fushën e Panairit - Korab, të tre arritëm në Steblevën e tokave të Ataturkut. Një lum që përfundon mes shkëmbinjve për të dalë e buruar tjetërkund!

STEBLEVË

Aty gjetëm një bar-kafe tipike e fshatit, ku një burrë na priti përzemërsisht duke na sjellë kafe. Ai na gostiti me hallvë. Mikpritje e veçantë, ku pasi mori vesh se ishim nga Dibra e Madhe, nuk na i mori paratë. Jetojmë prej shumë vitesh në kryeqendra europiane, por rrallë ose asnjëherë nuk ndodh që pronari të qerasë nikoqirin e sapo njohuar në kafe. Vlerë e fshatit, prapambeturi e kryeqendrës.

Më pas erdhën edhe ca banorë të tjerë të fshatit dhe biseduam. Në pyetjen për kishat në Gjinovec, ata thanë se aty janë gjetur ca dorëshkrime 200 vjeçare, se kishat janë bullgare. E kuptuam edhe më tepër se ndikimi bullgar këtu ishte më i fuqishëm sesa i sllavëve të tjerë.

LLAKAICË

Për të mos humbur shumë kohë, grupi nga Stebleva niset drejt "Green Pass" për të kaluar "ilegalisht" kufirin në Maqedoninë Veriore. Pas disa vështirësive në ngjitje me off-road, arritëm në një pllajë ku një pemë ishte rrëzuar në mes të rrugës sikur tregonte se mbaroi Shqipëria dhe fillonte një shtet tjetër. Pak metra më tej ndodhej piramida e famshme e ndarjes mbrapsht të kufirit, kur disa dhjetëra metra më tej një postë kufitare ish-jugosllave për të mbrojtur kufirin nga banorë me tipare dhe mbase gjen të njëjtë.

Dikur këtu lëviznin dhjetëra ushtarë jugosllavë e shqiptarë për të ruajtur kufirin, sot s'ka as udhëtarë për ta ruajtur dhe as polic!


Llakaica (Llakavica) ndodhej më tutje dhe rruga ishte e ndarë veçmas. Nga larg vëreheshin disa shtëpi të saporinovuara, por natyrisht bosh dhe pa asnjë person. Vendosëm të kalojmë nga Llakaica drejt rrugës për të dalë në magjistralen Strugë-Dibër, por ndodhi ajo që kishte vendosur natyra dhe ligji. Rruga në mes ishte derdhur dhe nuk funksiononte më, pasi shirat e rrëmbyeshme të para një muaji kishin nxjerrë jashtë shtratit ujin e lumenjve. Nuk mund të rrezikonim dhe kthyem mbrapsht nga kishim ardhur.

Dikur Llakaica ishte pjesë e qarkut të Steblevës dhe këto të dyja bashkë pjesë të Dibrës. Në këtë udhëtim, natyra sikur kishte dashur me zor rilidhjen e dikurshme mes Llakavicës e Steblevës, përkundër kufirit londinez të 1913. Pak rëndësi nga historia, por kjo zonë do zhvillohet vetëm nëse kufijtë anullohen, por natyrisht, së pari të rregullohen rrugët me asfalt.

FUSHË STUDËN/ORENJË

Fati jonë dhe i Llakavicës në javën e parë të 2023 ishte Stebleva dhe kthimi nga Qafa e Thanës. Nga Stebleva arritëm në Fushë Studën, ku liqeni ishte vërtet i bukur në mes të natyrës magjepsëse të pyjeve të ahut. Nga aty kaluam drejt fshatit Orenjë të Hafiz Sabri Koçit, rimëkëmbësit të madh të fesë myslimane ndër shqiptarë.

Mali që përmendet më së shumti ndër mediat perëndimore, është Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë. Në këtë park gjendet një pasuri e madhe e florës dhe e faunës. Shumë bimë si murrizi, boronicat, dredhëzat e egra, ndodhet me shumicë në këtë zonë. Edhe në librat e Mithat Frashërit, përmenden shumë eksplorues gjermanë, që prej para disa shekujsh, u ka bërë përshtypje bimësia e këtij masivi malor.



Liqeni në Fushë-Studen



Në Klenjë



Piramida që ndan Dibrën

QAFË THANË - DIBËR

Pasi arritëm në Librazhdin me pak rrugë asfalt mes tij dhe Fushë Studenit, shkuam drejt Qafë Thanës, ku pak para se të kalojmë kufirin edhe hëngrëm shijshëm. Polici nga Maqedonia, mbase nga informacioni, mbase nga Jeep-i, na pyeti nëse kishim ardhur maleve. Pas përgjigjes të sinqertë tonën, vazhduam tutje dhe arritëm në Dibër përmes Strugës.

Dibra është e madhe me shumë zona dhe krahina, ku njëra ndër to është Golloborda e fshatrave të lartpërmendur. Nga kjo zonë kanë origjinën figura të njohura si Hoxhë Moglica, Qemal Stafa, Dritan Hoxha, - themeluesi i ndjerë i Top Channel, Adnan Ismaili i Shtëpisë Botuese "Logos", Armando Sadiku i Euro2016, e shumë të tjerë. Ky vend ka nevojë edhe për më shumë investime. Shteti duhet të investojë që këtij vendi ti vijë pak "erë" nga shekullit XXI dhe jo mesjetë, me gjithë ato rruga të paasfaltuara.


Rruga e Arbërit nr. 197

miniera

Shënime të gazetarit: Me rastin e 75 vjetorit të minierës së Bulqizës

Bulqiza ndërtoi Shqipërinë, por ajo e harroi atë

Bulqiza, masivi më i madh kromëmbajtës, bashkë me Batrën, i jepte Shqipërisë një milionë tonë krom në vit. Por Shqipëria nuk i dha asnjë kacidhe, që jeta atje, jetë mbi flori, tu jepte banorëve të saj zhvillimin më të begatë në vend.



Mes njerëzve të kromit. Foto: A.Ashiku / Arkiv

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Një historian i huaj shkroi se "Po të digjej Stambolli Dibra e ngre nga themelet, por po të digjet Dibra Stambolli kthen kokën pas …"

Kështu ka ndodhë edhe me Bulqizën, masivin më të madh kromëmbajtës që bashkë me Batrën (një trung kromi) i jepte Shqipërisë një milionë tonë krom në vit, por Shqipëria nuk i dha asnjë kacidhe që jeta atje, jetë mbi flori, tu jepte banorëve të saj zhvillimin më të begatë në vend.

Një fotografi nga arkivi im me njerëz që me ta e kam jetuar Bulqizën në nëntokën e saj të begatë dhe në malet ku kërkohej krom, më ktheu shtatëdhjetë e pesë vjet të shkuara, atëherë kur një ditë shkurti të vitit 1948 mori rrugë miniera e kromit dhe u ngrit me baraka druri mbi truall të gurtë ai që do të njihej në botë si qyteti i Bulqizës…

Kërkova dhe midis blloqeve që "aksidentalisht" më kanë shoqëruar në mërgim, gjeta disa faqe shënimesh për Bulqizën në kurbën e rritjes vit pas viti, asaj kohe kur kromi i saj përcillej për tu kthyer në flori, valutë që ndërtoi Shqipërinë, por nuk ndërtoi kurrë Bulqizën…

Hapa e përcolla fletë pas flete një libër të Ymer Ketës, shkrimtar e publicist, studiues e historian, "Heronjtë e nëntokës", një enciklopedi ku lëvrijnë galerive të minierës e sondave të kërkimit të kromit heronj të mëdhenj të një kohe që nuk është larg në vite, por lënë larg në kujtesë…

Xhavit Hatibi dhe TodoManço, njeri drejtues minierash e ndërmarrjesh nafte të mëdha e tjetri inxhinier i talentuar i minierës së Bulqizës, Hero i Punës Socialiste, shpirti binjak i kromit, në krye të tridhjetë minatorëve të ardhur nga Rubiku e Dibra, ndezën më 18 shkurt 1948 fitilat e parë, e mali i Duriçit u zgjua për të mos bërë gjumë kurrë, ditë e natë.

E poeti popullor këndoi ndër dhjetëra vjeçarë mbi telat e çiftelisë…

Guri i kromit, gurë me xixa,
Vrapoi bota tek Bulqiza.
Guri i kromit, gurë i Zi,
Gjithë bota na ka Zili,
Gur e shkrepa
Të Zi me xixa,
Mbretëresha jonë,
Është Bulqiza…

Po, Bulqiza me të vërtetë do të bëhej Mbretëreshë, pioniere e madhe e nxjerrjes së kromit, nënë që do të hapte krahët e do të shtrihej në vite drejt Batrës, Krastës, Theknës, Selishtës, Cerujës, Tërnovës…

Atë vit të parë nga galeritë që u hapën Bulqiza i dha vendit, eksportit shqiptar, floririn e 10.432 tonëve krom për tu ngjitur gradualisht në 40 mijë tonë në vitin 1950, në 122 mijë në vitin 1955, në 220 mijë tonë në vitin 1960, në 420 mijë tonë në vitin 1985… (Nga blloku i shënimeve)

E gjithë kjo vlerë e krijuar me mend, djersë e gjak shërbeu për tharjen e kënetave nga Buna në Bistricë për të përfituar dhjetëra mijëra hektarë tokë që u bënë hambar i Shqipërisë, për ndërtimin e veprave të mëdha të bonifikimit e ujitjes, uzinave e fabrikave në të katër anët e Shqipërisë. Nuk ka vepër e pëllëmbë të tokës shqiptare pa floririn e nxjerrë me sakrificat ekstreme të minatorëve të kromit…

Në vitin 1955 në Bulqizë erdhi për të drejtuar minierën inxhinieri i talentuar TodoManço, njeriu që shkriu jetën për kromin e markës shqiptare, e në respekt për të miniera mori emrin, Miniera e Kromit "TodoManço"-Bulqizë.

Vitet '60-'70-të ishin vitet e zhvillimit intensiv në thellësi e gjerësi të Bulqizës e të masivit krommbajtës, pjesë e një trungu. Zona D, Pusi 2, Batra, Krasta, Thekna, Tërnova, Shkallë-Cëruja, Selishta… bashkë do ta ngjisnin nxjerrjen e mineralit të kromit nga 289 mijë tonë në vitin 1960, në një milionë tonë në vitin 1980 e në një milionë e dyqind mijë tonë në vitin 1989. (vjetari statistikor 1991).

Bashkë do ta radhitnin Shqipërinë në vendin e tretë në botë për nxjerrjen e mineralit dhe në vendin e parë për frymë të popullsisë…

Gjeologët e Bulqizës, pas ikjes së rusëve, u bënë zëri i së ardhmes së Bulqizës, kërkimi dhe zbulimi i kromit drejt thellësive dhe gjerësive. Miniera e re e Batrës do të merrte emrin e "11 heronjve" të gjeologjisë që humbën jetën në kërkim të kromit. Dy herë Çmimi i Shkallës së Parë të Republikës (Sefedin Qorlaze) do të festohej midis gjeologëve të Bulqizës për zërin e veçantë që dha gjeologjia jonë për të ardhmen e kërkimit dhe shfrytëzimit të kromit.

Bulqiza në vitet tetëdhjetë do të shtrihej në punime të mëdha kapitale. Dy traverbankët e Klosit dhe Rampa e Qafës së Buallit nisën udhën drejt Nivelit të Pestë, i pari me sistem transporti elektrik, kurse i dyti me zbritje e ngjitje me kamionë. Në dalje të traverbankëve u ngrit fabrika e pasurimit të kromit ndërsa, poshtë, në Klos mori formë stacioni i fundit i trenit dhe hekurudha po shtrinte shinat e saj. Në të njëjtën kohë nga Bulqiza, drejt Selishtës një traverbank tjetër ndërtohej për të marrë kromin e Balgjajt dhe të Selishtës…

Në Burrel u ngrit uzina për shkrirjen e kromit…

A duhej gjithë ky investim në kushtet kur ekonomia e vendit ishte e sëmurë?

Mbase po…

Mbase jo…


Një debat që duhet ta bluajnë imët në mullirin e gjykimit specialistët.

Nuk u gjykua atëherë, mbase nga "uji në gojë" hedhur nga regjimi i kohës.

Nuk u gjykua as kur "goja u hap një pashë" e specialistët, ata që e kishin ngritë me duar e me dhëmbë minierën mbetën në këndin që formon rruga që bashkon Bulqizën e Vjetër dhe të Renë me rrugën paralel me Pallatin e Kulturës.



Në foto: A.Ashiku mes minatorëve të Pusit 2. Foto: A.Ashiku / Arkiv



Gëzimi i gjeologëve kur sonda takon në krom. Foto: A.Ashiku / Arkiv

E kam në sy e në shpirt pamjen dhe gjendjen shpirtërore të Jorgo Kolës, inxhinierit gjeolog të minierës së Bulqizës, njeriun që i njihte thellësitë e kromit më mirë se kushdo, njeriun që i dha jetë (dhe i jep edhe sot me testamentin profesional që ka lënë) nxjerrjes së mineralit të kromit. Diçka në biografi do ta shuante meritën e tij të ishte Hero i kohës. Në pleqërinë e tij Jorgo Kolën, nga mëngjesi në mbrëmje, në ditë me diell e me acar, do ta gjeje në atë kënd rruge, me shpinë kthyer nga miniera tek shiste paqeta cigaresh, çamçakëzë…për të përballuar vitet e pleqërisë.

Këtë portret do të kishte edhe miniera, edhe nxjerrja e kromit, edhe qyteti i Bulqizës, që ndonëse me themele në flori ishte dhe është qytet gjallë – vdekë.

Kur u ndamë minatori i kromit mbeti me duar në xhepa të grisur. Bulqizaku as tokë kishte për të punuar, as punë kishte për të nxjerrë bukën e ditës, as përkrahje për ta mbajte jetën gjallë…

Minatori që dilte në pension me 10 vjet punë nëntokë, në moshën 50 vjeç, me pensionin më të madh për kohën, përjetoi tragjedinë e njerëzve të harruar, ashtu siç përjetoi edhe qyteti tashmë në duar ujqish të pa ngopur.

Dua të shkruaj shumë për minatorët dhe gjeologët e Bulqizës, këta heronj të mëdhenj të kombit…

Shënimet e mija në këtë 75-vjetor të rrugës shqiptare të kromit do të desha që të vijonin me kujtime e vlerësime të asaj dhe kësaj kohe, nga njerëz emrat e të cilëve i kam në mendje dhe u ulem në gjunjë me respekt për vlerat e mëdha që dhanë.

Nuk e di se çfarë do të ketë më 18 shkurt në Bulqizë…

Festë (?) apo protestë (?) !

Mbase më 18 shkurt 2023 Kuvendarët e Shqipërisë do të ngrenë dorën lart njëzëri për të miratuar "Statusin e Minatorit".

Ua kanë borxh, një borxh që ndjek borxhin e s'paguhet dot kurrë…

Athinë, 12 shkurt 2023.

Njoftim për shoqata dhe organizata joqeveritare

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibrën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre.

Kostot e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot e botimit të gazetës.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603** ose shkruani emailit: **rrugaearberit@gmail.com**

cyan magenta yelloë black

speciale

Prof. **Adem Bunguri** zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave

Profesor Adem Bunguri zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në mbledhjen vjetore të Asamblesë së Akademisë së shkencave që u zhviluar më datë 6 shkurt 2023, u votua edhe për anëtarët e rinj të Akademisë, ku prof. Adem Bunguri u votua si anëtari më i ri në fushën e shkencave albanologjike.

Prof. Adem Bunguri ka formuluar dhe argumentuar shkencor për të parën herë hipotezën anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit "kurgan", që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Kjo hipotezë e re, ka përmirësuar ndjeshëm dinamikën e proceseve të formimit të kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri, substrati mbi të cilën u zhvilluan më vonë proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire.

Prof. Bunguri vlerësohet sot si studiuesi më aktiv dhe më i suksesshëm në arkeologjinë shqiptare, si një nga studiuesit më të përkushtuar dhe produktiv të 10-vjeçarit të fundit në fushën e arkeologjisë prehistorike. Vlerësohet për maturinë shkencore dhe për formulimin e përgjithësimeve të rëndësishme lidhur me protogjenezën e shqiptarëve dhe indoeuropianizimin e rajonit.



Prof. Adem Bunguri gjatë një leksioni në Akademinë e Shkencave në mars 2022, mbi rivlerësimin e hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova.

TIRANË, 6 SHKURT 2023. - Profesor Adem Bunguri zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në mbledhjen vjetore të Asamblesë së Akademisë së shkencave që u zhviluar më datë 6 shkurt 2023, u votua edhe për anëtarët e rinj të Akademisë, ku prof. Adem Bunguri u votua si anëtari më i ri në fushën e shkencave albanologjike.

Bunguri u vlerësua me titullin Akademik pas një pune të gjatë në fushën e arkeologjisë në Shqipëri, duke sjellë fakte të reja në këtë fushë.

Kërkimet e tij arkeologjike në Kosovë dhe në Shqipëri si dhe duke bazuar në të rejat më të fundit shkencore në botë të kësaj fushe, argumentoi shkencërisht për herë të parë hipotezën anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit "kurgan", që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Kjo hipotezë e re ka përmirësuar ndjeshëm dinamikën e proceseve të formimit të kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri, mbi të cilën u zhvilluan më vonë proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire.

Adem Bunguri, i lindur më 10 mars 1054 në Grevë të Dibrës, nuk i është ndarë studimeve në fushën e arkeologjisë që nga viti 1982, kur kryen specializimin pasuniversitar pranë Qendrës së Kërkimeve Arkeologjike (më vonë Instituti i Arkeologjisë) të Akademisë së Shkencave Tiranë. Që nga viti 1983 punon si arkeolog në Departamentin e Prehistorisë të Institutit Arkeologjik, në vitet 1983-2003 në Bërthamën Arkeologjike të Peshkopisë, ndërsa nga viti 2004 e në vazhdim në Institutin e Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Në vitet 1984-1986 mbron shkëlqyeshëm të gjitha provimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, përfshirë edhe atë të gjuhës angleze. Në vitet 1987-1989 kryen gërmimet e para arkeologjike në vendbanimin prehistorik të Topojanit (Dibër) që shërbyen si bazë e përgatitjes së disertacionit të fazës së parë të kualifikimit pasuniversitar.

Në vitin 1991 ka mbrojtur me vlerësimin "shkëlqyeshëm" në Departamentin e Prehistorisë të Institutit të Arkeologjisë disertacionin me temë "Neoliti dhe Eneoliti në luginën e mesme të Drinit të Zi" për gradën "kandidat i shkencave". Në vitin 1996 fiton me vlerësimin maksimal titullin "Doktor i shkencave", në vitin 2000 ka fituar titullin "Prof. assoc. dr." ose "Mjeshtër kërkimesh" dhe në vitin 2011 ka fituar titullin "Profesor" ose "Drejtues Kërkimesh".

Bunguri ka drejtuar gërmimet arkeologjike në fushën e arkeologjisë prehistorike në rajonin e Dibrës (1986-2011), ku ka kryer disa fushata gërmimesh sistematike në rajonin e Dibrës, si në vendbanimet prehistorike të Topojanit, të Pesjakës, të Manasdrenit, të Blliçes, të kalasë së Peshkopisë dhe të Burimit, si dhe disa gërmime shpëtimi në qendra arkeologjike të këtij rajoni, si në kalanë e Grazhdanit, kapelën e Pesjakës, varret monumental të Zall-Sinës dhe të Kurtbegut , në varrezën e dystë të Sofraçanit etj.

Në vitet 2010-2016, ai ka përfituar qëndrime studimore në DAI (Deutsches Archaeological Institute) në Frankfurt am Main (Gjermani) dhe DAI në Istanbul (Turqi), për të shfrytëzuar bibliotekat e tyre shumë të pasura, që kanë përmirësuar ndjeshëm cilësinë e punës së tij shkencore.

Gjatë qëndrimeve të tij studimore në DAI Frankfurt am Main, ai ka mbajtur leksione



Në terren, qershor 2008, duke drejtuar punimet e kërkimeve arkeologjike në Sofroçan, ku gjatë punimeve për hapjen e Rrugës së Arbërit u gjetën 2 përkrenare ilire.

mbi çështje të ndryshme të Arkeologjisë Prehistorike të Shqipërisë dhe të Kosovës.

Interesat e tij shkencore janë përqendruar në studimin e kulturës së epokës së bronzit në Shqipëri dhe në Kosovë, të lidhur ngushtë me proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor. Kontributi i tij kryesor në këtë fushë studimesh është, pa dyshim, argumentimi shkencor me artikuj, studime dhe prezantime në konferenca ndërkombëtare i hipotezës së tij mbi komponentin anatolian në etogjenezën e ilirëve (2013-2020), në kundërshtim me hipotezën e migracionit "kurgan", që pati mbizotëruar edhe në arkeologjinë shqiptare për afro 60 vjet (1956-2013).

Adem Bunguri vlerësohet sot si studiuesi më aktiv dhe më i suksesshëm në arkeologjinë shqiptare, si një nga studiuesit më të përkushtuar dhe produktiv të 10-vjeçarit të fundit në fushën e arkeologjisë prehistorike. Vlerësohet për maturinë shkencore dhe për formulimin e përgjithësimeve të rëndësishme lidhur me protogjenezën e shqiptarëve dhe indoeuropianizimin e rajonit. Ka botuar mbi 70 artikuj shkencorë në revista arkeologjike në Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Sllloveni, Gjermani Greqi, Poloni, Britani (Cambridge, Oksford) dhe SHBA (Harvard University). Ka marrë pjesë në disa kongrese ndërkombëtare të Arkeologjisë Prehistorike (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut, Sllloveni, Francë, Greqi, Turqi, Gjermani, Poloni, Itali dhe Britani (Cambridge, Oksford) etj.

Kontributi i tij në fushën e arkeologjisë prehistorike pasqyrohet në inkuadrimin e kulturave Neo-Eneolitike të Shqipërisë në grupet dhe komplekset kulturor të Ballkanit dhe atyre të Bronzit të Hershëm dhe të Vonë në arealin Ballkano-Egjean.

Interesat e tij shkencore janë përqëndruar në studimin e kulturës së epokës së Bronzit në Shqipëri dhe në Kosovë, të lidhur ngushtë me proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire në Ballkanin Perëndimor. Ka formuluar dhe argumentuar në pikëpamje shkencore për të parën herë hipotezën anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit kurgan, që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Hipoteza e tij ka ndihmuar në njohjen më të mirë të proceseve të formimit të kulturës indo-evropiane të Bronzit të Hershëm në këtë rajon.

Bunguri ka formuluar dhe argumentuar shkencërisht për të parën herë hipotezën e tri modeleve të ndryshme kronologjiko-kulturor të procesit Neolitizimit të Shqipërisë, mbi bazën e tre impulseve anatolian të Neolitit të Hershëm.

Ai ka formuluar dhe argumentuar shkencor për të parën herë hipotezën anatoliane të migracioneve të Bronzit të Hershëm në Shqipëri dhe Kosovë, në kundërshtim me hipotezën e migracionit "kurgan", që ka mbizotëruar deri vonë në arkeologjinë prehistorike shqiptare. Kjo hipotezë e re, ka përmirësuar ndjeshëm dinamikën e proceseve të formimit të kulturës së Bronzit të Hershëm në Shqipëri, substrati mbi të cilën u zhvilluan më vonë proceset e formimit etno-gjenetik të popullsisë ilire.

Gjithashtu, Bunguri ka hedhur hipotezën e zhvillimit të pavarur metalurgjik gjatë Eneolitit dhe Bronzit të Vonë në Shqipëri & Kosovë. Studimi i rolit dhe vendit të metalurgjisë në zhvillimin shoqëror dhe kulturor të bashkësive prehistorike të vendit tonë nga fillimi i Epokës së Eneolitit deri në fundin e asaj të Bronzit.

Adem Bunguri ka botuar 7 monografi shkencore mbi prehistorinë e Shqipërisë, 4 si autor i vetëm dhe 3 në bashkëautorësi. Ka në poces botimi 3 monografi shkencore mbi çështje të ndryshme të arkeologjisë prehistorike në Shqipëri dhe Kosovë dhe një monografi divulgative mbi etno-arkeologjinë e Dibrës. Është bashkëautor i vëllimeve I-II të veprës "Harta Arkeologjike e Kosovës" (2006, 2012).

Prof. Adem Bunguri ka dhënë edhe një kontribut të rëndësishëm në botimin e plotë të veprës shkencore të Prof. Frano Prendi të përmbledhur në tri vëllime (2008, 2018) si dhe një monografi të Prof. Selim Islami (2013).

Botimi i tij i fundit, "Përkrenaret Ilire në Shqipëri dhe Kosovë" është një përditësim i bazës së të dhënave mbi përkrenaret e tipit ilir në Shqipëri dhe Kosovë si dhe përforcon hipotezëën e Prof. Hasan Ceka mbi atdheun historik të përkrenareve ilire.

Ka udhëhequr një numër të madh mikrotezash të Programeve "Bachelor" dhe "Master Shkencor DND" dhe është udhëheqës shkencor i 3 tezave të doktoraturës. Në vitin 2021 është përzgjedhur nga Komisioni i përhershëm i Historisë dhe Arkeologjisë i Akademisë së Shkencave si autor i tekstit të ri "Historia e Shqiptarëve" (Pjesa e lashtësisë).

Është laurat i çmimit të parë "Dea Dardanicae", që jepet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës, në vitin 2018. Mban titullin "Mjeshtër i Madh", akorduar nga Presidenti i Republikës.

Përgatiti: Bujar Karoshi

cyan magenta yelloë black

VLERËSIME

Zgjedhja e Prof. Adem Bunguri si anëtari më i ri i Akademisë së Shkencave është pritur mirë nga opinioni publik. Disa prej komenteve vlerësuese për profesorin, të shkruara në faqet zyrtare në facebook të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe gazetës Rruga e Arbërit, po i sjellim më poshtë:



"Urimet më të mira për të tre akademikët fitues. Urime të posaçme akademik Adem Bungurit, pasionin, punën dhe fuqinë analitike të të cilit unë e kam ndjekur prej më se tridhjetë vjetësh. Hipotezat e tij kanë nxitur debat të dobishëm shkencor dhe kanë ridimensionuar disa pikëpamje të diskutueshme. Vepra e akademik Bungurit është sa cilësore, po aq edhe sasiore. Në tërësinë e saj, kjo vepër do të shërbejë si burim referecial për të thelluar e pasuruar më tej dijet në fushën aq të rëndësishme për lashtësinë e kombit shqiptar, në fushën e arkeologjisë. Shëndet, suksese dhe arritje të tjera akademik Adem Bunguri!"

- **Hysen Uka**, *studiues*

"E ku ka më mirë për Dibrën, kur një bir i saj bëhet Anëtar i Akademisë së Shkencave. Shkencëtarë të tille, me kontribute të dallueshme për trevën tonë dhe jo vetëm, plotësojnë "kurorën akademike" në majat e shkencës shqiptare. I lumtë profesor Ademit dhe suksese!

- **Haki Përnezha**, *studiues*

"Urime për të tre anëtarët e rinj. Me siguri janë prurje cilësore që e nderojnë titullin akademik. Duke njohur nga afër aktivitetin dhe arritjet e zotit Bunguri, ndjehem veçanërisht i gëzuar për vlerësimin e tij. Gjithë çfarë ka shkruar, gjithë çfarë ka lektuar dhe gjithë çfarë ka referuar zoti Bunguri përbëjnë kontribute, jo vetëm në fushën e arkeologjisë, por edhe në atë të historisë, sociologjisë dhe didaktikës. Nëpërmjet kulturës së gjerë, formimit cilësor profesional, komunikimit të ngrohtë, angazhimit të pandërprerë dhe individualitetit krijues z. Bunguri ka sjellë origjinalitet dhe risi në korpusin e veprës së tij e cila, me siguri do pasurohet më tej, duke u fuqizuar pandërprerë në shërbim të çështjeve që lidhen me prehistorinë e trojeve ku kanë jetuar të parët tanë dhe vlerave të trashëgimisë në breza."

- Gafur Muka, *profesor i shkencave gjeologjike*

"Urime të përzemërta akademikut dibran, profesor Adem Bungurit, njeriut fisnik dhe modest, punëtorit të palodhur në shërbim të shkencës dhe atdheut, me kontribute të mëdha në fushën e arkeologjisë brenda dhe jashtë vendit. Akademik Bunguri i bënë nder Dibrës dhe Shqipërisë. Jetë sa më të gjatë, me shërbime tjera të çmuara në dobi të shkencës dhe atdheut!"

- **Vesel Hoxha**, *profesor i shkencave gjeologjike*

"Urime prof. Adem Bunguri! Ju sot u vlerësuat si studiuesi më aktiv dhe më i suksesshëm në arkeologjinë shqiptare, një nga studiuesit më të përkushtuar dhe produktiv të 10-vjeçarit të fundit! Krenar për ty dhe arritjet e tua!"

- **Miranda Goleci**, *botuese.*

"Urime dhe suksese akademikëve të rinj! Suksese akademikut dibran profesor Adem Bungurit, i cili ka një kontribut të shquar në fushën e arkeologjisë shqiptare! Shëndet, jetë të gjatë e energji për të punuar në dobi të shkencës tonë!"

- **Begu Hajri**, *profesor.*

"Njeriu i urtë, arkeologu me kontribute në mbarë Shqipërinë e në Dibër, punimet e tij janë cituar nga shume arkeologë nga shumë vende. E meriton këtë titull, i shkëlqyeri Adem. Suksese i nderuari Akademiku fjalë pak e punë shumtë."

- Selman Mziu, *botanist*

"Urime Akademikut të nderuar, prof. të fushës së Arkeologjisë z.Adem Bunguri. Kontributi i tij, pasioni dhe analizat e thella shkencore me argumente të pakundërshtueshme, janë garanci për arritjet të mëtejshme shkencore në shërbim të kombit".

- **Mustafa Tola**, *shoqata "Çidhna dhe Kastriotët"*

"Urime Adem djali!.. Je kërkuesi e studiuesi më i përkore dhe modest që kam njohur. Për mua je pasardhës i të madhit Hasan Ceka".

- **Xhezair Abazi**, *kritik letrar*

"Një lajm i gëzuar për të gjithë dibranët, në veçanti frymëzim për studiuesit dhe intelektualët. Urime akademik Adem Bungurit!"

- **Kamber Faruku**, *gazetar*

"Pasioni, studimi dhe këmbëngulja, vjen një ditë dhe shpërblehen. Urime, akademik Ademi. Titull plotësisht i merituar."

- Inajet Shehu, *shkrimtar*

"Sa lajm i bukur për ne, dibranët. Gëzohem shumë që profesor Bunguri vlerësohet me titullin më të lartë shkencor. Urime dhe suksese të tjera po kaq të mëdha."

- **Mentor Hoxha**, *gazetar*

"Urime prof. Adem Bunguri , suksese në veprimtarinë tuaj akademike, ku meritoni të jeni prej kohësh!"

- Bashkim Lami, *shoqata "Bulqiza"*

arkeologji

Nga **Adem BUNGURI**, Akademik

Evidenca arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë, na shtyn të ndalemi më thellë në këtë çështje, ku gjendet sipas nesh, çelësi për të kuptuar më mirë mekanizmin e shfaqjes së këtij fenomeni gjatë Bronzit të Hershëm, si dhe për të rivlerësuar hipotezën e migracionit "kurgan".

Kultura e Bronzit të Hershëm paraqet një facie të re kulturore të ndryshme nga ajo eneolitike, në elementët më kryesorë të saj. Rishfaqet në këtë periudhë qeramika me pjekje oksiduese me ngjyrë okër dhe okër të kuqe, që zëvëndëson qeramikën fine eneolitike me pjekje reduktuese dhe lustër të zezë. Shfaqen forma të reja enësh dhe koncepte të reja dekorative, me prevalencë të ornamenteve plastike, me frekuencë të lartë të shiritave horizontalë të gropëzuar, të vendosur në pjesët më të dukshme të enës. Shfaqen zhvillime të rëndësishme në jetën ekonomike e sociale, të kushtëzuara nga zbulimi i bronzit dhe përdorimi i tij në ekonomi. Impakti i parë dhe më i dukshëm i këtij zhvillimi është nevoja gjithnjë në rritje për metalin e ri, e shoqëruar nga lufta për të zotëruar burimet e xeherorëve të bakrit dhe të kallait, intensifikimi i shkëmbimeve tregtare midis komuniteteve agrikulturore e pastoraliste dhe atyre metalurgjike, dhe padyshim polarizimi social brenda këtyre komuniteteve. Shënohen kështu fillesat e krijimit të aristokracisë fisnore, në një shoqëri të sunduar nga burrat. Këto zhvillime në fushën e jetës ekonomike e sociale çuan gradualisht në vendosjen e një "rendi të ri ekonomiko-botëror", dhe sollën ndryshime edhe në fushën e jetës shpirtërore dhe religjioze, të materalizuar në shfaqejn e tumave, si monumente sepulkrale, ekskluzivisht të lidhura me fillimet e Bronzit të Hershëm.

Ndryshimet e mësipërme gjenetikisht janë lidhur apriori me migracionin e valës së tretë të "Yamna kulturës", të njohur edhe si kultura e tipit "pit grave " ose Kurgan IV, sipas hipotezës së M. Gimbutas. Megjithë influencat e komponentit "kurgan", kultura e Bronzit të Hershëm në Shqipëri e Kosovë, përveç komponentit indigjen eneolitik të tipit Maliq II dhe atij badeno-kostolacas, përmban edhe një komponent tjetër të konsoliduar. Është fjala për komponentin anatolik, rruga e depërtimit të të cilit, mund të ndiqet përmes analogjive kulturore të kulturës së Bronzit të Hershëm të Shqipërisë (Maliq IIIa-b) dhe Kosovës (Hisar IIIa-Vlashnje IVa) me kulturën e Bronzit të Hershëm të Pelagonisë (grupi Armenohori), Maqedonisë Egjeane (Servia VIII-X, Kastanas, Kritsana, Dikili Tash, Rrafshina e Dramës), Thesalisë (Argissa Magula III), Bullgarisë (Ezero A-B), Thrakisë (Salhane, Kanligeç, Haskoy Hoyugu (Edirne) dhe Anatolisë (Trojë I-II, Paphlagonia)**.** Gjetja e çelësit gjenetizues të kulturave prehistorike në përgjithësi, dhe asaj të Bronzit të Hershëm në veçanti, është një nga problemet më të vështira, dhe njëherësh më të rëndësishme, që shtrohet për zgjidhje para studiuesëve të arkeologjisë prehistorike. Përpjekja për të depërtuar në thelbin e proçesit, gjë që duhet thënë se mbetet gjithnjë relative, tregon se nuk mund të bëhet fjalë për një skenar të thjeshtë, sipas të cilit, popullsia vendase pret në mënyrë paqësore ose edhe me qëndresë të përkohshme dhe shpejt të thyeshme, ardhësit e rinj migracionarë, të cilët, si "kolonizatorë" të gjithëfuqishëm, ose i çvendosin banorët indigjenë, ose u imponojnë vendasve gjithçka të tyren, që nga kultura materiale deri tek ajo shpirtërore, duke i asimiluar plotësisht. Ky skenar i tipit *deus ex machina,* qoftë edhe i përcaktuar në kohë dhe në hapësirë, ka qenë përgjithësisht i pranueshëm edhe për arkeologjinë tonë prehistorike të para viteve '90[1]. Modeli bazë i këtij skenari ka qenë hipoteza e M. Gimbutas mbi migracionin "kurgan" në Europën Juglindore dhe në Ballkan, i cili gjatë tre valëve të tij suksesive, dhe veçanërisht gjatë valës së tretë të "Yamna kulturës", të njohur edhe si kultura e tipit "pit grave ", ose Kurgan IV[2], arriti të nënshtrojë një hapësirë kolosale, që përfshin rajonet veri ballkanike, përkatësisht territoret e Moldavisë, Rumanisë e Hungarisë, si dhe të gjithë Ballkanin, që nga Danubi dhe Deti i Zi në veri dhe në lindje, deri në detet Egje, Jon dhe Adriatik në jug dhe perëndim[3]. Në përpjekje për t'iu afruar thelbit të problemit, duke u mbështetur në kulturën materiale dhe atë shpirtërore të Bronzit të Hershëm, sipas evidencës arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë, kemi arritur në përfundimin se kemi të bëjmë me një qasje të ndryshme dhe më komplekse të kulturave autoktone eneolitike të kësaj hapësire ndaj rrymave kulturore indo-evropiane të Bronzit të Hershëm. Në këtë kontekst, rivlerësimi i kulturës së Bronzit të Hershëm dhe gjenezës së saj në dritën e kërkimeve dhe studimeve të reja në Shqipëri dhe Kosovë, është më se i nevojshëm, pasi lidhet me thelbin e proçesit gjenetizues të formimit të popullsisë ilire.

Hipoteza e migracionit kurgan.

Për të parën herë, hipoteza e migracionit kurgan u formulua nga M. Gimbutas në vitin 1956, dhe është plotësuar sistematikisht në vitet e mëvonshme (1961, 1970, 1973, 1977, 1979, 1990 dhe 1994)[4], duke u kthyer në një kredo të saj shkencore, me ndikim jo të vogël në teorinë e indo-europianizimit të Europës në përgjithësi dhe të Ballkanit në veçanti. Sipas kësaj hipoteze, lëvizjet migruese nga stepat kaukaziane drejt Ballkanit përbëhen nga tri valë të njëpasnjëshme[5], që shihen si pjesë e një proçesi të vetëm. Sipas Gimbutas, embrioni i këtij proçesi, është kultura Samara dhe Berezhnjevka e stepave pyjore të rajonit të Vollgës. Gjatë fazës së parë (4400-4300 para Kr.(cal) bartësit e kulturës Berezhnjevka nga stepat midis Vollgës dhe Kaspikut filluan lëvizjen drejt jugut për në rajonin e Kaukazit dhe Dnjeprit të Poshtëm. Vala e parë e këtij migracioni kishte karakterin e një intruzioni masiv ushtarak, që solli pasoja katastrofike për kulturat më të hershme bujqësore. Kjo valë migracionare shoqërohet nga shkatërrimi i plotë i kulturës Gumelnica-KaranovoVI-Varna dhe nga transformimi i kulturës Cucuteni-Tripolje[6], që megjithatë, vazhdoi evolucionin e saj.

Bartësit e valës II (3500-3300 para Kr.(cal) ishin gjithashtu tribu pastorale me rite kurgane të varrimit, të përftuara nga veprimi i impulseve kaukaziane, përkatësisht kultura Kuro-Araxes në rajonin Transkaukazian dhe kultura Maykop në Kaukazin Verior. Sipas M. Gimbutas, kjo valë ndikoi në përhapjen e teknologjisë së bronzit në Europën Jugore dhe atë Lindore, në shfaqjen e kulturës Mihajllovka, në përfundimin e riformatimit të kulturave të vjetra bujqësore, në formimin e kompleskit Usatovo, kulturës Ezero dhe grupit Baden-Vuçedol[7]. Ajo beson se komplekse të reja kulturore zëvëndesuan grupet e vjetra kulturore të Europës. Kështu kultura Cucuteni-Tripolje në Ukrainën Perëndimore dhe Rumaninë Veriperëndimore, u zëvëndësua nga kulturat Usatova, Gorodsk dhe Folteşti dhe pjesërisht edhe nga Globular Amphora, kultura Karanovo u zëvendësua nga ajo Ezero dhe Cotofeni, kultura Vinça, Lengyel dhe Polgar nga kultura Baden, kultura Cortailled-Lagozza në luginën e lumit Po në Italinë e Veriut dhe luginat alpine të Zvicrës, nga kultura Remedello[8] etj.

Më në fund, vala III (3100-2900 para Kr.(cal) është e lidhur me bartësit e kulturës së vonë Yamna ose të tipit "pit-grave". Migracioni i tyre masiv shoqërohet me riformatimin final të arealit Karpato-Danubian dhe Ballkanik dhe përfundimin e proçesit të gjatë të indo-evropianizimit të komuniteteve të kontinentit europian[9]. Sipas studiuesëve që e pranuan pikëpamjen e Gimbutas, dhe sidomos valën III të migracionit kurgan, të përfaqësuar nga kultura Yamna ose pit-grave, në rajonin veriperëndimor të Detit të Zi, në Moldavi, në Rumani, Bullgari, Hungari, Serbi etj, komplekset bujqësore neolitike pushuan së vepruari menjëherë pas ekspansionit "kurgan" drejt jugut dhe jugperëndimit[10].

a. Elementët "kurgan"

Elementët thelbësor të kulturës kurgane janë: varrimi tumular në varre të tipit "pitgrave",

studim

Hapësira kolosale e përhapjes së tumave, e bën të vështirë dhe të pamundur lidhjen e këtij fenomeni me një etnitet të caktuar prehistorik, sado i fuqishëm dhe i zhvilluar të ketë qenë ai. Sipas të dhënave arkeologjike, tumat, si monumente varrimi të epokës së bronzit njihen jo vetëm në zonën e kulturës "kurgan", por në një hapësirë gjigande që përfshin tre kontinentet më të mëdha të rruzullit, Azinë, Europën dhe Amerikën Veriore.

Rivlerësimi i hipotezës së migracionit "kurgan" sipas evidencës arkeologjike nga Shqipëria dhe Kosova

me arkë druri ose të tipit çist, riti i varimit me inhumacion në pozicionin "rombstellungen" ose në shpinë me këmbë të përthyera, shoqërimi i varrit qëndror me varrime rituale bagëtish, kryesisht të kaut ose të kalit dhe përdorimi i okrës ose pigmentit të kuq në varrin qëndror. Inventari i varreve të tipit "kurgan" përmban një ose disa nga objektet e mëposhtme: thikë të gjatë stralli, majë shigjete stralli me fletë trekëndëshe, varëse prej dhëmbë elefanti ose derri të egër, sëpatë guri me kokë të rrumbullakët, topuz guri kryqiform, modelin e karrocës me rrota, spektrin, figurina të kokës së kalit dhe figurina antropomorfe meshkujsh dhe simbole të fallosit[11]. Gjatë diskutimit të kulturës tumulare në Shqipëri, do të përmenden elementët e mësipërm "kurgan"në Shqipëri, edhe pse mjaft të rrallë dhe sipas mendimit tonë, të infiltruar nga influencat kulturore dhe shkëmbimet tregëtare. Evidenca arkeologjike në Shqipëri dhe Kosovë, na shtyn të ndalemi më thellë në këtë çështje, ku gjendet sipas nesh, çelësi për të kuptuar më mirë mekanizmin e shfaqjes së këtij fenomeni gjatë Bronzit të Hershëm, si dhe për të rivlerësuar hipotezën e migracionit "kurgan".

Elementët thelbësor të kulturës kurgane janë: varrimi tumular në varre të tipit "pitgrave", me arkë druri ose të tipit çist, riti i varimit me inhumacion në pozicionin "rombstellungen" ose në shpinë me këmbë të përthyera, shoqërimi i varrit qëndror me varrime rituale bagëtish, kryesisht të kaut ose të kalit dhe përdorimi i okrës ose pigmentit të kuq në varrin qëndror. Inventari i varreve të tipit "kurgan" përmban një ose disa nga objektet e mëposhtme: thikë të gjatë stralli, majë shigjete stralli me fletë trekëndëshe, varëse prej dhëmbë elefanti ose derri të egër, sëpatë guri me kokë të rrumbullakët, topuz guri kryqiform, modelin e karrocës me rrota, spektrin, figurina të kokës së kalit dhe figurina antropomorfe meshkujsh dhe simbole të fallosit.

Argumentet kundër migracionit kurgan:

a. Të karakterit të përgjithshëm

Si për çdo hipotezë të rëndësishme, edhe për atë të indo-europianizimit të Europës nëpërmjet migracionit "kurgan", mendimet janë ndarë prej kohësh në dy grupe. Në njerën anë janë besnikët e hipotezës së M. Gimbutas, ku spikat qëndrimi i N. Hammond[12], M. Sakellarious[13], V. Dergachev[14] dhe A. Katona[15] dhe në anën tjetër kritikët e saj të shumtë. C. Renfrew është i pari studies që e ka kundërshtuar këtë hipotezë[16]. Madje, sipas tij, nuk mund të bëhet fjalë për kolonizimin me drejtim Lindje-Perëndim, por mund të flitet për kolonizimin me kahje të kundërt dhe shtron hipotezën e kolonizimit të stepave të Rusisë nga perëndimi, si proçes normal i zhvillimit të pastoralizmit[17]. Studiuesë të tjerë që kundërshtojnë hipotezën "kurgane" janë J. Makkay[18], D. Telegin[19], Y. Rassamakin[20], A. Harding[21], M. Jones[22], V. Heyd[23], E. Banffy[24] , C. Gerling, J. Dani. K. Köhler, G. Kulcsár, A. W.G. Pike, V. Sverenéyi[25] etc. Sipas Y. Rassamakin, "*teoria e inkursionit të "traditës kurgane" në stepat pontike nga Lindja (Vollga dhe zona e Kaspikut Verior) nuk gjen më mbështetje serioze*"[26], ndërsa sipas E. Banffy "*Gimbutas përshkruan një pamje idilike të një bote pothuajse utopike të sunduar nga burrat*"[27].

Hipoteza e migracionit "kurgan", karakterizohet nga disa kontradikta të brendshme të karakterit kronologjiko-kulturor, që do të ceken më poshtë:

1. Kultura "kurgan" kufizohej në jugperëndim nga rajoni i kulturës Cucuteni (Rumani) dhe Tripolje (Ukrainë), popullsia e të cilëve ushtronte një ekonomi të përzier bujqësore e blektorale. Ndërsa sipas M. Gimbutas intruzioni kurgan stepik gjatë valës së dytë migracionare, shënoi mbarimin e kulturës Cucuteni-Tripolje[28] gjatë fazës Cucuteni A-Tripolje B_1, gjë që presupozon një shkatërim të madh dhe armiqësor të kësaj kulture, evidenca arkeologjike nuk tregon asnjë fakt bindës që mund të shpjegohet me ndërprerje të banimit dhe ndryshime drastike të jetës. Studimet bio-arkeologjike në mbi 80 vendbanime të kulturës Tripolje, kanë provuar vazhdimin paqësor të jetës së tyre agrikulturore dhe pastoraliste, dhe kultivimin e disa drithërave, bimëve bishtajore si dhe drufrutorëve[29]. Gjithashtu fakti se mjaft objekte të kulturës Tripolje janë gjetur në zonën e stepës, në lindje të kësaj kulture, dëshmon për kontakte rajonale të kryera përmes stepës[30] në drejtimin perëndim-lindje. Nga ana tjetër, diferenca e ndjeshme kronologjike midis kulturës migracionare Maykop (3500-3300 para Kr.) dhe kulturës pritëse të fazës Cucuteni A-Tripolje B_1 (4100-3800 para Kr.)[31], e bën të matematikisht të papranueshëm propozimin e Gimbutas. Gjithashtu J. Makkay ka treguar se egzistojnë ndryshime të mëdha midis kulturës Cucuteni-Tripolje and Yamna kulturës përgjatë luginës së Dnieprit[32], një prej të cilëve është padyshim kontinuiteti midis varrimeve të dysta dhe atyre tumulare në zonën e kulturës Cucuteni-Tripolye[33], dukuri që mbështet konkluzionin e mësipërm.

2. Gjatë Bronzit të Hershëm, hapësirat e Polonisë, Çekisë, Bohemisë, Gjermanisë, Zvicrës, Austrisë, Hollandës dhe Danimarkës[34] kanë qenë mbuluar nga qeramika kordelore[35] (*corded ware*). Sipas C. Renfrew bartësit e kësaj culture nuk kanë asnjë afërsi biologjike me popullsinë kurgane të Ukrainës[36]. Ky fakt është mbështetur edhe nga D. Telegin, që ka treguar se kultura "*Corded Ware*" dhe "Yamna Culture", si dy kultura fqinje, që takohen në pellgun e Dnieprit, karakterizoheshin nga pastoralizmi dhe ritet kurgane të varrimit[37], por bartësit e qeramikës kordelore, ndryshe nga ato të Yamna kulturës, i përkasin tipit antropologjik *gracil* mesdhetar[38], d.m.th një tipi të ndryshëm nga ai stepik i Yamna kulturës. Qeramika kordelore, e njohur edhe si "*schnurkeramik*"[39], datohet në gjysmën e parë të mijëvjeçarit III-të para Kr.[40] ose rreth viteve 2900-2450 calBC[41]. Në Poloninë Jugore ajo datohet midis viteve 3090-2920 cal BC[42], në luginën e Elbës midis viteve 3000-2400 cal BC[43], në Gjermaninë Jugore midis viteve 3200-2400 cal BC[44], në Zvicër midis viteve 3000-2200 cal BC[45], në Hollandë midis viteve 2880-2580 cal BC[46] dhe në Danimarkë midis viteve 2750-2600 cal BC[47]. Përhapja e qeramikës *schnur* në të gjithë hapësirën e gjërë të Europës Qëndrore dhe Veriore është bërë nëpërmjet një rjeti të gjërë komunikimesh dhe jo me anë të migracionit[48].

3. A. Harding ka treguar se "*ndërtimi i tumës ishte një praktikë kulturore e përhapur gjatë Eneolitit dhe Bronzit në Europë*"[49]. Gjithashtu sipas tij, është e sigurtë që varrimi nën tuma të thjeshta është i pranishëm edhe në zonën e kulturës së qeramikës kordelore në Europën Veriore, ku personi i varrosur shoqërohet me qeramikë kordelore dhe ndonjëherë edhe me "*battle-axes*" ose sëpatë guri me aks të tejshpuar[50]. Ai ka sjellë në kujtesë gjithashtu edhe konkluzionin e studiuesit gjerman A. Häusler mbi origjinën lokale të kulturës së qeramikës kordelore (*corded ware/schnurkeramik*)[51].

4. Sipas Y. Rassamakin, "*periudha e hershme e zhvillimit të arkitekturës monumentale të stepës është e kufizuar në një zonë midis Kaukazit Verior dhe provincës metalurgjike të Ballkanit Karpatik dhe në trajtën e një sistemi shkëmbimi të mallrave të prestigjit*"[52]. Po sipas tij, drejtimi i intruzioneve të Bronzit të Hershëm në zonën e kulturës "kurgan" është kryer jo nga lindja në perëndim apo jugperëndim, por anasjelltas. Y. Rassamakin ka shënuar se shfaqja e konstruksioneve rituale me karakter monumental nuk është shkaktuar nga impulse të brendshme, siç mendon M. Gimbutas, por nga impulse të jashtme, të lidhura me zhvillimin e metalurgjisë në rajonin e Karpateve Ballkanike dhe lindja e sistemit të shkëmbimit të mallrave të prestigjit. Shfaqja e varrimeve të para individuale në trajtë kodrash apo konstruksionesh rituale, të shoqërura me mallra prestigji, në zonën stepike midis Kaukazit Verior dhe Karpateve Danubiane, është, sipas tij, rezultat i zhvillimit të një sistemi të ri "botëror" ekonomiko-social[53].

6. Sipas M. Özdoğan mendon se influenca kurgane, është infiltruar në Anatoli nga grupe elitare të ardhura nga Kaukazi Verior, të cilët në një fazë të mëvonshme, kanë lëvizur nga Anatolia drejt Ballkanit[54]. Gjithashtu ai ka konstatuar praninë e një hiatusi kulturor në Thrakinë Lindore, që përfshin periudhën nga mesi i mijëvjeçarit të V-të deri në fillimin e mijëvjeçarit të III-të para Kr., ose periudhën nga mbarimi i kulturës Aşağı Pinar deri në fillimet e Bronzit të Hershëm (kultura Helvaci Şaban dhe Kocatepe)[55], i cili është mbushur nga grupe mobile të ardhura nga pjesa Anatoliane e detit Marmara[56].

7. Ka një diferencë të ndjeshme midis datave të larta të propozuara nga M. Gimbutas për zbutjen e kalit në kulturën Derievka (3565+-90 vjet më parë (BP) dhe 4480-4360 para Kr.(cal) dhe datave të argumentuara bindshëm nga P. Mallory (2950+-100 vjet më parë (BP) dhe 3780-3630 para Kr.(cal), të përforcuar nga analizat faunale, të cilat që sugjerojnë që kali është zbutur për herë të parë në territorin e kulturave Gumelnica dhe Tripolye-Kocoteni, prej ku edhe është përhapur drejt stepave të verilindjes, gjatë ekspansionit drejt lindjes të kulturës Sredni Stog II[57]. Zanotti beson se edhe origjina e Yamna kulturës është pak a shumë e ngjashme me këtë[58].

8. Gjithashtu në zonën e kulturës Cucuteni-Tripolje, është konstatuar vazhdimësia midis varrezave të sheshta dhe atyre tumulare, gjë që presupozon edhe vazhdimësinë etno-kulturore të bartësve të tyre. Lidhur me tumat janë vënë në dukje dy elementë thelbësorë: së pari tuma si një formë e re monumentale varrimi ka mundësi potenciale për ruajtjen e lidhjeve fisnore që ofronte varreza e dystë. Së dyti, tuma, duke qenë shumë e dukshme, mundëson kryerjen *face to face* të të gjitha akteve memorative midis të afërmve dhe miqve të gjallë dhe të dashurve të tyre të vdekur dhe të mbuluar në tumë[59].

9. Hipoteza e migracionit "kurgan" ka edhe kontradikta të karakterit kronologjik, që e bëjnë të dyshimtë përmbajtjen e saj. Kështu, është konstatuar se areali i Pontit Verior të zonës Circumpontike, ka prirjen për t'i vonuar datat në raport me pjesën jugore të tij. Gjithashtu parimi i sinkronizimit të kulturave përreth Detit të Zi nga Lindja dhe Perëndimi, nuk lejon përfshirjen e monumenteve të Pontit Verior të Eneolitit të vonë final në sistemin Cirkumpontik[60]. Këtu përfshihet edhe mospërputhja kronologjike midis kulturës migracionare Maykop (3500-3300 para Kr.(cal) dhe kulturës pritëse të fazës Cucuteni A-Tripolje B_1 (4100-3800 para Kr.(cal)[61]. Vetë Gimbutas në përfundim të artikullit të saj mbi valën e dytë të migracionit "kurgan", pranon faktin që "*shkalla e ndryshimeve më e dukshme është në lindje, në pikën e fillimit të impaktit, dhe më e ulët në perëndim*"[62].

10. Së fundi, hapësira kolosale e përhapjes së tumave, e bën të vështirë dhe të pamundur lidhjen e këtij fenomeni me një etnitet të caktuar prehistorik, sado i fuqishëm dhe i zhvilluar të ketë qenë ai. Sipas të dhënave arkeologjike, tumat, si monumente varrimi të epokës së bronzit njihen jo vetëm në zonën e kulturës "kurgan", por në një hapësirë gjigande që përfshin tre kontinentet më të mëdha të rruzullit, Azinë, Europën dhe Amerikën Veriore. Përveç gadishullit Ballkanik (Greqi, Serbi, Bullgari, Kroaci, Bosnje Hercegovinë, Mali i Zi, Shqipëri, Kosovë) dhe pellgut Danubian (Rumani, Hungari, Moldavi, Gjeorgji) grupime të mëdha tumulare ndeshen në pellgun e Egjeut, Anatoli dhe Levant, në Europën Qëndrore dhe atë Perëndimore (Itali, Austri, Gjermani, Poloni, Çeki, Bohemi, Francë, Belgjikë, Spanjë, Portugali, Britani, Irlandë) dhe në Skandinavi (Danimarkë, Suedi, Norvegji). Harta e shpërndarjes së tumave përfshin edhe Azinë Juglindore dhe Lindore (Indi, Kinë, Kore) si dhe Japoninë dhe Amerikën Veriore[63], madje në këto të fundit ato paraqiten mjaft karakteristike. Për këto arësye, besojmë se tumat janë shfaqje rituale të një rendi të ri ekonomiko-botëror, të bazuar mbi një ekonomi më të zhvilluar, ku fuqizimi ekonomik i aristokracisë fisnore u shoqërua me dëshirën e përjetësimit arkitektonik të kujtimit të të parëve dhe të jetës së përtejme, dhe pajisja e inventarit të tyre me mallra prestigji. Duke e diskutuar këtë çështje, A. Harding shtron pyetjen kruçiale: *"A është vërtetë e mundur të shoqërojmë praktikën e ndërtimit të tumave me një popull të veçantë, dhe të pranojmë që përhapja e kësaj praktike tregon edhe përhapjen e këtij populli"*?[64]. Është vetë Harding që i përgjigjet kësaj pyetje:*"është e vështirë të shoqërohet praktika e ndërtimit të tumave, kaq e përhapur në hapësirë dhe në kohë, me një grup të veçantë etnik... Sidoqoftë, ka argumente të shumtë kundër këtij mendimi në planin arkeologjik"* [65].

(Vijon numrin e ardhshëm)

Profesor Bunguri, zgjidhet anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Akademik Adem Bunguri,



Copëza kujtimesh me akademik Bungurin nga profesor i asociuar doktor, inxhinier **Vesel Hoxha**

TAKIMI NË ARRËMOLLË

Në verën e vitit të largët 1977, ndonëse punoja në zonën e Korabit për kërkim zbulimin e mineralizimeve të hekurit pa nikel, siç hyri në fjalorin e asaj kohe, do të shkoja për punë në zonën e Arrëmollës për tu njohur me disa shfaqje të bakrit që paraqitnin interes kërkimi, veçanërisht në përruan e Gështenjit, mbi shtëpinë e të mirënjohurit Çup Alia, babait të mikut tim të kahershëm Nezir Çupi, me të cilin dhe sot e kësaj dite vazhdoj të kemi marrëdhënie shumë të mira, falë dhe lidhjeve të tij miqësore me kolegun tim nga Lura, ose më saktë nga Pregjë Lura, inxhinierin Xhemal Mena, shtëpia e të cilit vite më vonë, do të bëhej për mua dhe jo vetëm për mua, një shtëpi e dytë, kur do të punonim bashkë, për kërkimin e bakrit në disa objekte si dhe në atë të kromit në Përruan e Ftujës etj. në rajonin e Lurës. Rastësia e solli që të takoj për herë të parë mësuesin e historisë dhe gjeografisë në shkollën e Arrëmollës (Arra në Mallë, e, nisur nga origjina e emrit më saktë do ishte Arrëmalla jo Arrëmolla), arkeologun dhe njëherazi akademikun e ardhshëm Adem Bungurin. Pas përshëndetjeve dhe pyetjeve të rastit muhabeti mori udhët e shkencës. Për çfarë nuk më pyeti, për gjeologjinë dhe mineralet. Kishte një kuriozitet të jashtëzakonshëm. Çështë e vërteta, unë në atë kohë sapo kisha mbaruar studimet dhe isha vetë i ri e i etur të bëja pyetje, jo tu jepja përgjigje pyetjeve për gjeologjinë për të shuajtur kureshtjen e madhe, të akademikut të ardhshëm. Në atë kohë, më i avancuar isha në njohjen e mineraleve, gjë që e kam patur pasion që kur isha në Teknikumin e Minierave dhe të Gjeologjisë në Përrenjas, (ndonëse në fund unë diplomën e mbrojta për Makshajderi) në vitet e largëta 1966-1970. Asokohe në atë zonë punonin teknik gjeologët Isa Mandri dhe Adli Baholli që më vonë do të transferoheshin në Ekipin e Hekurit në fillim të vitit 1979 dhe atje do të punonte për pak kohë Teknik gjeologu i talentuar Ali Bardhi. Punimet në zonën e Arrëmollës provizorisht u drejtuan nga inxhinieri gjeolog Ilir Alliu (sot profesor), i cili vite me vonë pas një specializimi për gjeokimi në Itali, do të punonte në institucione shkencore qendrore në Tiranë, dhe për shumë vite si pedagog në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, ku dhe doli në pension.

Ademi me atë thjeshtësinë dhe modestinë që e ka karakterizuar dhe e karakterizon, na ftoj tek dhoma ku kishin bazën e tyre të banimit. Kur shkelëm për herë të parë në Arrëmollë me 20 gusht 1976 – vijoj të na tregoj rrugës mësues Ademi - bashkë me kolegun Ramazan Mani, drejtori Osman Vladi na çoi në shtëpinë e Tij (të Zenel Musës) ku kishte organizuar gjithçka, e cila ishte një kullë mjaftë komode dhe cilësore, një shtëpi e madhe që ka dhënë bukë të madhe, shtëpi e përmendur në atë nahije. Më vonë u rregulluam në dy dhoma me krevat drrase, me nga dy krevate secila, të cilat ndodheshin në qendër të fshatit, afër zyrave të kooperativës dhe dyqanit, në vendin e njohur si Sheshi i Doçe. Nuk dua të komentoj kushtet dhe vështirësitë e mësuesve në atë kohë kur punonin e banonin larg shtëpisë së tyre. Drejtor i shkollës ishte Osman Vladi, një njeri i qetë, bujar dhe shumë i zgjuar. Vite më vonë, në kohën e demokracisë, kur jepja disa provime pasuniversitare ne universitet, e takoj në Tiranë. Ishte kujdestar konvikti në qytetin e studentit. Kujtuam me nostalgji ato vite që nuk kthehen pas, pse jo, fjala ra dhe për akademik Bungurin, asokohe një mësues i dalluar dhe i rrallë që pat fatin ta kishte Arrëmolla dhe Lura- vijoj komentin e tij lakonik z. Vladi.Njerëzit që takohen në jetë në rrethana specifike nuk harrohen. Kështu më ndodhi dhe mua me mësuesin e historisë dhe gjeografisë në Arrëmollën e largët, akademikun e ardhshëm Adem Bungurin, me drejtorin e shkollës z. Vladi, e sa e sa njerëz të tjerë të punës pasionante dhe me vuajtje të mëdha në zona të thella malore, që takova gjatë disa dekadave, në atë krahinë aq të njohur në të gjithë Shqipërinë. Nga ai vit i largët zënë fill marrëdhëniet e mia me profesor Bungurin të cilat kanë ardhur në rritje, duke u bërë kështu njeri nga miqtë e mij të çmuar prej të cilit kam mësuar dhe mësoj shumë, kjo dhe për faktin se arkeologjia dhe gjeologjia kanë afinitet midis tyre, merren me nëntokën dhe mbitokën. Unë nuk pata rastin ta takoj më në Arrëmollë mësuesin Bunguri, pasi ai ishte transferuar në Gur Lurë, kësaj here si drejtor i shkollës.



Akademik Bunguri duke folur në Konferencën shkencore "100 vjet nga lufta e Dibrës".

Kujtimet e takimet me profesorin e nderuar dibran Adem Bunguri janë të shumë. Zgjedhja e tij si anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë është një nder dhe gëzim jo vetëm për profesor Bungurin dhe miqtë e tij por për gjithë Dibrën. Jetë sa më të gjatë akademikut më të ri të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, njeriut punëtor e të pa lodhur, një shembull për tu ndjekur në rrugën e ndritur të shkencës!

TAKIMI NË GUR LURË

Në prill të vitit 1980 do të shkoja në Gurë Lurë për vrojtime gjeologjike. Siç kam shkruar në botimet e mia, edhe pse emërimin zyrtar e kisha që të punoja në zonën e Korabit, për kërkimin e hekurit oksido-silikat dhe disa mineralizimeve të tjera, kurioziteti për të njohur gjeologjinë e vendit tim më gërvishte herë pas here mendimet dhe kësisoj caktoja rradhën e vrojtimevenë terren në periudhën e verës por, pa cënuar punën kryesore. Tashmë mësuesin e historisë dhe gjeografisë e dija se është transferuar në shkollën 8 vjeçare të Gurë Lurës në detyrën e drejtorit dhe nuk mund të rrija pa e takuar. Pas përshëndetjeve të rastit e ngacmoj:

-Hë u bëre drejtor, qenke ngritur në detyrë.

Me atë humorin e hollë që e karakterizon, mu drejtua duke më perifrazuar një fjalë të urtë turke: "Unë kam mendimin se është më mirë brigadier në Stamboll se sa drejtor në Anadoll".

Qeshëm me të madhe. Më pëlqeu shumë për rastin edhe pse e kisha dëgjuar dhe herë të tjera.

- Domethënë kërkon të transferohesh "brigadier" në Peshkopi, afër familjes.

- Po, ke të drejtë – vijova unë - bëre shumë vite larg shtëpisë. - Dëgjo këtu zotni drejtor, - i thashë, - po të të tregoj edhe unë një të përafërt që ma ka treguar i ndjeri Koço Gushi, ish kryegjeologu i NGJ të Bulqizës në vitin 1979, disa javë para se të vriste veten, por jo nga Turqia, por nga Rusia ose ish BS. "Në kohën e Stalinit kishin mbaruar studimet e larta dy ushtarakë në BS dhe ishin në pritje të emërimeve. Futet i pari për të marrë emërimin dhe i thonë që je caktuar me punë në Vladivostok! 'Rroftë Cari! - thotë, - që i shiti Alaskën Amerikës se do më kishit caktuar me punë atje'. Futet i dyti dhe i thonë që jeni caktuar me punë në rrethinat e Moskës. 'Rroftë Stalini! – thotë".

I pëlqeu shumë dhe më porositi që të bëja kujdes dhe të mos e tregoja në ambiente të hapura. Kishte shumë të drejtë, diktatura ishte



Vlashnje, 2010, Gjatë matjeve.



Hisar, 2004, Gjatë një interviste televizive



kulturë

personalitet i shquar i arkeologjisë shqiptare

tejet vigjilente dhe barsaleta të tilla të çonin në vende të errta ku nuk e shikoje dritën e diellit, ku Gur Lura apo Korabi, qendrat e punës asokohe të të dyve, ishin lule e shkuar luleve para tyre. Pasi më pyeti për qëllimin e ardhjes më tha: Unë sot do të nisem për shtëpi. Në se do ta kemi rrugën bashkë të bëjmë planifikimet e udhëtimit. Kisha biseduar me ato të Institutit të Gjeologjisë, të cilët do më nxirrnin shoferin e tyre Lahim Daci në Çidhën, pasi ai më kishte përcjellur një ditë më parë deri në Fushë Lurë. Në atë kohë punohej në temën qeveritare Zall Dardhë - Topojan nën drejtimin e gjeologut të shquar të ISPGJ-së, dr. Vangjel Qiricit, një minoritar por dhe një dashamirës i madh i shqiptarëve, që e flet gjuhën letrare shqipe më mirë se shqiptarët. Pasi i them planin drejtorit të shkollës, u gëzua shumë. "Kur të mbaroni punë Ju, nisemi". "Po - i them unë, - por punë do të bëjmë edhe gjatë rrugës së Gjalicave, kësisoj pas orës 12 do të nisemi nga Gur Lura pasi në atë orë unë i kam mbaruar vrojtimet këtu dhe ato vrojtimet rrugës do ti bëjmë bashkë.""U tha u bë-vazhdoj drejtor Ademi, duke e shoqëruar me një buzëqeshje të lehtë në buzë, çka tregonte gëzimin për rrugën që do bënim bashkë dhe makinën që na priste e do të na çonte në Peshkopi.

Rrugës së Gjalicave kaloja për herë të pare pasi shkova në Gur Lurë nga ana e Borie Lurës. Ademi e kishte bërë disa herë dhe kishte jo vetëm eksperiencën por, dhe kujdesin e veçantë kur kalonte aty. Nuk dua ti kujtoj ato momente të vështira pasi, dhe sot e kësaj dite, kur e kujtoj më merren mend. Për këtë rrugë kam shkruar dhe herë të tjera, por këtu do të ndalem në kureshtjen që pati mësuesi dhe drejtori i Gur Luës, Adem Bunguri. Një shkencëtari të ardhshëm i bënë përshtypje natyra që e rrethon. Pyeste pa ndërprerje për shumë gjëra dhe në veçanti për shkëmbinjtë e llojet e tyre, për depozitimet e Pliocen- Pleistocenit në Zonën e Xhaxhait, një dukuri e rrallë, për shpellat karstike, për formimin e kanionit të Setës, për orteqet, për burimet ujore, për çfarë nuk më ka pyetur. Unë i përgjigjesha brenda atyre që njihja në atë kohë të largët, ku dijet e mija për gjeologjinë regjionale ishin të cunguara. Pasi pushuam pak për një kafe në bahçen e vjehrrit tim, të ndjerit Shaqir Tola, ku na priste shofer Lahimi, u nisëm. Lahimi e kishte stacion të njohur shtëpinë e miqve të mijë në Çidhën, pasi punët gjeologjisë e kishin sjellur edhe herë të tjera aty. Në buzëmbrëmje arritëm në Peshkopi. Shoferi i papërtuar Lahim Daci, me origjinë nga Gjorica, nga fisi me emër i Dacit, me origjinë nga Zogjet e Grykës së Vogël, e përcolli deri në Grevë. Prof. Bashkim Lleshi, drejtori i asaj kohe i Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë në Tiranë, kishte dhënë porosi që sa herë të ketë nevoja pune në shërbim të temës qeveritare, të na ndihmonin me makinën e tyre. Dhe ashtu ndodhi. Ndihmat dhe ngjarjet mbreslënëse nuk harrohen. Ato gdhenden si shkrimi në gur.



Burim, 2007, çaste pune.



Reshtan, 2011, Ekipi i punës.

TAKIMET NË KOSOVË

Profesor Bunguri e shtriu aktivitetin e tij edhe në Kosovë. Këtu rastësia e solli ta takoj përsëri profesorin e nderuar që i kushtoi një jetë të tërë studimeve e gërmimeve arkeologjike anë e kënd viseve të Shqipërisë Etnike. Në Kosovë, jo vetëm kontribuoi drejtpërdrejtë në gërmimet e studimet e avancuara arkeologjike,duke kontribuar me argumente shkencore autoktoninë e shqiptarëve në ato troje dardane, por zgjeroi edhe më shumë njohjen e tij me kolegët kosovarë, të cilët i janë shumë mirënjohës, duke mësuan shumë prej këtij personaliteti shkencor. Tashmë, me profesorin e mirënjohur në gjithë Dibrën e Shqipërinë, kishim një njohje dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Arrëmolla e largët mund të themi se "kishte ngelur ne hije".

Prej tij mësova se puna e studimeve dhe gërmimeve arkeologjike në Kosovë, ishte fokusuar në dy drejtime kryesore:

- Në survejime arkeologjike kryesisht: në zonat ePejës në shtator 2000, në Gjakovë – 2001, në Prizren - 2002, në Rahovec - 2004, në Prishtinë - 2006, në Drenas, Skënderaj – 2012.

- Në gërmime të rregullta në bashkëpunim me dr. Shafi Gashi, me pjesëmarrjen e arkeologëve: Ma. Vesel Hoxhaj, dr. Premtim Alaj, dr. Sedat Baraliu, ma. Berat Ademi, ma. Azdren Shala, ma. Kushtrim Kuçi etj. si në: Vlashnje (Prizren: 2002, 2006 - 2008, 2010) (Dr. Shafi Gashi, Prof. Edi Shukriu (vetëm në fushatën 2002); Korishë (Prizren): 2002, 2006; Hisar (Suharekë): 2003 - 2004, 2007; Reshtan (Suharekë): 2010 – 2011; Kalaja e Prizrenit: 2012 - 2022 (gërmim dhe konservim); Tumat e Volujakut dhe Peçevës (Klinë): 2022 – 2013; Tumat e Lubozhdës (Istog): 2014 – 2015; Budriga e Epërme (Gjilan): 2015 etj

Gjatë kohës që profesori punoi në Republikën e Kosovës unë vetëm dy raste e takova në vitet 2014 dhe 2015. Në vitin 2014 e kam takuar në zonën e Istogut kur punonte në Tumat e Lubozhdës. Rastin tjetër në Kalanë e Prizrenit ku po realizonte gërmime dhe konservime, siç më thoshte profesori.

Aty më pati prezantuar dhe me arkeologun e ri me emrin Vesel Hoxhaj. Prezantimi i tij më tërhoqi vëmendjen pasi emri e mbiemri i tij ishin pothuaj të njëjta me inicialet e emrit e mbiemrit tim. Mendova se mos bëhej ndonjë shaka, duke më vajtur mendja se profesori i ka dhënë me qëllim që të prezantohet ashtu, por jo. Isha gabuar, ai ishte i sakt, atë emër e mbiemër kishte. Nuk thonë kot që rastësia është mbreti i botës. Unë do të ndalem në këtë rastësi që u bë shkas që të njihem nga afër me të dhe ta kem mik arkeologun e ri të Kosovës nga Prizreni, me emrin Vesel Hoxhaj.

Ma. Vesel Hoxhaj, aktualisht është Përgjegjës i Muzeut Arkeologjik në Prizren, pjesë e Institutit të Monumenteve Prizren, i varur nga Ministria e Kulturës e Republikës së Kosovës. Veseli tani ka kryer Masterin shkencor pranë Institutit Arkeologjik Tiranë me rezultatin "shumë mirë" me drejtues shkencor profesor Adem Bungurin dhe është në proces të doktoraturës me temë: "Vendbanimi prehistorik i Glladnicës", me drejtues po profesor Adem Bungurin.

Pas vitit 2009, pata përsëri fatin dhe rastin, siç theksova më lart, që gjatë viteve 2014 dhe 2015 të angazhohem me punë në Kosovë në periudhën e verës me nga një muaj në rilevime dhe redaktime gjeologjike në shkallë 1: 50 00, se bashku më një profesor të shquar të gjeologjisë së Shqipërisë. Në këto angazhime profesionale në Kosovë mu dha mundësia të takoj profesor Bungurin dhe të shikoj nga afër punën dhe përkushtimin e tij në hulumtimet dhe gërmimet arkeologjike. Po në këtë periudhë, duke mos qenë i saktë në data, takoj në Tiranë profesorin dhe Veselin e famshën të cilët ishin ulur në një kafe afër Akademisë së Shencave. U gëzova shumë, jo vetëm pse isha njohur me të në Kosovë, por dhe për një diçka tjetër. Pasi pyetemi e përshëndetemi, sipas zakonit të malësorëve më ofrojnë një ujë dhe kafe. Po, ju thashë, do ti marr por me një kusht, që ti paguaj unë të gjitha, pasi ju e keni kryer rradhën në Prizren, kur na shtruat drekën në një lokalet e bukura të qytetit historik, buzë lumit të Bistricës, duke më dhuruar shumë dashuri e respekt. Këmbëngula, por më vonë kuptova se si, me marifetin e dibranit të lashtë, si vetë Prehistoria e Dibrës, profesor Bunguri i kishte bërë pagesat. Këto kohët e fundit më ka bërë përshtypje një ndodhi jo e zakontë, i drejtohem unë arkeologut Kosovar nga Prizreni, të cilit profesori do ti udhëhiqte disertacionin.

Më kanë ardhur shumë e-maile dhe më kanë graduar duke më bërë Kryetar të Këshillit të Trazhëgimisë Kulturore në Institutin e Monumenteve të Prizrenit. Pasi i njoftova, po me e-mail, dërguesit e e-maileve, se unë nuk isha personi i duhur, u kërkova që mos mi dërgonit më këto, pasi nuk kam një detyrë të tillë, dhe me humor shtova, as nuk kam perspektivë ta kem. Ata mu përgjigjen me një ndjesë duke më falënderuar. Të dy filluan të qeshnin. Profesor Ademi tha se Kryetar i Këshillit të Trashëgimisë Kulturore në Institutin e Monumenteve të Prizrenit është ky adashi juaj që e keni përballë. Përsëri rastësia e bëri punën e vet. U befasova shumë pasi nuk e shkoja ndërmend, kjo dhe për faktin se ai mu duk një djalë shumë i ri, e brezi im jemi mësuar që në poste të tilla të jenë më të mëdhenj në moshë. Isha ulur në kafe me Kryetar të Këshillit të Trazhëgimisë Kulturore në Institutin e Monumenteve të Prizrenit, z. Vesel Hoxhaj, e-melet e të cilit më vinin mua. Qeshni, qeshni vijova unë por paga e një muaj si kryetar më takon mua .Është detyrë vullnetare vijoj me humor adashi im. Me të qeshura e humor u mbyll dhe ky takim.

Kujtimet e takimet me profesorin e nderuar dibran Adem Bunguri janë të shumë. Zgjedhja e tij si anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë është një nder dhe gëzim jo vetëm për profesor Bungurin dhe miqtë e tij por për gjithë Dibrën. Jetë sa më të gjatë akademikut më të ri të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, njeriut punëtor e të pa lodhur, një shembull për tu ndjekur në rrugën e ndritur të shkencës!







Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

cyan magenta yelloë black

Jeta dhe kontributi i Liri Rashës janë më shumë se një kurorë ari për muzikën popullore shqiptare.

Liri Rasha

Fenomen i papërsëritshëm i muzikës folklorike shqiptare





Nga **AGIM QOKU**

Jeta e njeriut është kohë e administruar bazuar mbi vlera, cilësi e kontribute që i përkasin shoqërisë e të cilat vetë koha i konservon si të tilla për çka janë. Jeta dhe kontributi i Liri Rashës janë më shumë se një kurorë ari për muzikën popullore shqiptare, që do të çojë ndër breza një shembull të plotë se si mund të administrohet talenti dhe qytetaria në dobi të shoqërisë, kulturës e atdheut tënd. Pavarësisht ndryshimit të ngadaltë që kënga popullore pëson në formë dhe mjetet e veta shprehëse, Liri Rasha e kthen këngën folklorike në një simbol të fuqishëm dhe me ekspresivitet të theksuar, aq sa edhe vetë kënga folklorike duket sikur ka ndikuar në portretin e saj, si mjeshtre e këngës. Kënga e Liri Rashës nuk mund të ishte e tillë e nuk mund të realizohej në nivele të tilla artistike pa aftësinë e saj të rrallë për të përvetësuar ndjenjën e mirëfilltë të folkut dibran e të shpirtit të tij tejet përjetues. Liri Rasha është një fenomen në arealin e Muzikës Folklorike Shqiptare, duke përcjellë për publikun, për më shumë se gjysmë shekulli në tërë hapësirën gjeografike shqiptare, praninë e një zëri magjepsës në dëgjim e therës në mesazh. Në tërë repertorin e saj ajo transmeton fuqishëm ndjenjën e frymëzuar nga jeta e jetuar ndër breza. Repertori i veçantë nxjerr në pah karakterin intim të gruas, vajzës, nëpërmjet një qartësie në interpretim, duke individualizuar e kristalizuar traditën e hershme të lirikës interesante të trevës e me gjerë. "Konservatorizmi" i kësaj figure të madhe të këngës folklorike në Luginën e Drinit për t'i qëndruar besnike fjalës dhe mesazhit të folklorit përmes individualitetit të saj, duke i siguruar folkut shfaqje të thjeshtë, të kuptueshme e të pëlqyeshme për publikun, ka siguruar ndër vite rritje të madhe të audiencës, sa për këngëtaren dhe këngën e saj, po aq edhe për vetë folkun. Talenti Rasha, interpretuese jo vetëm e këngës së shkurtër epike e lirike, evokon jetën e përditshme, trashëguar duke ruajtur tipare shprese shprehëse tradicionale të folklorit dibran e më gjerë e duke mundur harresën e tij e të këngës folklorike dibrane. Në të kënduarit e saj Liri Rasha krijon ndjenjë dhe sensibilitet të thellë tek adhuruesit jo vetëm dibranë ndaj traditave, duke shmangur braktisjen e përbërësve të saj, pasi shkakton mundime të thella shpirtërore te vartësit e saj dëgjues. Thënë ndryshe, kënga e Liri Rashës i përgjigjet e përputhet plotësisht me konstitucionin shpirtëror të trevës nga ajo vjen. Në tërë këngët e këtij talenti tejet interesant shkrihen në një, dy individualitete; ai i folklorit në të dyja anët e Luginës së Drinit me atë të këngëtares, duke u bërë pjesë integrale e fenomenit më interesant në këtë luginë, fenomenit muzikor Rasha, si një personalitet muzikor i papërsëritshëm. Botimin e të gjitha këngëve të saj siç këndohen, po e bëjmë për të shmangur humbjen që erozioni kohor rezervon. Ndoshta do të ndalemi më gjatë me veçoritë e kësaj kënge e zëri të rrallë e nga më të pëlqyeshmit ndër shqiptarë.

KUR E PËRCOLLA YLBERIN

Kur e përcolla Ylberin
Ktheva t'hyna ne odë
Kur ia pashë manzerin vjerrës
Ja lava me lotë.

Mos e laj me lot, oj zan
Mos e laj me lot,
Se shkon viti par, oj zano,
Sikur dita sot.

Shkuan dit e shkuan vite
Zemra m'u dogj flakë,
S'na lanë halle e s'na lanë derte
Me jetue bashkë.

Vitet e kurbetit, o Ylber,
Qofshin të mallkue,
N'danë nanë e bir, o ylber,
N"danë burrë e grue.

Mora harxhet dola në bahçe
Çorapet me shkru,
Prej mërzisë mbi çorape,
Plasa tuj lotu.

O ylber i dadës
A thu m'ke harru,
Vitet e kurbetit ylber
Qofshin të mallku!

KUR MA KTHEVE SHPINËN

Kur dola te dera
Nuk më linte vjehrra,
Shpirto, si t'bëj un' e mjera.
Vjehrra s'më linte
Se hallet s'm'i dinte
Shpirto, zemra fort po m'digjte.

Kur ma ktheve shpinën
Vera m'u bë dimër.
Shpirto, si ta kaloj jetën.
K'to muajt e dimnit
Do i vej në poll të qylimit
Shpirto, do i lidh në qosh të mindilit.

Votra qan për fmi
Nana me duar në gji
Shpirto, si t'bëjmë na pa ty
Këto muajt e gjatë
Do t'i shkruaj n'kartë.
Shpirto, do t'i mshehi n'arkë.

MOJ FUSHA E KORABIT

Moj fusha e Korabit, oh e mjera un, - o
Taj na erdhe hakut, oh e mjera un, -o
Taj na erdhe hakut, oh e mjera un, -o
Shkove u harrove, oh e mjera un, -o
Një letër s'ma çove, oh e mjera un, -o
Një letër s'ma çove, oh e mjera un, -o.

Prap' na çeli Grama, oh e mjera un, -o
Një letër s'ma çove, oh e mjera un, -o
Një letër s'ma çove, oh e mjera un, -o.

Merr pare me fajde, oh e mjera un, -o
Mos harro e hajde, oh e mjera un, -o
Merr udhë e hajde, oh e mjera un, -o.

SHTATË LIQEJT E LURËS

Shtatë Liqejt e Lurës, shtatë nota kristali,
Për një valle fushe, për një këngë mali.
Fusha këndon bukën, mali për trimërinë
Mal e zemër këndojnë bashkë
Këndojnë për Shqipërinë.
Fusha këndon bukën, mali për trimërinë
Mal e zemër këndojnë bashkë
Këndojnë për Shqipërinë.

Refreni:
Shtatë Liqejt e Lurës-o, lart për mbi pllaja,
Rrin si sytë e Shqipes-o, hapi tek kalaja.
Ky liqen i luleve, nën majën me borë,
Dëshmorëve të Lurës u qëndron kurorë.

Shtatë Liqejt e Lurës, shtatë gota dollie,
Për një valle dasme,
për një këngë trimërie.
Vallja për fitoret, besa për lirinë,
Bes' e zemër këndojnë bashkë
Për jetë me Shqipërinë.
Vallja për fitoret, besa për lirinë,
Bes' e zemër, këndojnë bashkë
Për jetë me Shqipërinë

MINE, MORI MINE

Mine, mori Mine,
Sa e mira ti më je!
Mine, mori Mine,
Sa e mira ti më je!
Dil moj te qemeri,
Se plasa i mjeri.
Dil moj te qemeri,
Se plasa i mjeri.

Fryni er e malit -o
Grykës së Radikës
Fryni er e malit -o
Grykës së Radikës

Seç ja prishi Mines-o
Gërshetat e shpinës.
Seç ja prishi Mines-o
Gërshetat e shpinës

Fryni er' e malit -o
Fushës së Korabit,
Fryni er' e malit -o
Fushës së Korabit.

Seç ia lujti Mines-o
Baluket e ballit.
Seç ia lujti Mines-o
Baluket e ballit.

SEÇ E MORA RRUGËN

Seç e mora rrugën
Për me ra në arë
Më ka dal cuca përpara
Diçka don me m'arr.
Un' i jap shaminë e kuqe,
Jelek me ar.

Refreni:
Of aman, of aman aman
Unë i jap shamin e kuqe, jelek me ar.
Fort ju luta unë asaj,
Mas meje me ardhë.
Fort ju luta unë asaj,
Mas meje me ardhë.
Rrugën bashkë e morëm
Për me ra në fushë.
Tek një krue, seç u ndalëm
Bucelën me mbush.
Zemrat tona rrahin fort
Shihemi në sy
Unë asaj i fala zemrën
M'fali syn e zi.

Refreni:
Of aman, of aman
Zemrat tona rrahin fort-o.
Shihemi në sy
Unë asaj i fala zemrën
M'fali synin e zi.
Zemrat tona rrahin fort-o
Shihemi në sy
Unë asaj i fala zemrën,
M'fali synin e zi

ÇU ÇU RRUSHJA

Çu çu Rrushja n'at sabahe
Ka la sytë ka dal n'çardak.
Dul n'çardak mori thik,
Me duar të bardha ia ka njit.
Me duar të bardha ia ka njit
Plot me rruza e bylyzik.

Plot me rruza e bylyzik,
Ç'ka don djal për drek me t'qitë.
A don pulën me ta myt-e
A don petlla e flit e grynt-e?
A don pulën me ta myt-e
A don petlla e flit e grynt-e?

E k'shtu djalin kur ma pyete
Nuk du pulen-o me ma myte-o
As du petlla e flit e grynt-e
Por mfal faqet dhe dy sytë-e.
As du petlla e flit e grynt-e
Por m'fal faqet dhe dy sytë-e.

SHËTITA ANEMBANË

Shëtita anembanë mori lule
Si hana kur bjen mram.
Si hana kur bjen mram
Si vasha yll e hanë,
Si vasha yll e hanë
Sa fort u mërzita, moj lule,
Erdha moj me të marr.
Erdha moj me të marr.

Ani un me ty moj nan e kam një fjalë
A't ta them oj nano a ta them
A't ta them oj nano a ta them
Ani moj e mira çfarë ke me m'thanë?
Moj e mira e nanës -o
Moj e mira e nanës –o.

Ani më kërkon, oj nanë, një djal i ri
A ta marr moj nanë, a ta marr?
A ta marr moj nanë, a ta marr?
Ani se ka shokun nano në malsi,
A ta marr oj nanë, a ta marr,
A ta marr oj nanë, a ta marr?

NËNTË MALET E DIBRES

Ani krisi pushka në brigje të Drini të Zi
Nëntë malet e Dibrës luftojnë për liri,
Nëntë malet e Dibrës luftojnë për liri.

Flakës së barotit si shqiponjë dibranët,
Er' e malit frynte përmbi xhamadanët,
Er' e malit frynte përmbi xhamadanët.

Hej bini burra hasmit për vatanin
Er' e malit frynte përmbi xhamadanët.
Er' e malit frynte përmbi xhamadanët
Maleve përgjakur të erdhi liria
Fanar i pashuar mbeti Shqipëria
Fanar i pashuar mbeti Shqipëria.

MORA RRUGËN MORA

Mora rrugën mora
N'festival me ardhë
Mora rrugën mora
N'festival me ardhë
O sa shumë u gëzova
O ç'gëzim i rrallë
O sa shumë u gëzova
O ç'gëzim i rrallë!

Dua me këndue
Këngë me çifteli
Dua me këndue
Këngë me çifteli.
Për jetën e lumtur
Këtu në malësi
Për jetën e lumtur
Këtu në malësi.

Zemrat tona rrahin
T'gjitha përnjëherit
Zemrat tona rrahin
T'gjitha përnjëherit.
Këndojnë lumturisë
I këndojnë Atdheut.
Këndojnë lumturisë
I këndojnë Atdheut.

Le t'i bashkojmë zanat
Kënga le të ushtojë
Le t'i bashkojmë zanat
Kënga le të ushtojë.
Nga të katër anët
Bota ta ndigjojë
Nga të katër anët
Bota ta ndijojë.

këngë



Liri Rasha është një fenomen në arealin e Muzikës Folklorike Shqiptare, duke përcjellë për publikun, për më shumë se gjysmë shekulli në tërë hapësirën gjeografike shqiptare, praninë e një zëri magjepsës në dëgjim e therës në mesazh.

KËNGA E REXHËS

Ohooo
Çou, mor Rexh, e dil te lama
Dasëm të madhe po t'ban nana
Çou Rexho, çou djalo,
Çou moj i miri i nanës -o
Se ska nana tjetër –o!
Çou Rexho, çou djalo,
Çou moj i miri i nanës -o
Se ska nana tjetër –o!

Oohoo
Po vijnë krushqit rrethit malit,
Rexha i vdekur në grasht të kalit.
Çou Rexho, çou djalo,
Çou moj i miri i nanës –o,
Ma fike kunakun -o!
Çou Rexho, çou djalo,
Çou moj i miri i nanës –o,
Ma fike kunakun –o!

Oohoo
Ti or at o t'u thaft kama
Qysh ma myte Rexhën mram-o!
Çou Rexho, çou djalo,
Çou sokoli i nanës –o,
Si ma mbylle derën –o!

Oohoo
Ju mor krushq hani e pini
Nesër Rexhën n'dhe ma shtini.
Çou Rexho, çou djalo,
Çou delia i nanës –o!
Sot ma i mir po m'dukesh -o
Çou Rexho, çou djalo,
Çou delia i nanës -o
Sot ma i mir po m'dukesh –o!



GURËT E SOKAKUT

O ju gurët e sokakut
Fal me shnet t'mi bani
Lules të zambakut
Ani si t'ia bëj i mjeri,
Jam tuj plasun prej merakut.

Hajde, hajde moj e mira e lalës-o,
Ani sa t'ashoh moj shpirto,
Gishtin e unazës –o.
Sa t'i prek baluket e ballit
Mori lulja e livadhit-o,
Sa t'i prek baluket e ballit
Moj e mira e mëhallës –o.

Moj e mira yll i dritës-o,
Ani po të pres te ura e Radikës-o.
Ani sa t'i prek moj shpirto,
Shpirt i lalës gërshetat e shpinës –o.
Ani sa t'i prek moj shpirt-o,
Shpirt i lalës gërshetat e shpinës –o.

OR BILBIL I MALIT

Zbardh e lumja dite
Nisem për në krue
E gjej ujt e kroit-o
Krejt të turbullue
E gjej ujt e kroit-o
Krejt të turbullue.

Vjen e lumja dite
E para në punë
Bilbili në degë o he
Po m'ban fjalë shumë
Bilbili në degë o he
Po m'ban fjalë shumë.

Refreni:
Or bilbil i malit
Pse më del përpara?
Ty të shoh në gjumë e ho
Ty të shoh në ara.
Ty të shoh në gjumë e ho
Ty të shoh në ara.

Vjen e lumja ditë
Ulem tu qëndis,
Bilbili për mue o he
Kangën paska nisë,
Bilbili për mue o he
Kangën paska nisë.

Shkoj e hy në valle,
Qesh fytyra ime
Vjen ulet bilbili o he
Oh mbi dorën time**.**

Refreni
Or bilbili i malit,
Pse më trazon
Gjergjefi më dridhet-o,
Gjilpana më shpon.
Or bilbil i fushës,
Ndize vallen shpuzë
Në jetë me valle-o ,
Me këngë në buzë.

NUSJA ME TË BARDHA

O moj nusja jon e me limona -o
A ma mirë te na, a te nana -o
O moj nusja jon e me limona -o
A ma mirë te na, a te nana –o.

Refreni:
Hoooo, lujma lujma belin
T'lidh lala kordelin ,
Or zambak me rrema
Dil se m'plasi zemra.
Lujma, lujma shtatin,
T'fal lala dukatin,
or zambak me rrema.

O moj nusja jon e me limona -o
A ma mirë te na, a te baba –o.
O moj nusja jon e me limona -o
A ma mirë te na, a te baba –o

AMANETI

O Shqipëtar kudo ku jeni
Amanet prej meje e keni
Mos urreni njani-tjetrin,
Mos t'harroj i riu të vjetrin.

Sa dhem gjaku, nuk dhem deti
Na e ka mësu nana tek djepi
Sa pranvera vlen liria
Por më shumë vlen Shqiptaria!

Refreni:
Ju që vini nëpër breza
Dit për ditë, e mot për mot
Ju bekoftë Nan Tereza,
Ju bekoftë i madhi Zot.

O gur e dhé ku rron shqiptari
Viset tona janë prej ari.
Mos e lini millën t'thahet
Mos e lini murin të çahet.

O shqiptar me diell mbi vetull
Bashkë e mbarë fillojmë këtë shekull
Kush inat na e ka bashkimin
E mart' deti bashkë me Drinin!



MOJ LIRI NUSE KOSOVE

Vjen një fjalë nga dielli e hana
Cilin djalë po marton nana?
Vjen një fjal' nga ylli e bora
Cilën nuse merr Kosova?

E kërkoj në gurra loti
Sytë ia lan me flak baroti,
E kërkoi Drini e gjaku
E fitoi për jetë te pragu.

Refreni:
Moj liri nuse Kosove
Tokës djegur, drit lëshove.
Mos u plaksh në votrat tona
Se Kosova o asht e jona.

Vjen një fjal nga historia
Ku i ka nuset Dardania?
Nuset janë ku fillon jeta
Tuj qëndis shqipen mbi djepa.

Ku janë malet e përflakun,
Ku janë dimrat e përgjakun,
Ku janë ikjet nga robnia,
Për mbi gur po i gdhend liria

ZOGU I VERËS

Ore zogu i majit, ore lalo ore lalo,
Ku je si s'po njihesh, ore lalo ore lalo
Hajde në pranverë, ore lalo ore lalo,
Çel lulja me erë, ore lalo ore lalo.

Pranvera na erdhi, ore lalo ore lalo,
Mali kudo çeli, ore lalo ore lalo.
Ore zog bilbili, ore lalo ore lalo,
Çeli trëndafili, ore lalo ore lalo.
Trëndafili çeli, ore lalo ore lalo,
Me gjethe boj teli, ore lalo ore lalo.
Ore zog i verës, ore lalo ore lalo,
Fal me shnet Dilberes, ore lalo ore lalo.
Dilberës me shnet, ore lalo ore lalo,
Fllanxa jemi vet, ore lalo. ore lalo.

SHKURTA E HAKLIT

Shkurta e Haklit o synin e zi
Shkurta e Haklit o synin e zi,
Lidh midisin hoj me shamie.
Lidh midisin hoj me shamie,
Plasna zemrën hoj djemve të ri.
Plasna zemrën hoj djemve të ri,
Djemve t'ri o të fshatit tonë.
Djemve t'ri o të fshatit tonë,
Sa vete o i gjej te kroni
Sa vete o i gjej te kroni
I gjej te kroni o tuj pushue
I gjej te kroni o tuj pushue
Po vjen njani o me i ndihmue
Po vjen njani o me i ndihmue.

Refreni:
Atje poshtë tek do djerrë
Ih moj lumja unë!
Pash një vashë tu ruajt do dele
Ih, moj lumja unë!
Tuj iu hudhun dal nga dal
Ih, moj e lumja unë!
Me të ndrrova dy-tre fjalë,
Ih, moj e lumja unë!
Hej mos ki frikë na pafshin bota
Ih, moj e lumja unë!
Ato janë veç fjalë të kota
Ih, moj e lumja unë!
Hej mos ki frikë na pafshin bota
Ih, moj e lumja unë!
Ato janë veç fjalë të kota,
Ih, moj e lumja unë!

MALET E DIBRËS

Malet e Dibrës janë mbushur me borë
Shtabit të përgjithshëm po i prin një malësor.
Nata asht e zezë, rruga ashtë e gjatë,
Shtigjet janë zanun, por dyert janë hapë.

Refreni:
Çan përmes stuhisë ylli partizan,
Rrezet e lirisë ndizen mbi Prodan.
Hej po nata qiellin e ka mbush me yje,
Oho në malet shqiptare po fryn fllad lirie.

Ka ardh' komandanti, nëpër shtigje lufte,
N'kasollen dibrane ka hy drit e kuqe.
Mbyllet një frëngji, hapet një dritare,
Oda është e vogël, por zemra është e madhe.

KËNGË PËR NIKOLLË KAÇORRIN

Moj Shqipni e rreptë, shkam në çdo tufan,
Sokolat që linde, vendit i lan nam.

Refreni:
Si Nikoll Kaçorri, shqipja e malësisë
Të gjithë jetën e tij ia kushtoi lirisë.
Si Nikoll Kaçorri, shqipja e malësisë,
Të gjithë jetën e tij ia kushtoi lirisë.

Pushkë edhe penën, nga dora s'i lëshove,
N'kongres t'Manastirit, bukur ligjërove.

Refreni.
Me pushkët që çove nëpër lak të konopit
Burrat e Kurbinit i zunë grykën topit.
Me pushkët që çove nëpër lak të konopit,
Burrat e Kurbinit i zunë grykën topit.
Kur n'qiellin e Vlorës, mbi tokë të zhuritur
Flamuri kombëtar, fitimtar është ngritur.

Refreni.
Me Ismail Qemalin, yllin për liri,
N/kryetar i par' u zgjodh në qeveri.
Me Ismail Qemalin, yllin për liri,
N/kryetar i par' u zgjodh në qeveri.
Shokët kur t'i lidhën, n'internim me i çue
Biri i Dibrës trime si dallgë ka qëllue.

Refreni.
Trim Nikollë Kaçorri, lulja e trimënisë
Mu në gjoks të hasmit grykën e alltisë.
Trim Nikollë Kaçorri, lulja e trimënisë,
Mu në gjoks të hasmit grykën e alltisë

DOLA JASHTË PO BINTE SHI

Dola jashtë po binte shi, o po binte shi,
Dola jashtë po binte shi, o po binte shi,
Syzeza ma ban me sy, o ma ban me sy.
Dola jashtë po binte shi, o po binte shi,
Dola jashtë po binte shi, o po binte shi,
Syzeza ma ban me sy, o ma ban me sy.
Syzeza ma ban me sy, o ma ban me sy.



Refreni:
E deshta, e mora,
Me unazë e mashtrova
E deshta, e mora,
Me unazë e mashtrova.

Dola jashtë po binte borë, o po binte borë,
Syzeza ma ban me dorë, o ma ban me dorë.
Dola jashtë po binte borë, o po binte borë,
Syzeza ma ban me dorë, o ma ban me dorë.

Refreni:
E deshta, e mora,
E deshta, e mora,
Dashurinë ia dhurova, o ia dhurova,
Dashurinë ia dhurova, o ia dhurova.
Oj luli, bukuri, si do rri lala pa ty, o pa ty!

Dola jashtë po rri n'çardak, o po rri n'çardak,
Syzeza m'ka ba marak, o m'ka ba marak.
Dola jashtë po rri n'çardak, o po rri n'çardak,
Syzeza m'ka ba marak, o m'ka ba marak.

Refreni:
Oj luli, bukuri, si do rri lala pa ty
E deshta, e mora,
Me unazë e mashtrova, o e mashtrova.

vijon numrin e ardhshëm

“Na bashkoi poezia” vjen me vëllimin e 14-të

Na bashkoi poezia -14, krijues të njohur e të rinj me një gjeografi hapësinore në trojet shqiptare,

Nga **Hava MUÇOLLARI** (Poete)

Botimi i çdo libri ka vlerat e tij të padiskutueshme, por edhe Antologjia poetike “NA BASHKOI POEZIA” libri i 14-të, përgatitur për botim nga poetët Selvije Kadriu - Prishtinë dhe Ilmi Dervishi - Tiranë, me prurjet artistike, me zëra poetikë nga trevat shqiptare, aty ku flitet e shkruhet gjuha e bukur shqipe, ka lexuesit e saj të shumtë.

Kur u botua libri i parë “NA BASHKOI POEZIA” ishte një ide e poetit Ilmi Dervishi, që u përkrah nga poetja nga Vushtria Ymrije Beqiri, ku ishin pjesëmarrës nga Kosova dhe disa qytete të Shqipërisë, por edhe nga Shkupi. Kjo përmbledhje me poezi u prit mirë, ndaj arriti deri te numri 14.

Të hartosh ose të botosh një antologji ka kriteret e veta artistike e gjithëpërfshirëse, kritere që njihen në letërsinë shqipe, por edhe europiane e botërore, e cila njihet mirë nga studiuesit dhe botuesit.

“NA BASHKOI POEZIA”, vëllim ku përfshihen krijues të njohur e të rinj me një gjeografi hapësinore në trojet shqiptare, të cilët i bashkon poezia me vlerat e saj të padiskutueshme shpirtërore dhe artistike.

Vëllimi 14-të “NA BASHKOI POEZIA” u botua në mars 2023.

Shpesh për disa nga këto botime janë bërë dhe promovime si në qytetet: Prishtinë, Tiranë, por edhe në Korçën e bukur. Janë mbledhur poetët pjesëmarrës, janë njohur nga afër me njëri- tjetrin, kanë shkëmbyer mendime mbi botimet e tyre, duke bashkëbiseduar dhe me lexuesit dhe dashamirësit e poezisë.

Suksese në botimet në vazhdim

Tiranë, mars 2023



KOHË E IKUR!
Albina Dokollari

Të kthehem në kohë vështirë për mua,
sa çaste mund të jenë deri më tani?!
Sa shumë po duken me vete thua!
Ama je po prapë Ti.....

Nxitove në kohë se deshe të arrish,
çfarë nuk kërkove, por ti s]mund ta dish,
se koha e ikur të duket shumëfish,
Mundohesh ta kapësh, të ecësh bashkë me të,
por sa e sa here ajo mbrapa të lë....

Ah shpresëpakët sa iluzion ushqen,
se veç tepër mundohesh e shumë prapa veten e gjen...
Vrapo, vrapo, se e munde për pak....
çdo tik-tak që shkon një ëndërr më pak!

Si Penelopa antike me trikon e thurur,
kur kthehesh ti mbrapa sa pak ke arritur...
A kuptove se me kë je matur?!
Ah natyrë e brishtë, koha të ka mundur!

HEROINAT E MIA
Athina Bino

Këto duar që shkruajnë sot,
larë janë me ujë, djersë e lot.
Lindur veç për të punuar,
rropatur, lodhur, stërmunduar.

ABC-ne, mësuan e shkronjat,
penën kapën, u treguan të zonjat.
Fëmijërinë me thonj e grisën,
me gjilpërë qepën, qëndisën.

Që të merrte udhë rinia,
zgjatën krahët të dashuria.
Ndal!- i thanë, mos prek me duar!
Lotët valë... ish e ndaluar.

Ku t’i mbaje, ku t’i çoje?
Doje të përkëdhelje, doje të përqafoje!
Këto duar, sa shumë u përpoqën,
dhembin, çajnë, s’u tërhoqën!

Mbajtën aksioneve, bel e lopatë
Fëmijë rriten, si nënë ditë e natë.
Karabinën zboreve shtrënguan,
Luftuan me “hiçin”, u detyruan.

Transformuar. Si janë gjallë?
Mërgimit, punë shtatë ballë!
Lot fshijnë dhe sot mbi letër.
“Heroinat e mia”...rezistojnë patjetër!

SOKAKUT KUR SHKOJE
Burbuqe Agolli

Ëmbëlsirë më thua,herë bakllava,
më duket çudi,ndofta bën shaka,
çupka më e mira në atë farefis,
si yll vetëtinje, kur dilje mexhilis.

Kur shkoje sokakut, bukuri e rrallë,
e mençur e shkathët, trupin porsi ngjale,
pas teje marrosur, rashë në dashuri,
të gjithë që na shihnin na kishin zili.

Më puthje në buzë, erë merrje ne gji,
fustani bukur rinte, si lulja në saksi.
të fala buzëqeshje, me dhe mençuri,
me nishan në faqe, si një kullumbri.

Vitet ikin shkojnë,ashtu dhe kjo ditë,
mosha bën të sajën, gjithçka u venit,
bukuria iku si Zana në përrallë,
pleqërisë së shkretë, dua t’i bëj ballë.

NA MUNGON
Bujar Muça
(Babait Jonuz Muça, ndarë nga jeta më 3.5.2019, atë ditë që kishte ditëlindjen)

Bosh po më duket shtëpia,
Kur kthehem nga puna të pushoj,
Në çast më kap mërzia,
Zërin e babës nuk e dëgjoj.

Lulet të vyshkura më duken në ballkon,
Asnjë gjurmë nëpër shkallë,
E ndjej vërtet se më mungon,
Kthej i Zabitit pa fjalë.

Dhimbjen për prindërit e di,
Çdo fëmijë e ndjen patjetër,
Mua më mungon më shumë tani,
Prindi s’është kurrë i vjetër.

KAM MALL
Ergen Alia

M’ka marrë malli për brigjet t’Drinit,
Kam mall për aromën e lules blinit,
Kam mall për ujët e freskët,
Atë që gjendet n’majë t’bjeshkës,
Kam mall për shiun e vjeshtës,
E për frutat varun anës s’derës.
Kam mall t’përshkojë rrugët anës Drinit t’Zi,
Që kam përshkruar kur kam qenë fëmijë,
Kam mall të përjetojë përsëri atë liri,
Kam mall të ndjej prapë atë nostalgji,
Kam mall të zgjohem me pamje bukuri,
T’shoh majën e malit t’Korabit plotë krenari.

Kam mall t’luaj top me
këmbëzbathur n’baltë,
Kam mall t’lahem në Dri të Zi kur bën vapë,
Kam mall t’shohë nënën ulun
n’ballkon t’shtëpisë....
Kam mall t’ndaj bukën me sheqer
me shok t’fëmijërisë....
Kam mall për malet e larta t’vendit tim,
Kam mall për atë toke
ku do t’pushojë trupi im.

SHPIRT I BARDHË
Selvije Kadriu Vllasi

Ti shpirt i bardhë,
Që ia fale jetën,
Engjëllit tënd pa krahë,
Ti që veten e harrove,
E mua asnjëherë,
Ta thashë njëherë,
Se kjo është arsyeja,
Që të dashuroj,
Edhe më shumë ty,
Ti je i mirë,
Je ashtu si të ëndërrova,
Edhe pse më mungon,
Unë prapë do të të dua,
Ajo buzëqeshje e jotja,
Do të mbetet gjithmonë,
E njëjta për mua.

PËRSHËNDETJE PRANVERË!
Fiorela Kofsha

Një pranverë me ngjyra plot,
sa e bukur është dita sot,
mirë se ardhjen të uroj moj pranverë,
sa e lulëzuar je këtë herë.

Një pranverë me ngjyra plot,
unë nuk të përshkruaj dot,
sa e mirë qenke bërë,
ti pranverë je shumë me vlerë,
me këto lule që mbajnë aromë.

AGULIÇJA IME
Fiqiri Bruçi

Prilli Runjës borën po ja shkrin,
aguliçja ime mbi borën lulëzon,
verdhon shpateve mbi kaltërsinë,
primula veris, pranverën lajmëron.

Erdhe sivjet, si çdo herë,
e para e verës, verdhon xhelozi,
troket si lajmëtare derë në derë.
kokën tund shpateve me freski.

Do ta mbledh një tufe aguliçe,
dhe një buqetë tjetër me lule zoje,
shpatit të Runjës në livadhe e brigje,
si bleta mjaltin me nektar nëpër hoje.

FJOLLA
Jahe Delia

E shtrenjta ime, dhjetë vite mbushe,
Sa shpejt u rrite, mbesa ime,
Fjolla, s’të vura dot emër lule fushe,
Emër lule bjeshke, vetë të zgjodha.
Sa fort të gënjyem, sa fort,
Se babi do kthehej nga qielli,
Por, u rrite, s’të gënjenim dot,
Për t’vërtetën e qartë si dielli.

Ikën vitet, u bënë dhjetë,
E vockël ishe kur me të je ndarë,
Dhe pse di gjithçka, prapë del e pret,
Në qafë t’i hidhesh, ta puthësh me mall.

Mund të bëhesh sportiste, shkencëtare,
Ai emër t’ju ndrijë si diell,
Me motrat të jeni krenare,
Për këtë vend, për ju,
Ai mbeti në qiell.

Përshëndeti atë prill nga t’çarat e borës,
Ato lule fjolla që sa kishin çelur,
Nga avioni n’qiell valëvitja e dorës,
Duke t’përshëndetur, përjetë ka ngelur.

LABIRINTI I JETËS..!!
Manushaqe Ismailaj

Gjendur në labirintin e jetës,
Mes llavës që çdo çast shpërthen!
Llogaritur në frymarjen mbetës,
Disa kokëriza lumturie gjen!

Labirintin e jetës përshkroi,
Drita jeshile tregon shpresë!
Miresin te të gjithë përçoi,
Lumturia midis nesh do mbes.

S’do rend si maratonomak,
Dhe nga qielli s’do pres !
Do buzëqesh dhe kur marr pak,
Dhe përsëri dashuria do mbes!

Me fije ari thura mirësinë,
Shpirtin e ushqeva me bardhësinë!
Dashurinë e pajtova me krenarin,
Dhe e lumtur fitova miqësinë!

MOS HESHT!
Mirsida Daci

Mos hesht!
Edhe pse je femër
Edhe nëse lumenjtë paragjykues
do të vërshojnë drejt teje
Ti mos hesht!
Grise tylin e shkëlqimit të rremë
të “shoqërisë së civilizuar”!
kjo botë është ndryshe
nga ajo që shikon.
Mos hesht,
por ndiqi ëndrrat e tua!
Edhe nëse bota është kundër
zbuloje enigmën e fshehtë të jetës!
Mos hesht,
por tregoji botës se ti vlen
Vlen shumë më shumë
nga sa mendojnë për ty.
Ti je femër!
Je krenaria më e madhe e gjithkujt!

MËSUESIT TË PARË
Selim Çerpja

Ne ishim përballë,
Me vete: A thua kam shkarë?
Mendjen sillja vërdallë,
Do jetë vërtetë mësuesi i parë?

Gazetari që kish pranë,
Më tha është Lavdrim Shehu,
U ngrita me respekt në këmbë,
Se mendja s’më gënjeu.

Të dy të thinjur 55- vite kaluar,
Kur ky më merrte për dore,
Më ndriti sytë nga i “ verbuar,,
Duke mësuar e shkruar në fletore.

Ti më ule së pari në bankë,
Me ty fillova, jetën time,
Fëmijë dhe qaja, më këndoje këngë,
Për mua rreze drite, ti në agime.

Respekti për ty dhe çdo mësues,
Sa deti që nuk shteron ,
Gjurmë në shpirt si PAPIRUS,
Udhërrëfyesit e jetës që vazhdon.

Sa të ec Hana me yje,
Dhe Dielli të mbesë rreze arë ,
Do ju kem simbol krenarie,
Ty mësuesi im i parë... !

SYTË E TU TË HESHTUR
Masllan Meçi

Sytë e t të heshtur dua t’i shoh,
Trupin tënd si selvi kush s’e lakmon.
Të vërtetën në shpirt ty ta zbulova
Dhe unë me ty u dashurova.

Njeriu që deshe në këtë butë më shumë,
Ti je ajo femër që të dua shumë.
Zemra ime është gjithë ngrohtësi,
Për ty unë kam dashuri.

Shpirti im ngroh porsi dielli,
Ti ke bukuri si trëndafili,
Ti je ëndrra ime që shumë e dua,
Vetëm ti e dashur je jeta për mua.

ASAJ- GRUA
Minivere Muja Maka
Për ditën e poezisë)

Në ujëvarë të ëndrrës
Fshehe lotin valë
Se ata të thanë
E plagën e hapur ta lanë
Flluskat e spërkalat e jetës
I prite me lahurinë e bardhë
Një shpresë mbi ëndërr ndërtove
Uragan mbi barbanë kalove
Në heshtje qave
Por s’mallkove
S’u dehe por rënkove
E jetën mallkove
Shtigjeve të jetës
Pa dashuri u fale ëmbëlsi
Gjëmë mbi to s’la
Ece me fishkëllimën e fishekut
Te ruajtur diku ne pajë
Erën e barotit shpesh e ndieje
Kur drenushes i lidhje plagën
Te marrë qëmoti
I flisje për të ndaluarën dashuri
Të varrosur
Se ashtu të thanë
Vitet me trishtim mbi plagë
Radhite
Në duar mallkoje fishekun
Urreje pajën e marrë me vete
Bashkë me shtratin e vdekjes

STOLI I VETMISË
Ramadan Topuzi

Sot bisedova me stolin tonë
Sa kujtime të bukura më rrëfeu
E ndjeva ngrohtësinë e stolit
Përzier me çastet e lumtura që kaluam
Qëndrova gjatë mbi stol
Se njëmend biseda qe e këndshme
Deri kur stoli nisi të ftohej
Se kujtimet e rrëfyera
Mu përzien me harresën tonë
Tek po largohesha
Më dhembi shpirti
Si kështu vallë?
Nuk qëndrojmë dot më mbi të
...stoli ka mbetur shkretë
Askush nuk ulet më këtu
Thonë se ky stol ndjell ters
Madje e kanë pagëzuar
Me një emër të tmerrshëm
“Stoli i vetmisë”.

SHOQE FËMIJËRIE
Pamela Telo

Je ti pjesë e jetës sime,
Je në të mira e gëzime,
Je shoqe fëmijërie që ndajmë shumë gëzime,
Shoqëria jonë gjëja më me vlerë,
Do të më kesh pranë mua kurdoherë,
Ndoshta të kam lënduar,
Por ti kurrë s’je larguar,
Pranë meje në ditët më të vështira ke qëndruar,
Je mike e vërtetë,
Si ti s’ka të dytë në jetë.

JANË BOMBË EMOCIONET
Suzana Rama

Nuk di këtë buzëmbrëmje se ç’ ndjej,
teksa dita thyhet dhe shkon të flejë,
ndërsa nata krahët po shtrin me terr,
diçka më ngacmon e dot nuk e gjej.

Gudulisem tek mundohem të zhbiroj,
tek e shkuara e largët, në atë kohë,
të zbuloj të harruar ndonjë emocion,
e kotë, vitet i paskan mbuluar me llohë.

Bie shi sot, ashtu hollë - hollë, shtruar,
moti është ftohur dhe fryn pakëz erë,
prej kohësh nga kujtimet jam e larguar.

PSE HESHT
Ymer Z. Troshupa

Ç’ke Lahutë që thellë ke heshtur,
Zgjohu pak me melodi,
Merrja valles së pa reshtur,
S’paku ti mos mbaj më zi.

Ke vajtuar në kohë të vështira,
A mos ndoshta të kanë mashtruar,
Që kanë ardhur sot kohë më të mira,
E s’ju duhesh më për t’vajtuar.

Largo pluhurin ndezur zjarr,
Ende kohërat nuk kanë ndryshuar,
Mbaje ritmin më heq mall,
Fillo prapë ti me vajtuar.


Mal me mal ti zërin lësho,
Edhe brigjet le të flaken,
Këtij populli një gjë iu kujto,
Se vajtimet kurrë nuk plaken.
Ato janë ajka e mllefit,
Përmes këngës zemra çmallet,
Disa n’valle bëjnë qef vetit,
E të tjerëve brendësia u kallet.

Ec lahutë mos më braktis,
Ti me tela e unë me shkrim,
Që nga sot du me u nis,
Qofshim s’bashku deri në amshim.

cyan magenta yelloë black

arsim







Respekt dhe mirënjohje për mësuesit e mi

Nga **RASIM HOXHA**

Si të gjithë të tjerët që kanë mbaruar mësimet në shkolla të ndryshme dhe kanë respekt për mësuesit e tyre, edhe unë kam respekt për të gjithë mësuesit e mi, që nga klasa e parë e shkollës fillore e deri te pedagogët në shkollën e lartë. Meqenëse nuk mund të shprehem për të gjithë, dua të shprehem për tre mësues.

MYSLIM SHEHU (BAFTJARI)

Fillova klasën e parë në shkollën "Demir Gashi" në Peshkopi. Në klasë të parë kisha mësuese një zonjë nga Elbasani, e cila quhej Zyra. Vitin e dytë e fillova me mësuesen e nderuar dhe të respektuar Drita Zhulali. Bëmë vetëm semestrin e parë, mbasi në semestrin e dytë u hap shkolla fillore në Pilafe, ku do të mësonin të tre fshatrat: Pilafe, Tomin dhe Rashnapojë.

Myslim Shehu, me punën e tij të shkëlqyer si mësimdhënës dhe me sjelljen e tij me të gjithë prindërit e të tre fshatrave, u bë personi më i respektuar. Jo vetëm ne nxënësit, por edhe të gjithë fshatarët i flisnin me *Zotni Mësues* dhe jo në emër.

Mësuesi që do t'i jepte mësim klasës së dytë e të katërt (mësim me klasa kolektive I dhe III bashkë dhe II dhe IV bashkë) ishte zotni Myslim Shehu.

Që ditën e parë të mësimit mësuesi na priti me dashamirësi, sikur të ishim fëmijët e tij. Mbasi bëri njohjen me të gjithë fëmijët, ai u interesua për të mësuar edhe për prindërit tanë dhe për ndonjë problem që mund të kishte ndonjëri prej nesh.

Mësuesi, si një mësues me shumë përvojë dhe metodist i shkëlqyer, që në orët e para të mësimit na bëri që ta ndjekim me shumë vëmendje. Mësuesi nuk kishte nevojë të na tërhiqte vërejtjen për ta ndjekur, mbasi të gjithë nxënësit e ndiqnin me vëmendje. Edhe kur bënte kontrollin e dijeve, mësuesi ishte shumë i vëmendshëm dhe na bënte ne nxënësve të tij që të ishim të qetë gjatë përgjigjes. Rezultatet e shkëlqyera të punës së tij u konkretizuan në mbarim të vitit shkollor. Në atë kohë në klasën e katërt fillore jepeshin provime në disa lëndë. Shkolla e Pilafes i dha provimet në shkollën "Demir Gashi" në Peshkopi. Rezultatet e nxënësve të Pilafes qenë në nivel më të mirë se të atyre të qytetit. Ky ishte rezultati i punës së kujdesshme dhe plot pasion të mësuesit tonë.

Shkolla e Pilafes, si e re që ishte, kishte mjaft probleme për të zgjidhur. Problemi kryesor ishte sigurimi i druve për ngrohje. Ditët e fillimit, të gjithë fëmijët merrnin nga dy copa dru për të siguruar ngrohjen. Mësuesi mendoi se kështu nuk mund të vazhdohej gjatë gjithë dimrit. Ai takoi të tre kryetarët e këshillave të tre fshatrave dhe arriti ta zgjidhte: për gjithë dimrin drutë do të vinin nga kryetarët e këshillave.

Vitin tjetër shkollor isha nxënës i klasës së tretë. Mësuesi mori në atë vit klasën e parë e të tretë. Gjatë atij viti puna vazhdoi në një nivel më të lartë, sepse tashmë mësuesi na njihte ne dhe ne, gjithashtu ishim mësuar me mësuesin. Ne e respektonim atë jo, thjesht si mësues, por edhe si prind. Për çdo problem, sado të vogël që të kishte një nxënës, ai menjëherë do të kontaktonte me prindin për të sqaruar gjithçka dhe për të bërë të mundur që nxënësi të mos kishte shqetësim. Mësuesi merrte kontakt me të gjithë prindërit e fëmijëve. Këtë e bënte jo duke i thirrur që të vinin në shkollë. Ai shkonte në çdo familje në të tre fshatrat dhe bisedonte me prindërit e nxënësit për të rregulluar të gjitha problemet që mund të kishte. Rezultatet në mësime vazhdonin të ishin shumë të mira e të qëndrueshme. Kjo u vërtetua edhe nga kontrolli që erdhi nga seksioni i arsimit të rrethit.

Mësuesi u familjarizua me të gjithë fshatarët. Ishte koha kur besimi ishte i lirë dhe mbahej ramazan e bëheshin festa fetare. Mësuesi ishte i ftuar gjithmonë. Sipas mundësive ai merrte pjesë në këto festa. Kjo e bënte mësuesin të respektueshëm, jo vetëm nga ne nxënësit, por edhe nga të gjithë fshatarët. Duke marrë pjesë në këto festa, ai konstatonte se nxënësit e tij, ndonëse ishin fëmijë, mbanin ramazan. Pas këtij konstatimi ai ndërhyri te nxënësit që ta prishnin ramazanin. Pati nxënës që nuk e pritën mirë atë veprim. Mësuesi për të na bindur ne për veprimin që bëri, ditën tjetër solli në shkollë djalin e tij, Hasanin, i cili ishte moshatar me ne dhe nuk mbante ramazan. Kështu na bindi ne që të mos mbanim ramazan.

Me punën e tij të shkëlqyer si mësimdhënës dhe me sjelljen e tij me të gjithë prindërit e të tre fshatrave mësuesi u bë personi më i respektuar. Jo vetëm ne nxënësit, por edhe të gjithë fshatarët i flisnin me Zotni Mësues dhe jo në emër.

ADEM SHEHU

Mbarova shkollën fillore dhe në vitin shkollor 1958-1959 fillova shkollën shtatëvjeçare "Demir Gashi" në Peshkopi.

Në këtë shkollë në atë vit ishte drejtor zotni Adem Shehu, të cilin e kishim edhe mësues të gjuhës dhe të leximit.

Ishte metodist shembullor. Në çdo orë mësimi me mësues Ademin ne e ndjenim veten shumë mirë. Që në fillim mësuesi u kujdes që nxënësit që vinin nga fshati të mos diferencoheshin nga nxënësit e qytetit. Kam shumë kujtime nga mësuesi. Ato kanë ngelur të freskëta në kujtesën time.

Një orë mësimi në " lexim letrar" - kështu quhej në atë kohë lënda. Tema e mësimit "Dashuria e nanës". Flitej se si një zog shpëton të vegjëlit e tij, duke hyrë edhe në gojë të gjarprit. Shpjegimi qe aq i mrekullueshëm, sa pothuajse të gjithë nxënësit po qanin. Përvetësimi i mësimit nga shpjegimi ishte 100%.

Mësuesi i vinte shume rëndësi përvetësimit të dijeve nga nxënësit. Por ai vlerësonte shumë edhe kalitjen e vullnetit për punë. Kërkonte nga të gjithë nxënësit që të punonin duke i lexuar sa më shumë të gjitha mësimet. Në një orë mësimi pyeti dy nxënës. Njëri ishte nxënës i mirë dhe mësuesi e vlerësoi me 3 e gjysmë (nota më e mirë ishte 5); tjetri ishte nxënës mesatar dhe mësuesi e vlerësoi me 4 plus. Përgjigjja sipas konceptit të nxënësit ishte e njëjtë. I bëmë pyetje mësuesit për vlerësimin. Ai na u përgjigj, duke pyetur dy nxënësit. E pyet nxënësin e mirë sa herë e kishte lexuar mësimin dhe ai përgjigjet: 2 herë; nxënësi mesatar përgjigjet: 13 herë. Pas këtyre përgjigjeve mësuesi na tha: Ky që e ka lexuar dy herë, po të vazhdojë kështu, nuk do jetë më nxënës i mirë, ndërsa ky që e ka lexuar 13 herë, nuk është sot nxënës i mire, por do të bëhet shumë shpejt nxënës shumë i mirë.

Zemërgjerësia e mësues Adem Shehut dhe dashuria për nxënësit shfaqej në çdo moment që i jepej mundësia. Ai ishte metodist shembullor. Në çdo orë mësimi me mësues Ademin ne e ndjenim veten shumë mirë.

Drejtor Ademi bënte punë shembullore në drejtimin e këshillit pedagogjik. Mundohej që nxënësit që vinin nga fshatrat të mos ndiheshin inferiorë me nxënësit e qytetit. Këtë e bënte vazhdimisht gjatë gjithë punës në shkollë. E bënte edhe në aktivitetet jashtëshkollore, duke i aktivizuar edhe nxënësit që vinin nga fshati.

Kujtoj kur u bë mbrëmja e fundit të vitit. Nxënësit më të mirë dërgoheshin në mbrëmjen qendrore që bëhej në shkallë rrethi. Dhe drejtori, për herë të parë dërgoi edhe një nxënës nga fshati. Ky ishte Kalosh Tomçini.

Kur unë mbarova shkollën shtatëvjeçare dhe fillova shkollën pedagogjike mësues Ademi tani ishte nëndrejtor konvikti i shkollës pedagogjike. Në këtë detyrë mësuesi qe më shumë një prind sesa një drejtues.

Do të kujtoj tri gjëra:

Ishte dimri i vitit 1962-1963. I ftohtë ekstrem. Temperaturat arritën në minus 22 gradë. Drejtori kishte shqetësimin për t'u siguruar fëmijëve kushte për të fjetur. Në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës vendosën që një pjesë të nxënësve konviktorë t'i merrnin nxënësit e jashtëm nëpër shtëpitë e tyre (nga 2-3 veta); pjesën tjetër - në një kapanon me soba me dru për t'i ngrohur. Nxënësit flinin, ndërsa drejtori rrinte gjithë natën duke i kontrolluar e mbuluar jo si drejtor, por si prindi që rri zgjuar për fëmijën e vet.

Nxënësit konviktorë që thyenin disiplinën mund të përjashtoheshin nga konvikti. Ishte masë për thyerje disipline. Mësues Ademi nuk e bëri as edhe për një rast të vetëm këtë.

Zemërgjerësia e tij dhe dashuria për nxënësit shfaqej në çdo moment që i jepej mundësia. Meqenëse ishte nëndrejtor konvikti, kishte informacion edhe për mundësinë për të futur në konvikt nxënës. Meqë kishte një variant të tillë, njofton një nxënës mesatar, por që kishte nevojë ekonomike. Nxënësi shkon në konvikt dhe e regjistron. Kur nxënësi futet në mensë dhe ha një vakt, "vigjilenca e Partisë" e konstaton dhe e detyrojnë mësues Ademin ta largonte nga konvikti se ishte me biografi të keqe.

Kur unë arrita në vit të tretë të shkollës, mësues Ademi kaloi si mësues i pedagogjisë praktike, që e bënin nxënësit e viteve të treta e të katërta. Si normalist, me aftësitë e mrekullueshme për mësimdhënien, të gjithë ne që patëm fatin ta kishim mësues të pedagogjisë praktike, mësuam shumë prej tij dhe u përgatitëm për të qenë të aftë për të bërë mësim në të gjitha shkollat, ku na emëruan pasi mbaruam shkollën pedagogjike.

KADRI ZHULALI

Pasi mbarova shkollën shtatëvjeçare, në vitin shkollor 1961-1962 fillova shkollën e mesme pedagogjike, Peshkopi. Shkolla kishte një staf pedagogjik të një niveli të lartë pedagogjik - duke filluar nga drejtori i shkollës, Zenel Sula dhe gjithë të tjerët. Por unë dua të veçoj pedagogun Kadri Zhulali.

Kadri Zhulali, përveç punës shumë të mirë si mësimdhënës, e cila u pasqyrua në rezultatet në mësime të të gjithë nxënësve, profesori qe edhe edukator shembullor. Ai shoqërohej me të gjithë nxënësit, sikur të ishte shok i tyre

Profesor Kadriu jepte lëndët e matematikës. Ishte i ri në moshë dhe në eksperiencën e punës, por me dëshirë dhe vullnet të madh për punën e tij si mësues, për të përgatitur mësues të rinj. Prezantimi i tij para nxënësve qe i thjeshtë dhe mbresëlënës. Ai na ftoi ne nxënësve për bashkëpunim me të për të bërë të mundur realizimin e programit mësimor, që ishte detyrë e të gjithëve - e nxënësve dhe mësuesit. Siç dihet, lëndët e matematikës janë më të vështirat për t'u përvetësuar nga nxënësit. Profesori, duke e ditur këtë fakt, kishte programuar, përveç orëve të mësimit, edhe program shtesë konsultimesh për të gjithë nxënësit, të cilët vinin nga shkolla të ndryshme dhe nga vende të ndryshme të Shqipërisë Verilindore. Puna me nxënësit vazhdoi në mënyrë sistematike dhe pa ndërprerje. Ajo i dha rezultatet e veta dhe në provimin semestral, që jepej në atë kohë në shkollën pedagogjike, rezultatet e nxënësve qenë të mira. Ai përdorte metoda të ndryshme pedagogjike për të bërë të mundur rritjen e nivelit të dijeve te nxënësit dhe mundësisht, për të arritur të gjithë nxënësve rezultate maksimale. Ngriti grupe me nga katër nxënës. Çdo grup kishte një nxënës shumë të mirë dhe kishte tre nxënës në një nivel më të ulët. Nxënësi i mirë do t'i ndihmonte shokët për të rritur nivelin e nxënies së dijeve dhe për të bërë të mundur përvetësimin e programit mësimor në lëndët e matematikës.

Përveç punës shumë të mirë si mësimdhënës, e cila u pasqyrua në rezultatet në mësime të të gjithë nxënësve, profesori qe edhe edukator shembullor. Ai shoqërohej me të gjithë nxënësit, sikur të ishte shok i tyre. Ai kishte hequr barrierën ndarëse të pedagogut me nxënësit; përkundrazi, kishte krijuar një lidhje me nxënësit, e cila jepte rezultatet në mësime. I miqësuar me nxënësit, ai mësonte edhe ndonjë hall që mund të kishte ndonjë nxënës dhe ndërhynte, duke e ndihmuar për ta zgjidhur. Në vitin e parë, shumë nxënës që vinin nga rrethe të tjera dhe që jetonin në konvikt, mërziteshin dhe mendonin të largoheshin nga shkolla. Profesori bëri të mundur që disa nxënës që donin të linin

(Vijon në faqen 19)





Për tre mësues të gjuhës shqipe nga katundi Vleshë

Nga prof. HAJRI SHEHU

Tre mësues gjuhe nga katundi Vleshë. Në vitet '50. Ata ishin **Femi Xhepa**, **Halim Shehu** dhe **Hivzi Shehu**. Të tre kishin mbaruar Medresenë e Naltë në Tiranë. Programi mësimor i Medresesë ishte mjaft i gjerë e mjaft formues. Edhe për dije të përgjithshme. Mësues Hivziu më ka treguar shënimet për lëndën filozofi. Dhe jam habitur kur kam lexuar faqe të tëra për Platonin dhe platonizmin. Në Medrese mësoheshin edhe dy gjuhë të Lindjes – arabishtja dhe persishtja. Nga gjuhët e perëndimit – anglishtja. Të tre mësuesit ishin, vërtet të formuar gjuhësisht. Kjo dukej nga mënyra si e jepnin mësimin në klasë. Edhe nga shkrimi, nga kaligrafia. Kishin një shkrim të bukur, thuajse njëlloj. Të tre mësuesit u bënë drejtorë njëri pas tjetrit në shkollën 7-vjeçare të Sllovës. Sllova ishte lokalitet. Pas drejtorisë së Sllovës, mësues Hivziu kaloi inspektor në Seksionin e arsimit të rrethit Peshkopi, kurse mësues Femiu u transferua në Fier.

Po kthehem te mësues *Femiu*. Ishte autoritar në shkollë e në klasë – si drejtor e si mësues. Dhe autoritetin ia jepte puna. Në klasë dëgjohej vetëm fjala e mësuesit dhe përgjigjja e nxënësit. Ishte i përpiktë në gjithçka. Do të jap një shembull shumë të thjeshtë: Rruga për në shkollën 7-vjeçare të Sllovës ishte me baltë. Mësues Femiu, njëherësh, drejtori i shkollës vinte me çizme. Asnjëherë nuk i kemi parë çizmet e mësuesit me pikla balte. Duket, diku, te një krua para se të mbërrije në shkollë, i lante. Jaka e bardhë e këmishës i ndrinte. Ishte, vërtet mësues. Me shembullin e tij edhe në paraqitje, edhe në veshje. Sepse mësuesi e dinte që nxënësit janë tërë sy. E dinte që nxënësit e kanë mësuesin model në jetën e tyre.

Ishte aq kërkues në mësim. Dua të them që plotësat (sot, termi është *rrethanorë*; i përkasin sintaksës këta) i kemi mësuar nga mësues Femiu. Me shembuj e me logjikë (sepse sintaksa do arsyetim) mësuesi na i nguliti në mendje. Dhe nuk e teproj po të them se ne bënim në klasë analiza sintaksore, siç i kemi bërë më pas në Shkollën Pedagogjike, në Peshkopi. Po të pyeten, kështu do të thonë edhe Bajram Çekiçi, Ajet Shehu, Faik Shehu, Ibrahim Daci, Misim Shehu, Sejdi Hysa – ish-nxënës të mësues Femiut e më pas – mësues vetë. Gabime në shkrim – në detyra shtëpie, diktim e hartim?! Ku lejonte mësues Femiu ta vije ë-në aty ku nuk duhej.

Në shkollën fillore, në klasën e dytë e të tretë, mësues Femiu na mësoi të folurit dialogjik. Copat e këndimit, si "Dy qetë dhe ujku" ne i luanim si "teatër" në klasë. Dhe jo vetëm që nuk kishim asnjë lloj impresionimi, por kënaqeshim dhe mezi prisnim orën e nesërme të leximit. Metodokisht, interpretimi ynë ishte zhvillim i të folurit – aq i kërkuar në punën mësimore me nxënësit, sidomos për ne në fshat.

Ma ka dashur puna të lexoj revista islame, botime të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë – "Zani i Naltë", "Njeriu" e



Femi Xhepa

"Kultura islame". Jam befasuar kur kam gjetur dy shkrime të nxënësit Femi Xhepa në revistën "Kultura islame". Shkrimet ishin dinjitare si për një kulturolog.

Mësues Femiu u transferua në Fier. Nuk e mbaj mend vitin, por duhet të ketë qenë pasi ne nxënësit e tij e kishim mbaruar 7-vjeçaren. Na vinte keq për brezat e nxënësve pas nesh: Ata nuk do ta kishin në shkollë e në klasë mësuesin e ditur e të përkushtuar – Femiun.

Mësues *Halimi*. Mësuesi ynë i historisë (duket, iu caktua historia e jo gjuha) dhe drejtori në shkollën 7-vjeçare të Sllovës. Do të përmend vetëm tri vlerësime për drejtor Halimin:

Drejtori krijoi pemëtoren e shkollës. Në anë të majtë të ndërtesës së shkollës ishte një brinjë jo e vogël. Nxënësit hapën gropat: 2-3 nxënës një gropë. Veglat e punës i merrnim nga shtëpia. U bënë gropat. Erdhën fidanët e mollëve nga Peshkopia. Dhe i mbollëm. Duhet të ketë qenë viti shkollor 1954-1955. Puna e mëtejme? Secila dyshe a treshe e nxënësve kujdesej për mollën që kishte mbjellë. Pra, edhe verës, kur nuk kishte mësim. A ka punë më të mirë bujqësore – mësimore, shkollore e zelltare se kaq? A ka mësim e edukim më të mirë botanik e bujqësor se kaq? Çdo nxënës a nxënëse kishte mollën e vet. Dhe ne përpiqeshim secili t'ia kalonim shokut e molla jonë të rritej më shumë e të bënte kokrra më shumë. Dhe kështu u rritën mollët, u hijeshua shkolla. Edhe sot mollët e hijeshojnë shkollën e Sllovës.

Drejtor Halimi krijoi grupin artistik të shkollës e të zonës. I binte shumë mirë violinës. Dhe violina e mësuesit na ka gëzuar kushedi sa herë në raste festash. Dhe Sllova zinte gjithnjë vendin e parë në rreth në festivalet folklorike.

Erdhi rasti që unë shkova me punë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë. Duke ia njohur përgatitjen gjuhësore, korrektësinë në gjithçka dhe përkushtimin kur merrte përsipër një punë, i them: A mund të mblidhni fjalë të rralla të gjuhës shqipe e t'i sillni në Institut ? Po, - tha, - por do të më shpjegosh diçka: ç'fjalë duhen, si të regjistrohen etj. Mjaftoi vetëm gjysmë ore me ca shpjegime e shembuj konkretë. Dhe mësues Halimi ka sjellë dhjetëra e dhjetëra fjalë popullore nga e folmja e tij. Mbaj mend, për shumicën e fjalëve, subjekti ishte e shoqja – një grua mjaft e zgjuar dhe mjaft e zonja. Profesor Androkli Kostallari (akademik), drejtor i Institutit e ka vlerësuar dhe falënderuar mësues Halimin herë pas here, me letra zyrtare si titullar i Institutit.

Do të kthehem te mësuesi im më i parë – *Hivziu*. Edhe në shkollën fillore, edhe në shkollën 7-vjeçare. Më pas, siç edhe u përmend, mësues Hivziu u bë inspektor dhe e njohën të gjitha shkollat e rrethit dhe të gjithë mësuesit e rrethit. E njohën për dijen e tij, korrektësinë e tij, udhëzimet e tij metodike e pedagogjike dhe fjalën e tij prekatare.

Fjalën prekatare të mësues Hivziut e kam pasë parë edhe në odat e fshatit. Edhe, në mbledhjet e këshillit pedagogjik të shkollës 12-vjeçare "Demir Gashi", Peshkopi. Ishte viti shkollor 1965-1966. Mësues Hivziu e kishte lënë tashmë inspektimin e Seksionin e arsimit dhe kishte shkuar në profesionin e tij – te gjuha shqipe. Jepte gjuhë shqipe në klasë VIII. Besoj, vetëm me një fjali mund të matet vlera e mësuesit Hivzi dhe e fjalës së tij: Nuk mund të mbyllej mbledhja pa diskutuar mësues Hivziu.

Unë personalisht kam shumë momente këshillash e fjalësh prekatare të mësues Hivziut, sepse e kisha timin e më donte si njeri të vetin. Do të tregoj vetëm një moment. Te mësuesia hyn: Ishte viti 1960. Bëja praktikën njëjavore si kandidat (*kandidat* – kështu quhej atëherë praktikanti për mësues) në shkollën "Demir Gashi", Peshkopi, në ciklin e ulët. Nëse e mbaj mend mirë, ka qenë klasa IV. Mësuesja e klasës ishte Femije Cami. Ishte mësuese me formim e me integritet të plotë. U mundova që atë javë të isha "mësues" i mirë. Hivziu atëherë ishte inspektor. Ishte ora e katërt. Dy minuta para se të binte zilja për mësim, mu te dera e klasës sime – inspektori. Të them të drejtën, - nuk e prisja. Gjithkush e ka provuar: Inspektori ka hije të rëndë. Filloi mësimi. M'u duk se shkoi mirë. Kur doli, inspektori më tha: "Do të vij të të shoh edhe në një orë tjetër". Sipas meje, kjo qe fjala e tij prekatare, fjala me takt prej mësuesi. Diçka duhej ta kisha bërë më mirë. Dhe inspektori gjeti formulën "do të vij të të shoh edhe në një orë tjetër". Realisht nuk erdhi më.

Mësues Hivziu ishte njeri shumë i ëmbël në biseda me të tjerët. Mbaj mend (unë isha i ri atëherë, dhe ne të rinjtë rrinim në fund të odës në fshat), Hivziun e dëgjonin të gjithë burrat. Ai fliste, ai shpjegonte, ai jepte shembuj. Oda e dëgjonte. Vetëm e dëgjonte. Kishte edhe dije të gjithanshme e fliste shumë rrjedhshëm dhe kështu fjala e tij ishte, vërtet gur i rëndë.

Mësues Hivziu e njihte shumë mirë arabishten. Di që ka përkthyer literaturë islame. Di që ka hartuar edhe një fjalor arabisht-shqip, të cilin besoj se do t'ia botojnë fëmijët. Unë, me cilësinë e kryeredaktorit të një reviste islame, i kam botuar përkthimin: 99 Emrat e Zotit. 99 Emrat janë edhe 99 Atribute. Shumë të vështira për të gjetur barasvlerësin në shqip që të përcjellë saktë konceptet fetare islame. Dijetar Hivziu i ka dhënë përsosurisht. Edhe si përmbajtje konceptore, edhe si formime gjuhësore në shqip.

Nuk mund ta mbyll sythin për mësues Hivziun, pa kujtuar disa momente si ish-nxënës i tij në shkollën fillore (të shkollës 7-vjeçare janë shumë e s'i numëroj dot). Do të përmend vetëm katër.

Me fjalë mbushamendëse, por si për fëmijë e si për nxënës, mësuesi na dha konceptin e thyesës. Bëhet fjalë për klasën IV e për 11-vjeçarë në fshat. Shpjegimi qe më i gjerë; thelbi ishte ky: Kemi dy bukë, - tha mësuesi. Njanën e ndajmë në 5 pjesë ; tjetrën e ndajmë në 3 pjesë. Nga cila bukë e doni pjesën ju ? Nga ajo që u nda në tri, - erdhi përgjigjja.

Momenti tjetër: Kur e duem dikë fort, e duem si kripa apo si sheqeri?, - pyeti mësuesi. Ne ishim mangët për sheqer e jo për kripë dhe mësimi mund edhe të dështonte. Por mësuesi e parapërgatiti mendjen tonë dhe nuk e bëmë gabimin që të thoshim "e duem babën ose nanën si sheqeri", por si kripa,

arsim





Respekt dhe mirënjohje për mësuesit e mi

(Vijon nga faqja 17)

shkollën - dhe kjo kryesisht nga vështirësitë në matematikë, t'i bënte që të vazhdonin shkollën sepse me punë të përbashkët me mësuesin do t'ia dilnin që ta mbaronin shkollën. Dhe ata, vërtet ia dolën. Kjo ishte kënaqësi për nxënësit dhe për mësuesin.

Profesor Kadriun, për fatin tonë të mirë, e patëm mësues për 4 vjet. Nga viti në vit rriteshin rezultatet në mësime dhe forcohej miqësia e nxënësit me profesorin. Ai ishte mësues i dalluar i kolektivit pedagogjik të shkollës. Vitet kalonin dhe profesori i shtonte lidhjet me nxënësit. Ishte pjesë e aktiviteteve të ndryshme sportive e kulturore bashkë me nxënësit. Ne nxënësit e tij kujtojmë me nostalgji kur profesori merte kitarën dhe luante pjesë të ndryshme muzikore - si muzikë popullore, ashtu edhe muzike klasike.

Rezultatet shumë të mira të punës së profesorit qenë të pranishme gjatë gjithë 4 viteve. Ato dolën në pah kur ne dhamë provimin e shtetit në lëndën e matematikës. Profesori, duke ditur punën që kishte bërë në katër vite dhe se sa i kishin përvetësuar nxënësit dijet, kur filloi provimi futi 8 nxënës brenda. Anëtaret e komisionit i thanë se ishin shumë dhe se duhej të fuste vetëm 5 nxënës. Profesori u tha se pesë nxënës do të uleshin për t'u përgatitur, ndërsa tre të tjerët do të përgjigjeshin direkt. Kështu, tre nxënës u përgjigjën direkt, pa bërë përgatitje dhe u përgjigjen shkëlqyeshëm e u vlerësuan me notën 10. Anëtarët e komisionit mbetën jo pak të habitur. Kështu bëri edhe në turin e pasdites. Rezultati i përgjithshëm i gjithë klasës qe shumë i mirë.

Dua të theksoj edhe dy gjëra, të cilat flasin shumë për profesor Kadriun.

E para. Bëra katër vjet mësim me të. Gjatë gjithë katër viteve, nuk mbaj mend që profesori të mungonte qoftë edhe një orë mësimi (bëhet fjalë për mungesa me arsye). Ky veprim i profesorit ka ngelur në kujtesën time si simbol i vlerësimit dhe përkushtimit për punën.

E dyta. Me pati thënë një anëtar i këshillit pedagogjik të shkollës se në një analizë vjetore të punës së shkollës, drejtori i asaj kohe pati thënë: "Shkolla pedagogjike, po t'i ketë të gjithë mësuesit si Kadri Zhulali, nuk ka nevojë për drejtor". Mendoj se kjo thënie i thotë të gjitha për profesorin e nderuar Kadri Zhulali.

Qe fati im që pas 9 vitesh, kur unë erdha student në Fakultetin Ekonomik, dega financë, e gjej profesorin pedagog për lëndën e matematikës.

Edhe këtu në Fakultet profesori qe i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë kolegët dhe eprorët e tij. Ai gëzonte respekt edhe te studentët.

Më vonë, profesori mbaroi Fakultetin Ekonomik me rezultate shumë të mira dhe kaloi pedagog i lëndës së statistikës. Më pas u bë shef i katedrës së statistikës. Rezultatet në punë i pati gjithmonë të shkëlqyera. Në vitin 1992 profesori u bë dekan i Fakultetit Ekonomik. Për të gjithë aktivitetin e tij si pedagog, si shef katedre dhe si dekan, ka folur stafi pedagogjik i Fakultetit kur ndërroi jetë profesori.

Tani ishim në pluralizëm dhe gëlonin mediat e "lira" e ku shkruhej si t'i tekej gjithkujt.

Gazeta "Koha Jonë" shkruante çdo ditë kundër qeverisë demokratike që ishte në pushtet. Ndër të tjera, një ditë, te gazeta botohet një kryeartikull "Klani Kapo" me autor anonim. Pasi thuheshin shumë gjëra, për të cilat nuk ia vlen t'i kujtojmë, thuhej se "Kadri Zhulali, pasi qe 10 vite anëtar i Partisë së Punës, tani bëhet demokrat dhe emërohet dekan i Fakultetit Ekonomik". Një ish-student i tij, që e njihte mirë profesorin, bën po në gazetën "Koha Jonë" përgënjeshtrimin, duke e sqaruar se profesori nuk kishte qenë asnjë minutë anëtar i Partisë së Punës. Gazeta e boton përgënjeshtrimin. Kolegët e profesorit marrin gazetën dhe i shkojnë në zyrë. Pasi përshëndeten, e pyesin nëse e kishte lexuar shtypin. U përgjigjet: "Ende jo se isha i zënë me punë". I thonë se ka shkruar prapë gazeta "Koha Jonë". Jemi në pluralizëm, - përgjigjet profesori dhe duhet të përballemi me të tilla fenomene. Kolegët i thonë: Këtë radhë është ndryshe sepse ka shkruar një ish-studenti juaj. Profesori pa pyetur se çfarë ka shkruar, u përgjigjet kolegëve: Nëse është ish-studenti im (deri në atë kohë profesori duhet të kishte kaluar qindra studentë, në mos mijëra), atëherë ato që ka thënë studenti, janë të vërteta. Profesori ishte i bindur për këtë nga marrëdhëniet korrekte dhe të shkëlqyera që kishte me të gjithë studentët.

Ky qe profesori i nderuar dhe i respektuar nga të gjithë - Kadri Zhulali.

R.HOXHA

Halim Shehu

sepse pa kripë s'bëhet gjella e përditshme.

Shumë emocionuese ka qenë pjesa e këndimit për Vilhelm Telin. Babai do të gjuante me hark mollën mbi kokën e të birit! Ishte dënim. Si mund ta bënte këtë një baba! Ne shpëtuam nga ankthi kur mësuesi tha: Shenjëtari baba goditi mollën. Dhe u gëzuam fort.

Të paharruara kanë mbetur për ne nxënësit e atëhershëm copat e këndimit (*këndim* quhej atëherë libri i sotëm i leximit): Gavroshi i barrikadave të Parisit; Pahomi i Maksim Gorkit; Sa të rrosh, do të mësosh (plaku 80-vjeçar mësoi nga fëmija që mbushet grushti me hi e vihen gacat mbi të e nuk djeg duart); *Kanë mbjellë të tjerët pemë për ne, tani të mbjellim ne për të tjerët*; etj. Kanë kaluar 70 vjet, por na duket sikur e dëgjojmë edhe tani zërin e mësuesit e fjalën e mësuesit. Viktor Hygoi thotë: "Dy janë nëpunësit kryesorë të shtetit – nëna dhe mësuesi". Edhe më shumë se kaq janë. Edhe më shumë se kaq qe mësues Hivziu në tërë jetën e tij si mësues, si edukator. Me fjalën e tij. Sepse vetëm fjalën pati. Dhe e pati gjithnjë të ëmbël e prekatare.

Mësues Hivziu na mësoi intonacionin në gjuhën shqipe. Intonacioni (ndryshimi i zërit në melodi dhe në ritëm gjatë të folurit) është karakteristikë e shqiptimit të një gjuhe. Ne shkonim në klasë me gjuhën amtare, pra, edhe me intonacionin e shqipes. Por shpjegimet e mësuesit ishin të domosdoshme, sidomos, atëherë, në atë moshë e me ndikime krahinore. Mësuesi na mësoi kur ngrihet zëri (kur pyesim) dhe kur ulet (kur pohojmë a mohojmë diçka). Si na e mësoi? Me ushtrime leximi e të foluri. Nuk e dimë a mësohet tani intonacioni e përgjithësisht, shqiptimi. Ndoshta, në gjuhë të huaja (p.sh., në anglisht, që na duket se i ka marrë orë gjuhës shqipe) mund të mësohet dhe duhet të mësohet. Në anglisht, p.sh., intonacioni ngritës dhe intonacioni zbritës përdallojnë edhe mënyrën, edhe domethënien e kumtimit.

Para se ta mbyll fjalën time të pambarimtë, do të risjell tregimin për pikën si shenjë pikësimi.

Kam qenë në klasë të tretë. Mbaj mend që patëm bërë diktim dhe disa nxënës kishin bërë gabime në disa shenja pikësimi. Ndryshe nga herët e tjera, mësues Hivziu nuk i mori një për një fletoret e të na thoshte gabimet. I vuri ato në tryezë. Pastaj, largoi pak karrigen e doli para klasës. Ndëgjoni me vëmendje!, - tha mësuesi. Do t'ju thom nji ndodhí. Do ta ndëgjoni tregimin, - vijoi mësuesi, - pastaj do ta ritregoni ju. Dhe nisi tregimin:

"Na kishte qenë njiherë nji mbret. Nji mbret shumë i egër e shumë i pamëshirshëm. Mbreti kishte dënue me vdekje sa e sa njerëz të vorfën. Ishte dënue e priste ditën e

Hivzi Shehu.

pushkatimit edhe një burrë i gjatë, i dobët e i thatë, por me nji fytyrë e me nji buzëqeshje të ambël. (Ç'do të thoshte *vras* e *pushkatim,* i dinim sepse kishim parë njerëz me pushkë. Kishim parë edhe një lepur, me lesh të butë si mëndafsh, që e kishte vrarë një gjahtar nga fshati. Madje, njëra nga vajzat e klasës qau kur e pa lepurin). Mbërriti fermani i mbretit te shkruesi (tani, *shkruesit* i thomi sekretar ose sekretare, kurse *fermani* ishte urdhën me shkrim, shkresë). Shkruesi, pra, sekretari do ta rishkruente dhe do ta përcillte urdhnin te skuadra e pushkatimit. Urdhni thojte: "Falje e pamundur. Të pushkatohet!". Kuptohet, - vijoi mësuesi, - burri i gjatë, i mirë e i pafajshëm kishte kërkue që mbreti ta falte. Po ku falte mbreti! E tërë klasa lëshoi një ofshamë të gjatë, një "oh" të thellë, që shprehte njëherësh dhembjen tonë dhe lutjen tonë, për të mos e vrarë atë njeri të mirë. Ne ishim përhumbur e hutuar. Ai ishte tregim, por ne na dukej se njeriu që do të vritej, ishte diku afër; na dukej se mësuesi që dinte gjithçka, duhej ta njihte edhe mbretin dhe mund t'i lutej ta shpëtonte. E, me siguri, mbreti e dëgjonte fjalën e mësuesit, se ishte mësues! Në këtë çast e kishim harruar fare atë fjalinë e parë të mësuesit. "Na kishte qenë njiherë nji mbret", pra, që kishte qenë një mbret njëherë e një kohë, dikur, jo sot. Në të vërtetë, edhe mësuesi e kishte harruar se qe tregim i moçëm, sepse qe ngrysur i tëri në fytyrë. Me siguri, edhe ai përjetonte dhembjen për njeriun e dënuar. "E mori shkruesi fermanin e mbretit, - vijoi mësuesi, - dhe nisi ta kopjonte, pra ta shkruente përsëri, për t'ia përcjellë skuadrës së pushkatimit. Në ferman, - siç ju thashë, - shkruhej: "Falje e pamundur. Të pushkatohet!". Mësuesi lëvizi pak përpara e ngriti kokën. "Shkruesi, - vijoi ai, - ndërroi vendin e pikës. Nga ngutja, apo se iu dhimbs njeriu i pafajshëm e deshi ta ndërronte, - këtë nuk e dimë, - shtoi mësuesi. Dhe shkruesi shkroi: 'Falje. E pamundur të pushkatohet'." Mësuesi shqiptoi fort fjalën *pikë* pas fjalës *falje*. Tani, mësuesi u çel në fytyrë, mori një pamje të gëzuar, i qeshi fytyra. "*Dhe njeriu i pafajshëm nuk u pushkatue*", - tha mësuesi dhe mori frymë lirisht. Ne, e gjithë klasa, siç qemë të shtangur e të mbërthyer pas syve e pas buzëve të mësuesit, lëshuam në një zë një "oho" kënaqësie dhe fill, menjëherë, në çast, prapë në një zë pyetëm mësuesin: "Vërtet, mësues?! Vërtet?! Vërtet, për një pikë shpëtoi ai njeri i mirë?" Ishim gati të vraponim të gjithë njëherësh e ta përqafonim mësuesin nga gëzimi, por në klasë nuk lëvizet. "*Vërtet*, - tha mësuesi, - prerazi, por ëmbël. *Për një pikë. Nga një pikë*".

Dolëm nga klasa, ashtu të magjepsur e të lumturuar, por edhe me merakun për të mos gabuar asnjëherë te shenjat e pikësimit.

NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK.
PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE...
Bëj pajtimin tënd!
Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.** Në Europë: **10 Euro.** Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për të ndihmuar në botimin e gazetës mund të përdorni botimin e saj në versionin print për njoftime ose reklama të ndryshme për bizneset.
Një faqë me ngjyra në fund të gazetës kushton 20 000 leke, ndërsa në brendësi të gazetës 15 000 lekë. Një faqe bardh e zi kushton 10000 lekë.
Një reklamë në formatin e kartëvizitës 5x9 cm kushton 1000 lekë gjatë gjithë vitit (12 botime)
Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.
Dhurimet pranohen **VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE** që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë.
SWIFT Code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640
Për informacion: tel: **069 20 68 603;**
Whatsapp: **0686508441.**
Email: **rrugaearberit@gmail.com**

Rruga e Arbërit nr. 197

botime

Studimi "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës", është përgjithësimi i të gjitha të dhënave të punimeve të rilevimit, të kërkim –zbulimit dhe studimeve të kryera për mineralet e dobishme metalore e jo metalore, punimeve e studimeve hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, gjeomjedisore, të rrezikut gjeologjik, gjeoturizmit, etj. të kryera ndër vite në rajonin e Dibrës...

Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës, një libër

Nga **prof.dr. BASHKIM LLESHI**

Në muajin dhjetor 2022 doli nga botimi libri "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës", me autor gjeologun e njohur dibran prof. asoc.dr. Vesel Hoxha. Në fakt ky nuk ka përmasat e një libri, por të një studimi me vlera shumë të mëdha shkencore dhe ekonomike. Është një pasuri që i dhurohet Dibrës, për ta njohur dhe administruar si duhet në të mirën e kësaj treve, për rritjen e mirëqenjes së banorëve të saj dhe të mbarë kombit shqiptar.

Studimi "Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës", është përgjithësimi i të gjitha të dhënave të punimeve të rilevimit, të kërkim –zbulimit dhe studimeve të kryera për mineralet e dobishme metalore e jo metalore, punimeve e studimeve hidrogjeologjike, gjeologo-inxhinierike, gjeomjedisore, të rrezikut gjeologjik, gjeoturizmit, etj. të kryera ndër vite në rajonin e Dibrës nga specialistët e shumtë dibranë e jo dibranë, si dhe nga puna këmbëngulëse, sistematike e me përkushtim mbi 47 vjeçare e kryer në terren, në zonën e Dibrës, në zonën që në gjeologji njihet me emrat e Zonës së Korabit, Mirditës etj. nga autori i këtij libri prof. asoc. dr. Vesel Hoxha.

Në këtë studim synohet t'u jepet një zgjidhje shkencore edhe disa problemeve për të cilat është e preokupuar shoqëria dhe shteti ynë, për të bërë të pranishëm rolin e rëndësishëm që kanë sot e në të ardhmen shkencat e tokës, për mirëadministrimin e territorit dhe të pasurive natyrore. Një vëmendje e veçantë u kushtohet mineralizimeve hidrotermale, mineralizimeve të hekurit, kromit, bakrit, manganit, evaporiteve (gjipseve e anhidriteve, seleniteve), squfurit, mineraleve të rralla e të çmuara, naftës e gazit, etj. që sapo janë gërvishtur me kërkime e studime gjeologjike në trevën e pasur të Bashkisë Dibër.

Studimi trajton tre komponentë kryesorë: Gjeologjinë e trevës së Dibrës; Mineralet e dobishme dhe Rrezikun gjeologjik, të përmbledhura në dy harta gjeologjike në shkallë 1:50 000 (produkt i planshetave në shkallë 1:25 000) për të gjithë truallin e Bashkisë Dibër. Në linja më të përgjithëshme e anësore trajtohen dhe hidrogjeologjia dhe gjeologjia inxhinierike, për shtatë planshetet kryesore të kësaj bashkie, të cilat në të ardhmen kërkojnë plotësime dhe studime të herëpas-herëshme nëpërmjet studimeve të specializuara bashkëkohore.

Në kapitullin e parë "Gjeologjia e Dibrës" janë përgjithësuar arritjet e fundit në studimet, kërkimet dhe rilevimet gjeologjike e komplekse të kryera ndër vite, si frut i punës së tij këmbëngulëse, me përkushtim e sistematikë në terren e në zyrë, si dhe bashkëpunimit të gjërë me bashkëpunëtorë e studiues të shumtë, njohës të arritjeve të shkencës shqiptare në fushën e gjeologjisë. Në këtë kapitull me vlerë janë përgjithësimet e të dhënave biostratigrafike dhe interpretimet tektoniko-strukturore, duke i dhënë përparësi tektonikës mbihipëse dhe mbulesore. Jepet stratigrafia e zonave dhe nënzonave të Dibrës me argumenta të bollshme biostratigrafikë e ilustruar dhe me material grafik, me prerje, skica, kollona stratigrafike e tektono-stratigrafike, foto, etj. të cilat ia shtojnë vlerën këtij studimi, duke e lehtësuar e zbërthyer më tej, njohjen e gjeologjisë së vështirë të zonës së Korabit.

Në trajtimin e stratigrafisë autori nënvizon bashkëpunimin me prof. Selam Meçe, i cili me futjen në përdorim të analizës së konodontëve, solli një kontribut të madh në gjeologjinë e Shqipërisë për disa zona tektonike, e në veçanti për zonën problematike e të vështirë të Korabit, në diapazonin Ordovik i Sipërm-Triasik i Sipërm. Në sajë të këtij bashkëpunimi në terren e në laborator këto rezultate u reflektuan në hartografimet gjeologjike të zonës së Korabit. Kapitulli i magmatizmit i kushtohet kryesisht ofioliteve të Jurasikut të Mesëm, dhe mëshkurtimisht magmatizmit Paleozoik dhe atij Mesozoik (ku trajtohet më në detaje formcioni vullkanogjeno-sedimentar).



Vesel Hoxha
Gjeologjia dhe mineralet e Dibrës
ISBN 978-9928-387-07-3

600 f. ; 21x29.7 cm.
Botimet M & B,
Tiranë, 2022
Çmimi: 3500 lekë

Një vend të rëndësishëm ze tektonika ku shtjellohen tiparet themelore strukturore të zonës së Korabit (të secilës zonë e nënzonë të saj, ku veçohen: nënzona e Kollovozit, nënzona e Malsisë së Korabit dhe nënzona e Muhurr-Çajës, duke nënvizuar këtu dhe bashkëpunimin e frytshëm me prof. Alaudin Kodra), zona e Mirditës, zona e Krasta Cukalit, njësia e Dibrës dhe mollasat pliokuaternare të Peshkopisë. Në mënyrë të sintetizuar jepet historia e evolucionit paleogjeografik dhe gjeodinamik të zonës.

Kapitulli më i rëndësishëm është ai i mineraleve të dobishme metalore e jo metalore. Njohja e lexuesve me rezultatet e arritura në kërkim-zbulimin e mineraleve të dobishme në zonën e Dibrës, tregon për punën e madhe të kryer në vitet 1950-2000 nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për kërkim zbulimin e këtyre mineraleve.

Në mënyrë të detajuar përshkruhen mineralizimet e kromit të Balgjaj-Selishtës ku numërohen rreth 21 objekte e vendburime kromi, me cilësi 25-49,20% Cr2O3, me rezerva të kufizuara, por me perspektivë të hapur për vazhdimin e punimeve të kërkim-zbulimit dhe shtimin e rezervave të kromit. Me punimet e kryera në objektet e kromit të kësaj zone, në Fushë Shtrungëz, Liqeni i Shtrungës, Rrënja e Milloshit, Liqeni i Dervishit, Maja e Hurdhës, Druni i Boshtive, Afër e Poshtë Kepave, Ujësjellësi, Kodra e Lëmueme, Shullani i Përrejëve dhe Afër Qaf Murrës janë zbuluar mbi 284 000 ton rezerva gjeologjike dhe industriale me cilësi mesatare deri të mirë nga 25 % deri në 46,8% Cr2O3. Vlen të theksohet se shfaqjet, objektet dhe vendburimet e kromit të zbuluara në zonën e Balgjaj-Selishtës, janë po në të njëjtin masiv perspektiv për krom, atë të Bulqizës. Ligjësitë e mineralizimit të kromit në këtë masiv janë të njëjta. Ashtu siç janë zbuluar vendburime të mëdhej kromi në pjesën jugore si, Bulqiza, Batra, Krasta, Thekna, etj. në pjesën jugore, do të kemi dhe në pjesën veriore nga Shkalla e Manazdreni në Balgjaj, Kacni e Selishtë. Kjo varet vetëm nga shkalla e intensifikimit të punimeve të kërkim–zbulimit. Në vitet shtatëdhjetë e tetëdhjetë nga Ndërmarrjet Gjeologjike Bulqizë e Burrel zbuloheshin afro 3 milion ton rezerva kromi në vit, nga të cilat 1 milion ton shfrytëzoheshin, ndërsa afro 2 milion ton rezerva shtoheshin në bilançin shtetëror të rezervave çdo vit. Me mbylljen e punimeve për mineralet metalorë në vitin 1992, ka 32 vite që në bilançin shtetëror të rezervave nuk shtohet asnjë ton mineral kromi, bakri, hekur nikeli, etj. por vazhdojmë të shfrytëzojmë atë që kemi zbuluar para vitit 1992, duke zbritur çdo vit bilançin shtetëror të rezervave. Shfaqje dhe objekte kromi janë zbuluar dhe në masivin e Lurës, në teritorin e bashkisë Dibër nga Liqejt e Lurës e Lura e vjetër, në Përruan e Ftujës, në Kësulë e Krej Lurë me cilësi mesatare deri të mirë. Edhe masivi i Lurës ndodhet në brezin lindor të masivëve ultrabazikë të vendit tonë dheështë perspektiv për mineralin e kromit, ashtu si masivët e Bulqizës, Kukësit e Tropojës në veri dhe Shebenikut në jug.

Punime të kërkim zbulimit janë kryer për mineralin e hekurit oksid në zonën e Muhurrit dhe Malësinë e Korabit (Gurët e Pëllumbave, Avdanicë, Pojatën e Ali Jakupit, Kepi i Stogjit, Shpellas, Rrafshin e Korabit etj.) si dhe në strukturën e madhe tëbrahisinklinalit të Sorokolit në objektet e Gurëve të Kodrës, Rreshkës, Tabes së Nizamit etj. etj. ku janë zbuluar mbi 552 000 ton rezerva hekuri oksido –silikat me cilësi të mirë, por që, punimet u ndërprenë për problemin e pasurimit të xeherorit në fjalë, për vështirësit që ai paraqet në ndarjen e hekurit nga fosfori, për shkak të përmbajtjes së lartë të fosforit. Xeherori i hekurit pa nikel kërkohej në atë kohë për nevoja të kombinatit metalurgjik të Elbasanit për prodhimin e çelikut të cilësisë së lartë. Perspektiva për rezerva është e hapur. Është kërkuar vetëm 10 % e strukturës xeherormbajtëse.

Për mineralizimin e bakrit është punuar në serinë efuzivo-sedimentare të Gramë – Tominit si nëPilafe, Tomin, Zimur, Hirisime Gurrë nëCerjan, Gurin e Kuq, Gramë, Skërtec etj., ku në objektin e Hirisimit janë zbuluar 20 000 ton mineral bakri me mbi 0.9 % Cu. Për mineralin e bakrit është punuar dhe në zonën e Lurës, nga Qafë Lura në Pregjë Lurë e deri në Arrëmallë (në objektet Gatri i Vjetër e Kroi i Buce, Kodra e Murrizit, Përroi i Gështenjit etj.) me rezerva të kufizuara e cilësi të mirë, ku deri tani janë zbuluar 33 786 ton mineral bakri me cilësi 0,4-2,98% bakër. Vlen të theksohet se mineralizimi i bakrit në këtë zonë është, si ai i vendburimit të madh të Gjegjanit në Kukës, prandaj dhe perspektiva është e hapur për punime të mëtejshme të kërkim-zbulimit duke vazhduar deri në shtrirjen e tij jugore deri në Mbasdeje..

Në vazhdim përshkruhen mineralizimet hidrotermle-teletermale të squfurit të Kërçisht-Kllobçishtit, mineralizimet e realgar-auripigmentit , në disa objekte me shoqërime të Au, Hg, Cu, Pb,Zn, Mn, Fe, dhe elementëve të tjerë si V, Mo, Co, etj.(në shfaqjet squfurore të banjave, Vrejtit, Dipjakës,Trojakut dhe më në veri në Malësinë e Korabit (në Stanet e Preshit, Qafën eRritheve, Burimet e Izvirit, Kepin e Stogjit, Shpellasin, Rrafshit të Korabit, Qafën e Rosnikut, Avdanicës, Trojakut, Dipjakës, Varrit tëSejmenit e Biçajës etj.).

Përshkruhen gjithashtu mineralet e Manganit dhe Hekur–Manganit në Borije Lurë, Muhur, Malësinë e Korabit ku përmendim ato tëHirisimit, Bjeshkës së Zonjave, Rrafshin e Korabit, përroit të Lushit, Krizës etj.; mineralizimet e Platinit dhe Nikelit sulfur në pjesën perëndimore të masivit të Lurës; të Hekur-Nikelit në Vlashaj; të Vanadit në Zall Dardhë, Zall Kalis, Përroi Veleshicës, përroi i Shumbatit, i Miravecit, i Bulaçit e deri në Muhur; të Aluminit (boksitet e Krej Lurës); të Arit në zonën e Korabit; të lëndëve të para të ndërtimit (mermere, gëlqerorë të mermerizuar, granite, ranorë, kuarcite, inerte lumore, rreshpe metamorfike (rrasa për mbulesa çatishë) etj.; Mineralet industrialë (Talku, Azbesti, Dunitet e freskëta, Pirofiliti i Sohodollit me 6 milion ton rezerva, Grafiti, etj.;

Lëndët e para kimike (Bojrat e Dheut e Squfuri) ku në objektet: Përroi i Miravecit, Përroi i Kaut Kastriot, Pilafe, Kabe, Tomin e Renz, janë zbuluar mbi 1 273 600 ton rezerva, ndërsa në objektin e Squfurit Kërçisht është zbuluar një sasi e vogël rezervash.

Lëndët e para teknike (Travertinat, ku janë zbuluar 40 000 m3 në objektin e Vleshës; Gëlqerorët, në dy breza nga Reçi në Selishtë dhe nga Korabi në Kërçin me rezerva shumë të mëdha, Gëlqerorët e mermerizuar të Muhurrit, Kraj Reçit e Kepit të Xhitetitnë Arras, me mbi 2,5 milion m3; Argjilat, në vendburimet dhe objektet: Dardha e Kubenit, Dohoshisht, Kastriot, Zbinec, Kodra Gjize, Zdojan, etj. ku jana zbuluar mbi 14 294 146 ton rezerva;

Evaporiteve (Gjipsit, Anhiditit e Selenitit) në masivin e madh që shtrihet nga përrejt e Grevës e Banjave deri në përroin e Gramës e Veleshicës, u kushtohet një rëndësi e veçantë duke kryer edhe më shumë punime dhe duke konkretizuar disa objekte e vendburime me rezerva të konsiderueshme, të ilustruara me hartografime e prerje gjeologjike, analiza kimike e fotografi.

Në libër citohen mbi 16 fusha përdorimi të gjipseve, nga ndërtimi (parafabrikate gjipsi, çimento të bardhë, etj.), bujqësia, deri tek krematurë për këmbët, shampo për flokët, në mjekësinë kineze e stomatologji. Në këtë masiv të madh të gjipseve janë zbuluar disa vendburime gjipsesh, anhidritesh e seleniti (Prroi i Banjave, Rabdisht, Vrenjt 1 e 2, Prroi i Gramës, Vleshë Uji i Ftohtë, Ura e Druve, etj. ku me punumet e kryera janë llogaritur afro 14 milion ton rezerva industriale dhe gjeologjike, si dhe vendburimi i Selenitit tek Varri i Sejmanit me 180 000 ton rezerva seleniti. Perspektiva për shtimin e rezervave është e hapur. Më gjithë këtë pasuri të madhe që ka Dibra me gjipse e anhidrite, përpunimi dhe futja në përdorim e kësaj lënde të parë me shumë fusha përdorimi len për të dëshëruar.

Ndërsa në Dibër të Madhe kemi pjesën periferike më jugore të gjipseve me përhapje të kufizuar dhe është ndërtuar që në fillim të viteve shkatëdhjetë "Gjipsara", sot Kombinati i Gjipsit "Knauf Radika", që furnizon me parafabrikate gjipsi, çimento të bardhë, etj. gjithë Europën dhe shumicën e shteteve të Azisë deri në USA, ne akoma nuk kemi ngritur një objekt të tillë gjipsi, kur me rezervat që kemi dhe mundësinë për t'i shtuar ato, mund të ngremë disa të tillë, jo vetëm për të plotësuar të gjitha nevojat e vendit por edhe për të dalë në eksport.

Në rajonin e Dibrës ka të dhëna edhe për mineralizimin e Arit në zonën e Korabit, Platinit e Nikelit Sulfur në pjesën perëndimore të masivit ultrabazik të Lurës, të Aluminit në boksitet e Krej Lurës, të Vanadit nga Zall Dardha e Zall Kalisi në përrejt e Veleshicës, Shumbatit, Miravecit, Bulaçit deri

shkencë

Prof. Vesel Hoxha, me punën e tij mbi 47 vjeçare, ka fituar një ekperiencë të madhe në fushën e gjeologjisë dhe me përfundimin e këtij studimi, e ka afirmuar veten si një ndër shkencëtarët e shquar në fushën e gjeologjisë shqiptare në përgjithësi dhe gjeologjisë së zonës së Korabit në veçanti.

me vlera të mëdha shkencore dhe ekonomike

në Muhurr, të Hekur –nikelit në Vlashaj Lurë, të Boksiteve në Krej Lurë, për Uranium në objektet e Bufllit në Muhur e Kodra e Kuajve në Kala të Dodës, të cilat përbëjnë fusha të reja për kërkime e studime të mëtejshme bashkëkohore për t'i zbuluar e për ti vënë në shërbim të rritjes ekonomike rajonale e kombëtare.

Në vendin tonë, ku ka gjipse duhet kërkuar edhe për naftë e gaz. Këtë e tregojnë studimet për naftë e gaz nga Veleshica në Kostenjë. Kjo nuk përbën ndonjë çudi, por është konkluzion i arritur me vrojtime e studime të autorit në bashkëpunim me gjeologët më të mirë të naftës e gazit në vendin tonë.

Kapitulli i III-të "Rreziku Gjeologjik i Dibrës" është një nga kapitujt e rëndësishëm të këtij libri, i trajtuar për herë të parë, që vihet në shërbimtë komunitetit, njësive vendore dhe Bashkisë Dibër. Është përpiluar Harta e Rrezikut Gjeologjik, ku trajtohen tërmetet (e viteve 1920-2002 në shkallë kombëtare dhe për Bashkinë Dibër për vitet 2002-2020 me katallogët përkatës), qëndrushmëria e shpateve, përmbytjet, orteqet, shkëputjet dhe zonat shkëputëse tektonike, rrëzimet, shembjet, etj. të shoqëruar me listat përkatëse. Trajtohen faktorët që ndikojnë në qëndrushmërinë e shpateve, nga ato gjeologjikë, tektonikë, veprimet e ujrave nëntokësore, hidrometeorologjik, seizmiciteti, mbulesa bimore, deri tek veprimtaria e njeriut.

Përshkruhen rreziqet gjeologjike natyrore, erozioni, vrojtimet gjeologo-inxhinierike, masat për mbrojtjen e shtratit të lumit Drin dhe për të rehabilituar pjesët e dëmtuara, dukuritë karstike, hinkat, gropat, lugjet, luginat, kanionet (tre kanionet e Grykës së Setës, përroit të Mallës së Lurës, lumit Drini i Zi, poshtë Urës së Dodës, në Kraj Reç, Hotesh, Gradec, i përroit të Gramës, Veleshicës, etj.), deri tek fushat karstike (të Fushës së Panairit, Lan Lurës e Lugina e Xharxhishtit), karsti nëntokësor, nga puset, oxhaqet, sterret, galeritë e shpellat, ku rregjistrohen 19 shpella karstike. Përshkruhen punimet e braktisura të shoqëruara me listën e tyre në shkallë bashkie.

Një rëndësi e veçantë u kushtohet burimeve ujore, ujrave të pijshëm ku jepet dhe tabela e të gjithë burimeve në teritorin e Bashkisë së bashku me debitet përkatëse dhe cilësinë e tyre, ujrat agresivë (agresiviteti i sulfureve, karbonateve, etj.), rezervuarët dhe liqenet natyrore (ku në zonën e Selishtës kemi 40 liqene nga të cilët16 të mëdhej deri mesatarë dhe 24 të vegjël, nga 14 liqene që kemi në zonën e Lurës(9 të mëdhej e 5 të vegjël) dhe në zonën e malsisë së Korabit 10 liqene të vegjël deri mesatar).

Tërhiqet vemendja për rreziqet gjeologjike tektonogjene (antropogjene) të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut, si shfrytëzimi pa kriter i inerteve lumore e shkëmbore, rezervuarët, minierat e braktisura, sterilet, mbetjet urbane, kanalizimet e ujrave të zeza, shfrytëzimi i karrierave pa projekte dhe pa masa të rehabilitimit të mjedisit, mbetjet industriale, ndotja e ujrave nëntokësor, mbetjet urbane, etj.

Një rëndësi e veçantë u kushtohet Monumenteve të natyrës dhe Gjeomonumenteve, ku jepet lista e 4 gjeoparqeve, 8 gjeomonumenteve me vlerë regjionale, 11 gjeomonumenteve me vlerë kombëtare, 25 gjeomonumenteve me vlerë lokale, 41 monumenteve të natyrës, ku për disa kryesore jepen përshkrimet dhe fotot. Përshkruhen Parqet kombëtare të Lurës dhe Korab-Koritnikut, prerja stratigrafike e graptoliteve të Muhurit, kupola evaporitike e Malit të Bardhë, Rrafshi i Korabit, Bjeshka e Zonjave me Bjeshkën e Gramës, burimet e Bellovës, shpellës së Sopanikës, kroi i Mbretit Sorokol, pasqyrat e Pelpenikut, alloktoni i Gramës, Fushat e Pelave, Lurë, Panairit Korab, fusha karstike e Lan Lurës, objekti i Squfurit Kërçisht, Monumentet e natyrës (Plepat e rrepat në Bardhaj, Hurdhë Reç e Sllatinë), Guri i Vashës në Qaf Murrë e Kishavec, Guri i Kuq në Krej Lurë, Kepi i Xhitetit në Arras, Guri i Pëllumbave, Bjeshka e Shehut, Pylli i Mështeknave në Kijavec, Ploshtan, Guri i Erebarës, etj të cilët duhen ruajtur e administruar nga njësitë vendore dhe Bashkia e Dibrës sepse përbëjnë një pasuri tjetër të madhe që ka Dibra për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit malor.

Në fund jepen edhe 15 Hartat e Rrezikut Gjeologjik të Bashkisë Dibër me shpjegimet përkatëse dhe lista e 170 projekteve, raporteve e studimeve të kryera si autor i vetëm, autor kryesor me bashkëpunëtorë dhe si bashkëautor.

Prof. asoc.dr.inxh. Vesel Hoxha në punën e tij mbi 47 vjeçare, mbi 35 vite i ka kryer në terren në zonën më të vështirë e problematike të gjeologjisë së vendit tonë, në zonën e Korabit, duke punuar direkt në terren, duke çuar më përpara njohjen e saktë të formacioneve gjeologjike, stratigrafisë, tektonikës, etj, duke reflektuar të gjitha përmirësimet hartografike të rilevimeve gjeologjike të kryera në shkallë 1:25000 dhe vrojtimeve të bëra në terren nga vetë autori. Ai ka drejtuar punimet për kërkim zbulimin e mineraleve të dobishme të hekurit oksid e silikat, bakrit, mineralizimeve hidrotermale-teletermale, evaporiteve (gjipseve, anhidriteve, seleniteve), squfurit, gurëve veshës dekorativë, etj. të zonës së Korabit etj. duke drejtuar në shumicën e kohës edhe Ekspeditën gjeologjike të Peshkopisë dhe më vonë, Degën Rajonale Gjeologjike të Peshkopisë.

Krahas punës së tij sistematike e me përkushtim, ai ka ditur të bashkëpunojë dhe të përfitojë nga eksperienca e shumë studiuesve të vjetër të gjeologjisë si, bashkëpunëtori i vjetër shkencor Abedin Xhomo, prof.Shyqyri Aliaj, prof.Vangjel Melo, paleontologu P.Pashko, profesorët Aleksandër Çina, Minella Shallo, Aleks Vranaj, Bashkim Lleshi, Andon Grazhdani, Artan Tashko, Afat Serjani, Vangjel Qirici, Vangjel Kici, Kadri Gjata, Ibraim Milushi, Përparim Hoxha, Ilir Alliu, Safet Dogjani, Ylber Muceku, Çerçiz Durmishi,Arjan Beqiraj, Nezir Mekshiqi, Avni Meshi, Eleni Gjani, inxh.Burhan Kodra, pa harruar dhe kolegët e ish Ekspeditës gjeologjike të Peshkopisë, inxhinierët Esat Manjani, Niko Kita, Irakli Premti, Sakip Elezi, Emërllah Kolgjini, Nexhat Hysa, Xhevahir Torba, Miftar Majmari, Xhemal Mena, Miftar Islami, inxh. topograf Selim Muça, teknikun topograf Xhelal Suli dhe teknik gjeologët Ali Bardhi, Halit Koka, Adli Baholli, Muharrem Sturçe, Isa Mandri e Hasan Lala.

Në vitet tetëdhjetë, nëntëdhjetë e deri kur doli në pension ai ka marrë pjesë në studime të kryera nga Institucionet kryesore shkencore të gjeologjisë si me Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë, Institutin e Naftës e Gazit, Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, Qendrën Sizmologjike, Ndërmarjen Gjeofizike, etj, si: në Studimin e perspektivës dhe prognozës së mineralit të hekurit pa nikel në zonën e Korabit të kryer në vitin 1979, studimin për përpilimin e Hartës gjeologjike të Shqipërisë në shkallë 1:200 000 të vitit 1983, të hartave tektonike, të mineraleve të dobishme dhe të Rrezikut gjeologjik të Shqipërisë në shkallë 1:200 000, studime për perspektivën e gjipseve dhe anhidriteve në zonën e Korabit, studimit të mineraleve të dobishme industriale në shkallë kombëtare të kryer në vititi 2005, studime në bashkëpunim me ING, etj. etj.

Ai është një ndër intelektualët e shquar të Dibrës, i cili është aktivizuuar edhe në aktivitetet kryesore të LID (Kuvendin tekniko shkencor të vitit 2007 dhe Konferencën Shkencore të 2019 për Rrugën e Arbërit, si autori kryesor i përgatitjes së referateve: "Pasuritë minerale të rajonit të Dibrës që mund të vihen në qarkullim ekonomik me ndërtimin e Rrugës së Arbërit" (2007)dhe "Përmirësimi dhe ndërtimi i rrugëve lidhëse me Rrugën e Arbërit të njësive administrative të Peshkopisë, Kastriotit, Çidhnës, Lurës, Dardhës, Reçit, Sllovës, Kalasë së Dodës, Tominit e Melanit- me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë, turizmit malor e historik" (2019).

Me punën e tij mbi 47 vjeçare ai ka fituar një ekperiencë të madhe në fushën e gjeologjisë dhe me përfundimin e këtij studimi, e ka afirmuar vehten si një ndër shkencëtarët e shquar në fushën e gjeologjisë shqiptare në përgjithësi dhe gjeologjisë së zonës së Korabit në veçanti. Tani vazhdon të jetë në pension, gëzon shëndet të mirë dhe i uroj të vazhdojë më tej punën kërkimore shkencore në fushën e gjeologjisë.

JETËSHKRIM: Kush është prof. Vesel Hoxha



VESEL RAMADAN HOXHA u lind në Blliçe, Dibër më 20 tetor 1952.

ARSIMIMI: Ne vitin 1970 mbaron Teknikumin e Minierave dhe të Gjeologjisë në Përrenjas, me rezultate të shkëlqyera, ku është diplomuar Teknik i Mesëm Markshajder. Në vitet 1970 - 1975 ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave me rezultate shumë të larta, ku është diplomuar Inxh. Gjeolog, për minerale të dobishme të ngurta. Pas mbarimit të studimeve të thelluara pasuniversitare (1998 - 2000), në vitin 2001 ka mbrojtur disertacionin me temë: "Tiparet themelore të gjeologjisë dhe perspektiva e kërkimeve në rajonin Kërçisht - Sorokol", me vlerësimin "Shume Mirë", ku fiton gradën "Doktor" në fushën e shkencave gjeologjike. Me 07 maj 2014, bazuar në shqyrtimin e dosjes së paraqitur dhe plotësimin e detyrimeve ligjore, i jepet titulli akademik "Profesor i asociuar", miratuar nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave. Gjatë viteve 2009 - 2017, pedagog i ftuar në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, si mësimdhënës në lëndën e "Rilevimit Gjeologjik dhe Gjeomorfologjik" dhe udhëheqës i praktikave mësimore në terren, për dy kurset e vitit të tretë (bachelor) të degës së Gjeoinformatikës. Gjatë viteve 2016-2017, pedagog i ftuar në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, si mësimdhënës në lëndën e "Vendburimeve të mineraleve të dobishme të ngurta dhe kërkimit të tyre", për kurset e vitit të tretë (bachelor) të degës Inxhinieri Gjeologjike dhe të degës së Gjeoinformatikës.

EKSPERIENCA NE PUNE: Pas përfundimit të studimeve të larta ka punuar si inxh. gjeolog pranë Ndërmarrjes Gjeologjike Bulqizë (Ekspedita Gjeologjike e Dhoksit dhe më pas në Ekspeditën Gjeologjike të Bulqizës) me kërkim - zbulimin e mineralit të Kromit. Në qershor të vitit 1976 fillon punë në Ekspeditën Gjeologjike të Peshkopisë, në Ekipin e Korabit, ku ka punuar për kërkim-vlerësimin e mineralizimeve të Hekurit oksido-silikat, oksideve të Manganit, disa mineralizimeve Polimetalore dhe atyre të Çmuar, në Zonën Tektonike të Korabit. Në janar të vitit 1984 emërohet Kryetar i Ekspeditës Gjeologjike të Peshkopisë. Në vitin 1998 emërohet Shef i Sektorit të Gjeologjisë Peshkopi. Në vitin 2003, emërohet Drejtor i Degës Rajonale Gjeologjike të Peshkopisë. Në vitin 1996, krahas detyrës së Kryetarit të Ekspeditës Gjeologjike Peshkopi, ka kryer edhe detyrën e Drejtorit të Ndërmarrjes Gjeologjike Bulqizë (i komanduar) dhe, nga viti 1993 e gjerë në vitin 1995, ka qenë Kryetar i Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Gjeologjike Bulqizë. Në vitin 2006 transferohet në Drejtorinë e Përgjithshme të SHGJSH -së, në detyrën e Shefit në Drejtorinë e Programimit, Vlerësimit dhe Menaxhimit të Projekteve, Tiranë. Nga shkurti i vitit 2008 e deri në shtator të vitit 2011, ka punuar si punonjës shkencor pranë Institutit te Gjeoshkencave, të Universitetit Politeknik të Tiranës, në Departamentin e Gjeoresurseve dhe Gjeoinxhinierisë, si Drejtues i Grupit Kërkimor-Mësimor të Mineraleve Metalore e Jo Metalore. Njëherazi gjatë kësaj periudhe ka qenë edhe Antar i Senatit akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës. Nga shtatori i vitit 2011 e në vazhdim, punonjës shkencor në Departamentin e Gjeoresurseve dhe Gjeoambientit të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, si dhe nga shtatori i vitit 2012, Drejtues i Grupit Kërkimor-Mësimor të Mineraleve Metalore e Jo Metalore. Pas korrikut të vitit 2015 e deri më 20. 10. 2017, punonjës shkencor, Drejtues i Grupit Kërkimor-Mësimor të Metalogjenisë, në Departamentin e Gjeologjisë, të Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisi.

AKTIVITETI SHKENCOR: Krahas detyrave të ngarkuara të cilësuara më sipër, ka kryer rilevime gjeologjike në shkallë dhe rajone të ndryshme të rretheve të Dibres, Kukësit, Matit, Bulqizës etj.; kërkime, vlerësime e kërkim - zbulime për xeheror kromi, hekuri oksid e silikat, mangani, bakri, polimetalorësh, squfuri, vanadi, mineralesh jo metalorë si mermere, argjila, travertina, bojra dheu, gjipse, anhidrite, selenite, inerte, kuarcite, ranorë, gëlqerorë, pirofilite etj. si dhe, është marrë me studime të gjeologjisë inxhinierike, gjeomjedisit, hidrogjeologjisë etj.

Është angazhuar në disa tema studimore të karakterit kombëtar (si bashkeautorë) me Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, Institutin e Kërkimeve Gjeologjike etj.; ka bashkëpunuar me disa firma të huaja që punuan në ish rrethin e Dibrës etj. nga viti 1993 e deri në vitin 1997, në zonën e Korabit, Vrenjtit, Lurës etj, për kërkim - vlerësimin e evaporiteve, mermereve, bakrit, mineraleve të çmuar etj. (Mec -East, Minorco, Nebex, UPUP – MUHUR, "Karma Mining" LTD). Nga korriku i vitit 2006 e deri në gushtin e vitit 2016 ka punuar si këshilltar i jashtëm për probleme gjeologjike pranë firmës së njohur gjermane – Knauf. Ka qenë Drejtues i Grupit Kërkimor/Studimor, autor dhe bashkautorë i mbi 125-se studimeve, raporteve, prezantimeve, projekteve, relacioneve gjeologjike, i mbi 24 artikujve shkencor të botuar në Buletinin e Shkencave Gjeologjike dhe në revista të tjera vendase e të huaja si dhe, ka në proçes botimi punime shkencore.

SI PUNIME KRYESORE VEÇOJMË: Realizimin e studimit: "Harta Gjeologjike dhe Pasurive Minerale të rrethit të Dibrës në shkallë 1:50 000 dhe teksti shpjegues përkates", përpiluar mbi bazën e studimeve dhe rilevimeve gjeologjike të kryera gjerë në vitin 1999; Në vitet 2001 - 2003 ka drejtuar studimin me temë: "Administrimi i territorit dhe resurseve natyrore në rrethin e Dibrës, të Qarkut Dibër". Po ashtu gjatë viteve 2004 – 2005, ka drejtuar studimin për ndërtimin e "Hartës së Rrezikut Gjeologjik për rrethin e Dibrës në shkallë 1:50 000, me tekstin shpjegues përkates" etj. Eshtë bashkëautorë dhe bashkepunetorë në disa studime madhore për vendin të cilat lidhen me gjeologjinë e Shqipërisë, mineralmbajtjen dhe metalogjeninë. Në janar të vitit 2020 botoj librin me kujtime maleve në kërkimet gjeologjike të titulluar "Shënime në Çadër" prej 566 faqesh. Ka në proçes pune librin vijues po me kujtime me titullin "Maleve të vendit tim". Është i kualifikuar në kompjuter në programet: Word, Exel dhe, mjaftueshëm në AutoCAD, Pawer-Point, Photoshop, etj. Gjatë punës ka patur rastin të bashkëpunojë me specialistë te huaj si gjerman, francez, italian, kanadez, turq, anglez, bullgar, maqedonas, rus etj. të fushave të ndryshme të gjeologjisë, punonjës në institucione shkencore të njohura të Europës. Shfrytëzon literaturë profesionale në dy gjuhë të huaja. Në vitin 1987 është dekoruar me: "Medalje për punë të shquar në miniera e gjeologji".

Libri "Gjurmë të folkut arbëror" i autorit Gëzim V. Bara, sjell në vemendjen e publikut të gjërë vlerat e trashëgimisë folklorike kombëtare si vlerë dhe pjesë e identitet kombëtar.

"Gjurmë të folkut arbëror" - një enciklopedi e folkut shqiptar

Nga **NAXHI KASORUHO**

Botimi i një libri për autorin është ditë e veçantë prandaj edhe ne miqtë e kolegët e Gëzimit jemi këtu në këtë promovim për të marrë pjesë në këtë gëzim dhe t'i urojmë atij krijimtari të begatë në të ardhmen.

Libri "Gjurmë të folkut arbëror" i përbërë me këtë triptik fjalësh shumëdomethënëse të zgjedhur nga autori sjellë në vemendjen e publikut të gjërë vlerat e trashëgimisë folklorike kombëtare si vlerë dhe pjesë e identitet kombëtar.

Autori në 280 faqe të librit në përbërje të 115 titujve të shkrimeve që ilustrohen nga rreth 220 foto të artistëve popullorë të veshur me kostume të shndritshme e shumëngjyrëshe në veprimtari kombëtare deri në Kalanë e Festivalit të Gjirokastrës janë analiza studimore shkencore duke na dhënë një panoramë befasuese në gjithë dimensionin e kësaj trashëgime kombëtare, që vjen nga thellësia e shekujve dhe meliumeve ku populli artist e ka trashëguar në breza me tërë dashurinë e shpirtit.

Për gjithçka që sjell autori në gjithë faqet e librit unë këtë libër e quaj: "Enciklopedi e Folkloristikës Shqiptare". U ula ta lexoj me vëmendje duke qënë se nga Festivali i parë Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës në vitin 1968 dhe deri në edicionin e tetë në vitin 2009 kam qënë pjesë e këtij manifestimi të fuqishëm edhe si udhëheqë artistik i grupeve popullore të rrethit të Gjirokastrës, më kalojnë para syve si një film dokumentar artistët popullorë nga gjithë kombi.

Mbi 20.000 këngëtarë këngëtarë, valltarë e instrumentistë virtuozë korifej të këngës e valles popullore shqiptare kanë bërë që të buçasin bedenat e kalasë historike të qytetit të gurtë nga zërat e tyre brilantë duke ekspozuar perla nga trashëgimia tonë folklorike.

Dhe nostalgjia për këto festivale më bëri të kujtoj një këngë të kënduar nga grupi i Gjirokastrës në festivalin e vitit 1978 ku thotë:

"Na buron nga zemra,
Kënga më e mirë.
Në Kalanë e Festivalit,
Plot me mysafirë.
Ç'e erdhën sot në vatrat tona,
Kaq zambak e kaq shqiponja,
Nga Saranda tek Valbona".
-Thoja shqipe, thoja,
Hidhe vallen shtruar,
Këndoni o male
Sup më sup bashkuar.

Pikërisht këtë atomsferë festive, këta artistë të jashtëzakonshëm, këto perla nga folklori tradicional dhe ai bashkëkohor të një mendimi studimor me penelata të theklsuara në një mozaik magjepës të etnografisë shqiptare dhe tinguj të këngës e valles burimore është mbështetur autori në këtë libër enciklopedi. Mendoni për një moment bashkimin e 220 fotove të librit në një poster gjigand se çfarë pamje mahnitëse e madhështore do të ketë ai duke na pasqyruar në tërë shumëllojshmërinë e ngjyrave të kostumeve mahnitëse të një populli vital në trojet e tij nga lashtësia deri në ditët e sotme.

Ja pra, madhështinë e këtyre festivaleve dhe pasurinë e jashtëzakonshme të trashëgimisë tonë na i përcjell në libër Gëzim Bara në një analizë të gjithanshme duke dhënë një kontribut të vyer si vlerë e identiteti kombëtar. Për këtë folklor befasues dhe madhështinë e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës po sjell këtu vlerësime të dy



Libri është një kontribut i promovimit të vlerave ku autori është munduar të na i sjellë me vërtetësi si studiues serioz dhe i vëmendshëm këto këngë e valle, vegla muzikore dhe kostume shumëngjyrëshe që vijnë nga thellësia e shekujve deri në diët tona.

Libri vjen si botim në një moment kur Ministria e Kulturës ka shpallur organizimin e Festivalit të Gjirokastrës duke sjellë në vëmendjen e lexuesit, artistëve popullorë dhe organizatorëve të këtij manifestimi madhështor të festës së folkut shqiptar, rolin dhe vlerat e kësaj trashëgimie dhe vëmendjen që duhet të tregojmë të gjithë që ky festival të organizohet me tërë madhështinë e tij.

personaliteteve të studiuesve të folklorit europian.

Selina Grasia Gorduvjo, zëdhënëse, drejtoreshë e Institutit Meksikan të Kulturës:

"Qyteti i Gjirokastrës është për mua një vend i mrekullueshëm për të organizuar festivalet folklorike. Unë jam e emocionuar që marrë pjesë në festivalin që zhvillohet këtu. Gjithashtu jam e lutur që takoj një popull që këndon me shpirt dhe krenari këngët e tij".

Dr.Dinrih Shyler – përfaqësues i Fonogram Arkivit të Akademisë së Shkencave të Austrisë në Vjenë.

"Do ta kujtoj këtë festival për një kohë të gjatë. Në asnjë vend të Europës sot nuk ka mundësi të dëgjosh e të shikosh këngë e valle folklorike kaq spontane, vitale dhe në të njëjtën kohë kaq tradicionale."

Autori është kujdesur maksimalisht për të sjellë në libër çdo cep të territorit të vendit me këngëtarë e valltarë virtuozë e grupe popullore befasuese, vlera në trashëgiminë kombëtare si përfaqësues të çdo treve etno-muzikore që ekspozuan në kalanë e festivalit në qytetin e Gjirokastrës, perla të rralla të folkut arbëror që tashmë janë në gjerdanin e artë të kulturës. Korifej që udhëhoqën këto grupe autori i sjell ata të portretizuar me tërë bukurinë dhe individualitetin e tyre në një tregim emocionues e mbreslënës duke u ndalur në vlerat artistike të veçanta, që ata bartin e transmetojnë nëpërmjet një intepretimi të lartë. Janë me qindra emrat e artistëve popullorë që Gëzimi i sjell në libër jo vetë si vlera statistikore e historike por tregon përhapjen në një dimension të jashtëzakonshëm të pjesëmarrjes në lëvizjen folklorike ku masiviteti është treguesi kryesor i vlerave në breza dhe që këta korifej të jenë edhe shembuj për artistët e rinj, që presin me padurim të ngjiten për herë të parë në Kalanë e Festivalit të Gjirokastrës, në sofrën e këngës, në panteonin e kulturës popullore në maj të vitit 2023 duke nisur udhëtimin e tyre të gjatë e të bukur.

Në trashëgiinë folklorike ka shembuj të artistëve që janë kthyer në legjendë e vlerë për kombin tonë që në historinë e një vendi vijnë një herë në 100 vjet si të papërsëritshëm e të paarritshëm nga Vaçe Zela, Mentor Xhemali, Ndue Shyti, Demir Zyko, Besim Zekthi, Katina Bejleri, Golik Jakupi, Fitnete Rexha, Luçie Miloti, Laver Bariu, pletë e Krujës, vallatërt e Tropojës, Korç[s, Rajcës, fyejt e Gramshit, grupi i Kolonjës etj., që këto fletë nuk mjaftojnë për t'i shkruar të gjithë që u jemi mirënjohës për kontributin e tyre jo vetëm në festivalin e Gjirokastrës por edhe në skenat e Europës dhe botës.

Në libër autori evidenton jo vetëm vlerat e festivalit por edhe trashëgiminë në përgjithësi të promovuar në shumë festivale tipologjike të organizuar nga Qendra Kombëtare e vepritarive folklorike si: Takimi i rapsodëve në Lezhë, vallet në Lushnje, polifonia në Vlorë, sazet në Korçë apo oda Dibrane e kënga qytetare në Elbasan etj, çka tregon vëmendjen që ai i kushton folklorit i cili na i paraqet me kopetencë dhe analiza të sakta të një studimi shkencor.

Gëzim Bara me pasionin e një studiuesi i ka ndjekur veprimtaritë folklorike me vëmendje të veçantë dhe na i pasqyron në këtë libër "Enciklopedi" në një dimension gjithëpërfshirës duke u ndalur në analiza të detajuara në pasqyrimin e kësaj pasurie nga Saranda në Tropojë.

Portretizimi i shumë artistëve të mirënjohur për vlerat që bartin e me të cilat takohet e bashkëbisedon në ditët e festivalit i japin vlera librit dhe i memorizojnë ato duke bërë të mundur të njihen nga lexuesit e shumtë dhe dashamirët e trashëgimisë folklorike.

Libri është një kontribut i promovimit të vlerave ku autori është munduar të na i sjellë me vërtetësi si studiues serioz dhe i vëmendshëm këto këngë e valle, vegla muzikore dhe kostume shumëngjyrëshe që vijnë nga thellësia e shekujve deri në diët tona. Për gjithçka që autori sjell, ne i jemi mirënjohës dhe i urojmë krijimtari të begatë në të ardhmen.

Libri vjen si botim në një moment kur Ministria e Kulturës ka shpallur organizimin e Festivalit të Gjirokastrës duke sjellë në vëmendjen e lexuesit, artistëve popullorë dhe organizatorëve të këtij manifestimi madhështor të festës së folkut shqiptar, rolin dhe vlerat e kësaj trashëgimie dhe vëmendjen që duhet të tregojmë të gjithë që ky festival të organizohet me tërë madhështinë e tij.

Në përfundim një sygjerim për Ministrinë e Kulturës, kur të hartojë programin e veprimtarive që do të zhvillohen në ditët e festivalit të panifikojnë edhe promovimin e librit të studiuesit të trashëgimisë kulturore Gëzim Bara. "Gjurmë të folkut arbëror". Ku më mirë se në në Kalanë e Gjirokastrës mund të flitet për vlerat e trashëgimisë folklorike të kombit tonë.



BASHKIM DUVA, MIKU I GJITHË MATJANËVE

Nga **SEJDIN DEMIRI**, Burrel

Më datë 03.02.2023, Këshilli Bashkiak Mat, aprovoi njëzëri një nga vendimet e tij më të drejta, dhënien me titull "Qytetar Nderi të Matit", Ing. Bashkim Duvës.

Bashkim Duva lindi në Bulqizë në një familje patriotike, por aktivitetin e tij të punës e pati në Mat. Bashkimi në mesin e shumë vështirësive mbaroi arsimin e lartë me rezultate të shkëlqyera si inxhinier shpimi. Pas mbarimit të studimeve të larta, ai dërgohet në frontet më të vështira të gjeologjisë në Mat.

Drejtoi prej shumë kohësh vendburimin e Batrës. Ku falë punës organizative dhe shkencore të Ing. Bashkimit u bë e mundur realizimi dhe tejkalimi i detyrave të zbulimit të kromit të pasur në vendburimin e Batrës, aq të nevojshëm për ekonominë Shqiptare duke e kthyer Batrën në ekspeditën gjeologjike pararojë në gjithë vendburimet krom-mbajtëse të Matit dhe më gjerë.

Në vitet 1980 Ing. Bashkim Duvës i besohet drejtimi i Ndërmarrjes Gjeologjike të Matit, kjo një detyrë mjaft e vështirë, por falë përgatitjes së lartë teknike dhe organizative dhe aftësive të tij të rralla për të punuar në grup, arriti që Ndërmarrja Gjeologjike e Matit të radhitet e para në vend për rezultatet e larta në zbulimin e kromit të pasur.

Ai bëri të mundur që çdo pëllëmbë tokë e Matit të mbulohej dhe të studiohej me shërbim gjeologjik. Inxhinier Bashkimi drejtoi gjeologjinë e Matit për një periudhe 10 vjeçare dhe në periudhën më të vështirë, për vetë natyrën e punës së saj gjeologjia është puna më e vështirë, por kësaj i shtohej edhe presioni i partisë në pushtet, ku inxhinier Bashkimi diti t'iu bëj ballë me sukses të plotë madje duke marrë në mbrojtje shokët dhe bashkëpunëtorët e tij, që punonin bashkarisht në projektet dhe zbatimin e detyrave në ndërtim zbulimin e kromit të pasur.

Bashkim Duva ishte një drejtues i vërtet i një ndërmarrjeje me vështirësi të mëdha për vetë karakterin e zbulimit dhe kërkimeve, distancat e largëta, hapësirat e shpërndarjes së punimeve që kërkonte sakrificë dhe lodhje, por ai ishte atje. Falë punës së tij organizative dhe shkencore plot përkushtim dhe pasion, u bë e mundur ndërtimi i një ndërmarrjeje me mbi 1000 punëtorë dhe specialistë, ku falë punës së tyre u bë e mundur hapja e perspektivës se minierës 11 heronjtë e Batrës me mbi 100 vjet shfrytëzim dhe sjellje të ardhurash për shoqërinë tonë. Në planin njerëzor, Inxhinier Bashkim Duva ishte një qytetar model, ai ngrit familjen e tij në Burrel ku lindi dhe rriti 3 fëmijë. Ku dy djemtë e tij ishin futbollistë të ekipit matjan të futbollit. Një cilësi tjetër e inxhinierit ishte dhe ajo e mbështetjes së njerëzve në nevojë, ku ne si punonjës të gjeologjisë e kishim derën e hapur për çdo problem ku inxhinier Bashkimi u be miku i gjithë matjanëve. Në vitet 1990 mbështeti proceset demokratike me qëndrimin e tij intelektual ndaj reformave ku shumë shpejt u zhgënjye për rrjedhën sesi morën ngjarjet. Ai punoi në ndërtimin e një gjeologjie të re me konceptet e ekonomisë së tregut por problemet me shëndetin e penguan në realizimin e kësaj sipërmarrjeje.

Ndërroi jetë pa arritur kohën e daljes në pension nga një sëmundje e rëndë. Vdekja e tij e parakohshme la një hapësirë dhe mungesë të madhe për familjen, shokët e punës dhe gjithë gjeologjinë shqiptare ku ai shërbeu me pasion dhe përkushtim për më shumë se 40 vjet. Desha t'i mbyll këto pak rreshta për drejtorin simbol të gjeologjisë së Matit dhe gjithë Shqipërisë dhe njeriun e mirë Bashkim Duva.

Desha të falënderoj edhe njëherë në emër të të gjithë kolegëve dhe punonjësve që kanë punuar me inxhinier Bashkimin, këshillin bashkiak të Bashkisë Mat duke nderuar me titullin e lartë "Qytetar Nderi i Matit" pas vdekjes mikun e gjithë matjanëve, dibranin e mirë, inxhinier Bashkim Duva.

homazh

Homazh për mësuesin veteran **Ahmet Rushit Tomja**

AHMET TOMJA u lind më 5 janar 1940 në Kovashicë të Grykës së Vogël, në një familje me të kaluar patriotike. Gjyshi i tij Zenel Tomja mori pjesë në luftën për pavarsi e demokraci në vitet 1905-1924. Daja i tij Bexhet Lleshi ka ndihmuar aktivisht luftën për mbrojtjen e trojeve nga pushtues të shumtë otomanë, serb e deri tek ata italianë e gjermanë, në vitet e luftës Nacionalçlirimtare. Daja i nënës Avdulla Xhurxhi nga Hoteshi është dëshmor i luftës kundër serbëve më 1913 tek Ura e Topojanit.


Rushit Tomja ishte ndër vullnetarët e parë antifashistë në Dibër. Shtëpia e tij ishte dhe u bë një ndër bazat më të rëndësishme të luftës nacional-çlirimtare, në malsinë e Grykës së Vogël. Ajo ndodhej në një nyje ose kishte një pozicion mjaft të volitshëm, që siguronte lidhje midis fshatrave që të çonin deri në thellësi e dalje në Luzni, Katër Grykë, Bulqizë nëpërmjet Qafës së Murrizit, në Bllacë, Grykën e Madhe etj.

Shkollën fillore Ahmeti e mbaroi në fshatin e lindjes, shtatë vjeçaren në Shupenzë. Mori bursë për në shkollën e mesme pedagogjike Peshkopi në vitet 1954-1958 dhe përfundoi me rezultate shumë të mira. Me pasion e filloi profesionin e mësuesit në shkollën shtatë vjeçare Margegaj në rrethin e Tropojës. Në moshë të re përballoi me vështirësi problemet e lëvizjes, komunikacionit, shpesh herë u detyrua ta bëjë më këmbë rrugë të gjata në kushte të vështira atmosferike. U largua nga Margegajt duke marrë respektin dhe konsideratat më të mira prej nxënësve dhe prindërve, dashurinë e malsorëve për mësuesin e ri vullnetar në ato zona të largëta prej familjes dhe Dibrës.

Prej Tropoje erdhi mësues në shkollën shtatë vjeçare "Man Jella" Zogje më 1961. Shkolla e Zogje në ato vite ishte ndër shkollat më të dalluara në rrethin e Dibrës. Ahmeti solli këtu edhe përvojën e mirë të mësuesve të Tropojës. Si mësues i gjuhës dhe letërsisë pati rezultate dhe arritje prandaj i dhanë një bursë për të vazhduar Universitetin e Tiranës, në degën e gjuhës dhe letërsisë, në vitet 1963-1967. Në vitin 1965 familja dhe vetë Ahmeti kaluan një goditje të rëndë. Vëllai, Skënderi, më i madhi, ishte puntor në ndërmarjen gjeologjike, në Krastë të Martaneshit. Në përpjekje për gjetjen e një shoku të tyre që humbi jetën për shkak të borës së madhe ato ditë, një ortek u mori jetën dhjetë puntorëve, ndërmjet tyre edhe Skënderit. Ata u shpallën dëshmorë të Atdheut. Për familjen ishte një humbje e madhe bashkë me dy fëmijët e tij. Ahmeti si më i madhi në familje i ra barra të përballojë jo vetëm dhimbjen, por edhe kujdesin për familjen.

Shkollën e mbaroi me rezultate të mira, një premisë e mirë për të filluar karierën në fushën e arsimit. Emërimi si inspektor në seksionin e arsimit dhe kulturës ishin edhe një frut i një pune sistematike që kishte kryer në punë si mësues por edhe një përgaditje në shkollën e lartë nga ana shkencore por edhe profesionale.

Në detyrën e re u njoh me përvojën e mësuesve të dalluar të shkollave të Dibrës, të cilën bëri përpjekje ta çojë në të gjitha shkollat si motra.Punoi pa u lodhur për kualifikimin e mësuesve nëpërmjet seminareve, orëve të mësimeve shembullore, kurseve të kualifikimit me mësuesit e gjuhës dhe letërsisë në shkallë zone dhe rrethi. Me grup autorësh punoi për zbatimin e vendimeve të Kongresit Drejtëshkrimit, përvetësimin prej mësuesve të profilit të gjuhës, të rregullave të drejtëshkrimit etj. Gjithashtu me grup



autorësh me mësuesit në bazë e qendër punuan për fjalorin Enciklopedik e atë të Gjuhës Shqipe në vitet 1970-1985.

Në periudha të ndryshme punoi si specialist në kabinetin pedagogjik dhe në gjimnazin e Peshkopisë si mësimdhënës. Gjithnjë si nënpunës ishte korrekt dhe i disiplinuar. Kudo ku ka punuar është shquar për urtësi, qetësi, maturi, marrëdhënje shumë të mira me kolegët, mësuesit, nxënësit por edhe prindërit.

Në vitin 1990 u trasferua në Maqellarë. Më 1993 erdhi në Brezhdan.Ai e njihte jetën dhe problemet e fshatit, sepse vinte nga fshati dhe asnjëherë nuk i shkëputi marrëdhënjet me familjen dhe prindërit e tij në fshat. 40 vjet mësues në qytet dhe fshat, ishte një punonjës arsimi që dha gjithçka.Ai kujdesej krahas vëllezërve dhe motrave, në veçanti për prindërit deri sa ndërruan jetë në Kovashicë.

Ahmeti krijoi familje me Anife Elezin nga Gradeci e cila punoi si edukatore kopshti në lagjen Dobrovë. Aty morën edhe shtëëpi, rritën dhe edukuan tre fëmijë; dy vajza Teuta infermiere, Valdetja mësuese dhe Dritani ekonomist. Të gjithë me arsim të lartë. Punojnë në punë sipas profileve, që kanë studiuar në shkollë sipas shembullt të prindërve të tyre.

Si qytetar Ahmeti ndërtoi marrëdhënje të mira me komunitetin që e rrethonte, ishte një veprimtar i këshillit në lagje, duke dhënë një ndihmesë si intelektual në zgjidhjen e problemeve që shqetësonin qytetarët.

Në vitin 2005 Ahmeti erdhi me familje në Tiranë, në lagjen "Don Bosko", i rrethuar me dashurinë e nipërve dhe mbesave. Gjyshi interesohej dhe kujdesej për mbarëvajtjen e tyre në shkollë dhe gëzohej për rezultatet e mira në mësime.Ahmeti si shumë dibranë, nuk e harroi asnjëherë Dibrën. I pranishëm në shumë veprimtari dhe evenimente që organizoheshin për Dibrën në Tiranë, në promovimet e krijuesve dibranë në kryeqytet etj.

Pas një sëmundje të rëndë u nda nga jeta më 3 shkurt 2013. Familja humbi njeriun e saj të dashur dhe të shtrenjtë, ne kolegun, shokun e respektuar, që do të na mungojë në takimet miqësore e shoqërore.

Lamtumirë miku ynë! U prehsh në paqe!

Sulë Tomçini, Avni Fida, Shahin Lazri, Kapllan Keçi, Zabit Lleshi, Qerim Tomja.

NEKROLOGJI

Ndahet nga jeta **Sami Sulejman Kamberi**, njeriu i ndershëm, i drejtë, mendjehapur

SAMI KAMBERI u lind në Peladhi, më 13 janar 1928. Kreu shkollën plotore të Zerqanit (1936-1940), dhe pas çlirimit kreu natën shkollën 8-vjeçare dhe gjimnazin. Në moshën 16 vjeç, më 12 maj 1944 doli partizan. Deri më 10 korrik 1944, së bashku me Jonuz Gjokën dhe 5 djem të tjerë nga Gryka e Madhe ishte në skuadrën shoqëruese të Baba Fajës, të cilin e përcollën deri në Labinot, pastaj u rreshtua në Batalionin II të Martaneshit me komandant Ferit Myrtezain nga Zerqani. Në nëntor të 1944-s ky batalion u dërgua për të marrë pjesë në luftën për çlirimin e Tiranës dhe pastaj iu bashkua brigadës XXVI S. Në gusht 1945 pranohet anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare. Pas çlirimit, deri në prill 1946 ishte pjesë e efektivit të Grupit të artilerisë kundërajrore në Tiranë. Në prill 1946 ishte në përbërjen e njërit nga dy grupet që u dërguan në Jugosllavi për mbledhjen e eshtrave të dëshmorëve që ranë në luftën e brigadave të UNÇl për çlirimin e saj. Në dispozicion të këtij grupi ishin tri makina (kamionë) dy prej shoferëve ishin Shaqir Cani, Sofraçan dhe Musa Sula, Zerqan. Ky grup kaloi fshat më fshat e mal më mal deri në Novi Sad dhe mundi të mbledhë eshtrat e 42 dëshmorëve, të cilat në qershor 1946 i kthyen ne atdhe. Nga nëntori i vitit 1946 deri 1948, ishte sekretar i Seksionit politik të Divizionit i të këmbësorisë. Në vitin 1948 kreu shkollën e oficerëve dhe u lirua si oficer rezervë me gradën aspirant. Deri në qershor të vitit 1949 punoi si sekretar teknik në minierën e Bulqizës. Nga kjo kohë thirret nga Ministria e PB (Punëve të Brendshme) dhe emërohet në Seksionin e PB në Shupenzë. Pas mbylljes së kësaj dege kaloi po në të njëjtin sektor në Peshkopi si kryereferent e më pas në vitin 1950 deri në vitin 1955 si shef i seksionit të sigurimit dhe kryetar i Degës së Qendrës së këtij qarku. Në gusht të 1955 deri në janar të 1956-s transferohet në Ministrinë e PB si kryereferent në Degën III. Pas kësaj rikthehet në Peshkopi si shef i Seksionit të sigurimit dhe nga viti 1961 deri në 1965-ën ishte nënkryetar i Degës së PB në Peshkopi me gradën major. Nga 1965 deri në 1968 transferohet në Degën e PB, Shkodër si shef Seksioni. Në 1968 transferohet si Kryetar i Degës së PB Përmet, ku qëndroi deri në vitin 1972. Në vitin 1972 transferohet si kryetar i Degës së PB në Berat, ku qëndroi deri në vitin 1975. Në vitin 1975 u transferua në Ballsh si Komandant i Repartit 309 ku qëndroi deri në vitin 1980. Nga viti 1980 deri në vitin 1982 ishte komandant i Repartit 313, Tiranë. Në vitin 1983 doli në pension dhe që nga ajo kohë banoi në Tiranë.

Kudo që punoi, Samiu u shqua si një person i disiplinuar, trim, i përpiktë, i ndershëm, i drejtë, njeridashës, mendjehapur dhe punëtor i palodhur. At Zef Pllumi në librin e tij "Rrno vetëm për me tregue" (Bot II, fq 633-637, Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2006) i ka kushtuar atij katër faqe: Ai thekson, midis tjerash, se Samiu ndryshonte 180 gradë nga paraardhësit e tij, të cilët drejtuan para tij Kampin e të burgosurve në Ballsh, se ishte i ndërgjegjshëm për pozitën që kishte, por edhe për të drejtat njerëzore që "asht një barrë edhe ma e randë" dhe vazhdon": Sami Kamberi kishte origjinë dibrane. Me shka njof un, njerëzit ma puntorë të Shqipnisë janë dibranët, ata të fushës së Devollit të Korçës dhe mandej ata të disa malsive të Shkodrës. Samiu e kishte në gjak punën. Kampin e gjet mo'Zo'ma keq edhe nga pikëpamja e sigurisë". Dhe më tutje tregon se, pasi ai e kishte ngarkuar Zefin të bënte një punë për rregullimet e Kampit, një ditë ishte ndalur pranë tij dhe e kishte urdhëruar të ndalte punën, të pushonte dhe të "dridhte një cigare", i jep dorën dhe i thotë: "E shoh që ke punuar mirë dhe të lumshin duarët" dhe Zefi ia kthen: "Të falem nderës, zotni komandant se asht e para herë që ndigjoj



Sami Kamberi u vlerësua e nderua jo vetëm nga shteti të cilit i shërbeu me përkushtim, besnikëri e dinjitet; nga shokët, miqtë dhe të njohurit e tij; por u respektua dhe u vlerësua, për ndershmërinë, drejtësinë, njeridashjen e respektimin e të drejtave njerëzore edhe nga kundërshtarët e regjimit të atëhershëm. Sami Kamberi nderoi jo vetëm familjen e tij, Peladhinë ku lindi, Grykën e Madhe e Dibrën, por edhe çdo vend ku ai punoi nëpër Shqipëri.

se i thuhet nji të burgosuni: 'Të lumshin duart', sepse gjithmonë jena mësue të na thonë "Jepi derr, shtyje derr, puno derr!" E më pas, kur Zefi kishte mbaruar një punë që i kishte ngarkuar, Samiu i kishte propozuar që të ndërtonte një lulishte aty para komandës. "Zef, - më tha, - megjithse tash je i përjashtuar nga puna e detyruar për shkak moshe e sëmundjeje, prap se prap, mendoj se është më mire për ty që të merresh me një punë se sa me ndejë aty mrendë duke llomotitë me të burgosurit e tjerë. Kështu i rri larg edhe rrezikut. Kjo punë është vullnetare, nuk paguhet, sepse nuk e përfshin tefteri, por bukën e gjellën e merr si puntorët." "Në të vërtetë, për mue kje nji privilegj i madh, sepse që nga revolta e Spaçit ndër kampe e burgje ishte ba i modës dënimi i dytë e i tretë me dëshmitarë e shpifsa. Nga ana tjetër edhe për shëndetin tem nji punë e lehtë si ajo e lulishtarit, n'ajër të pastër, i bante shumë mire trupit tem, tashma të ngarkuem me shumë sëmundje. Në vitin e ardhshëm lulishta duel shumë e bukur."

Ky burrë ishte Sami Kamberi, ai u vlerësua e nderua jo vetëm nga shteti të cilit i shërbeu me përkushtim, besnikëri e dinjitet; nga shokët, miqtë dhe të njohurit e tij; por u respektua dhe u vlerësua, për ndershmërinë, drejtësinë, njeridashjen e respektimin e të drejtave njerëzore edhe nga kundërshtarët e regjimit të atëhershëm. Sami Kamberi nderoi jo vetëm familjen e tij, Peladhinë ku lindi, Grykën e Madhe e Dibrën, por edhe çdo vend ku ai punoi nëpër Shqipëri dhe la mbresat e tij.

Në vlerësim të kryerjes së detyrave të tij, ai ishte dekoruar me medaljen e Çlirimit, medaljen e Shërbimit Ushtarak, medaljen 10-vjetori i Ushtrisë, medaljen e trimërisë, me urdhrin "Ylli i Kuq" si edhe me urdhërin e Skënderbeut Kl III.

Ky burrë, që u nda nga jeta, më 12 shkurt 2023, do t'u mungojë fëmijëve të vet, nipërve e mbesave, të afërmve dhe shokëve e miqve të tij të shumtë.

HOTEL CAMI

HOTEL CAMI

Shijoni magjinë e Dibrës







Për rezervime
+389 (0) 70 241 205
+389 (0) 46 841 555
hotelcami@hotmail.com
Dibër, Maqedonia e Veriut

cyan magenta yelloë black